



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 46/2019 regjistër (JR)
Datë 25.09.2019

Nr.15 i vendimit
Datë 18.06.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

Albana Shtylla	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 18.06.2021, ditën e premte, në orën 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonçi Petković, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI I ANKIMIT: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 161, datë 18.06.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita, me funksionin gjyqtar/kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2, F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e Komisionerit Publik Florian Ballhysa të paraqitura në ankim, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 161, datë 18.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita, prapësimet e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit, dëgjoi gjyqtaren relatore Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Kastriot Selita, në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar nga Komisioni, ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex-officio*.
2. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të neneve 33, 34 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD).
 - 2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar¹, duke konstatuar se: i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2 DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin e kontrollit të figurës², duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.
 - 2.3 KLD-ja ka rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe ka dërguar raportin³ në të cilin janë pasqyruar gjetjet dhe analiza e 8 (tetë) dosjeve gjyqësore.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 161, datë 18.06.2019, në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur konfirmimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita, me detyrë gjyqtar/kryetari Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë. Këtë vendim Komisioni e ka mbështetur mbi konkluzionet e arritura për kriterin e kontrollit dhe vlerësimit të pasurisë dhe figurës, si më poshtë.
 - 3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Nën hetimin e thelluar e të gjithanshëm, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar me vërtetësi dhe saktësi deklaratën “vetting” dhe ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në përputhshmëri të plotë me deklaratimet periodike, si dhe të mbështetur në dokumentacion ligjor që në momentin e dorëzimit të deklaratës “vetting” në ILDKPKI, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016. Hetimi i thelluar administrativ i Komisionit për burimet e bashkëshortes para martese apo konstatimi i pasaktësisë së saj, në një nga pasuritë e

¹Me shkresën nr. {***} prot., datë 14.11.2017.

²Me raportin nr. {***} prot., datë 02.11.2017, për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar me vendimin nr. {***}, datë 11.5.2018, të KDZH-së.

³Me shkresën nr. {***} prot., datë 9.02.2018.

deklaruar dhe që nuk cenonte burimin e ligjshëm, nuk passjell pasojë ligjore për subjektin e rivlerësimit e, për rrjedhojë, subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:

Trupi gjykues, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmëri në detyrë, edhe pas hetimit të thelluar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

3.3 Për kriterin profesional:

Nisur nga vlerësimi pozitiv i organit vlerësues se subjekti ka aftësi ligjore për të gjykuar, bazuar në standardet e jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, të konstatuara edhe gjatë hetimit të Komisionit për këtë kriter, por edhe nga denoncimet, të cilat ishin të lidhura kryesisht me themelin e çështjes (jo pak herë u konstatua se ato kishin përmbajtjen e rekurseve që kishin paraqitur në Kolegjin e Lartë Administrativ), çmon se subjekti i ka përmbushur kushtet ligjore të pikës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

4. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, në mbështetje të rekomandimit⁴ për paraqitje të ankimit, nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ka paraqitur ankim⁵ kundër vendimit të nr. 161, datë 18.06.2019, i cili konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit Kastriot Selita.
5. Në pretendimet e parashtuara në ankim, por edhe gjatë seancave gjyqësore publike, Komisioneri ka kundërshtuar vendimin e Komisionit në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë dhe kriterit të aftësive profesionale duke kërkuar nga Kolegji kryerjen e hetimeve të mëtejshme, rezultatet e të cilave mbështetën kërkimin përfundimtar për një vlerësim të veçantë dhe të përgjithshëm, të ndryshëm nga Komisioni të këtyre kritereve.
6. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

A. Lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë

7. Komisioneri Publik në ankim ka shprehur se prej tij është konstatuar se, përsa i takon vlerësimit të pasurisë, bazuar në kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr.84/2016, përfundimet e Komisionit për këtë kriter kontrolli ndaj subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nuk gjejnë mbështetje të plotë në aktet dhe provat e administruara. Komisioneri Publik, referuar dhe përmbajtjes së rekomandimit të paraqitur nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, ka çmuar se procesi i hetimit, i kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk ka qenë i plotë e, për rrjedhojë, përfundimet e arritura nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara.
8. Shkaqet e ankimit, duke u ndarë sipas pasurive të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, janë sa më poshtë vijon.

⁴Shih rekomandimin e ONM-së nr. {***} prot., datë 24.07.2019, në faqen zyrtare në internet të Komisionerit Publik: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2019/07/8.Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-161-dat%C3%AB-18.6.2019.pdf>.

⁵Ankim i Komisionerit Publik me nr. {***} prot., datë 08.08.2009: për më tepër shih në faqen zyrtare në internet të Komisionerit Publik: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2019/08/23.Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-161-dat%C3%AB-18.6.2019-z.-Kastriot-Selita.pdf>.

9. **Për pasurinë nr. 1:** “Apartament” me sipërfaqe 124,91 m², nr. pasurie {***}, ZK {***}, vol.{***}, f.{***}, rr. “{***}”,{***}, Tiranë,pasuri e blerë nga pala shitëse, znj. S. C. dhe z. F. C., për vlerën 177.370 euro, me kontratë shitje pasurie të paluajtshme me kusht kreditimi nr. {***} rep., nr.{***} kol., datë 15.12.2015⁶, me pjesë takuese 50%, në bashkëpronësi të subjektit me bashkëshorten, znj. M. K. Subjekti nuk ka mundur të provojë ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie⁷, e cila si origjinë fillestare ka gjendjen pasurore dhe financiare të bashkëshortes së subjektit dhe familjes së saj, në momentin e krijimit të asetit që kjo familje ka pasur në pronësi në Tiranë, shtëpi banimi (268,2 m²) dhe truall (330 m²), ndodhur në {***}, Tiranë për shkak të:

9.1 Mospërputhjes së vlerës së kostos së ndërtimit, që duket se është reflektuar në analizën financiare të Komisionit, krahasuar me atë në dokumentacionin provues, sjellë nga subjekti.

9.2 Mosjustifikimit të krijimit me burime të ligjshme të pasurisë shtëpi banimitë familjes së personit të lidhur në {***},Tiranë⁸, pasi nuk duhen konsideruar si të tillatë ardhurat e pretenduara,në shumën 1.630.035 lekë, të znj. M. K. nga fondacioni “{***}” Albania.

9.3 Mungesësë përlllogaritjes në analizën financiare të shpenzimeve për mobilimin e pasurisë shtëpi banimi (268,2 m²) në {***}, si dhe të atyre të qirasë për familjen K. në periudhën 1996-2004.

9.4 Paqartësisë në metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës për periudhën para vitit 2003.

10. **Për pasuritë nr. 2 dhe nr. 3:**

° “Apartament” me sipërfaqe 29,86 m², nr. pasurie {***}, ZK {***}, vol.{***}, f.{***}, rr. “{***}”,{***}, Tiranë. Kjo pasuri është fituar me kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.12.2016, me palë shitëse znj. S. C. dhe z. F. C., për vlerën 46.000 euro, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten, znj. M. K., me pjesë takuese 50% secili.

° “Garazh” me sipërfaqe 12,5 m², nr. pasurie {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, rr. “{***}”,{***}, Tiranë. Pasuri e fituar me kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. {***}rep., nr. {***} kol., datë 23.12.2016, me palë shitëse znj. S. C. dhe z. F. C., për vlerën 24.000 euro, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten, znj. M. K., me pjesë takuese 50%.

Për këto dy pasuri, subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e tyre,të cilat si origjinë fillestare kanë të ardhurat e përfituara nga shitja prej bashkëshortes së apartamentit prej 100,9 m², me adresë Rruga e {***}, {***},Tiranë, të blerë nga shoqëria “{***}” ShPk, pasi:

10.1 Referuar akteve të administruara përgjatë hetimit administrativ,si dhe deklarimeve të bëra nga subjekti gjatë këtij hetimi, nuk përputhet destinacioni i deklaruar për shpenzime kredisë së marrë nga personi i lidhur, në vlerën 23.000 euro, nga NBG Bank, për blerjen/porositjen e apartamentit nga shoqëria “{***}” ShPK në vitin 2005, me përmbajtjen e dokumentacionit bankar.

⁶Në nenin 4 të kontratës, parashikohet mënyra e likuidimit me dy këste: (i) shuma 92.370 euro do të derdhet në llogarinë e noteres brenda një jave; dhe (ii) diferenca prej 85.000 eurosh do të likuidohet me kredinë që do të marrë pranë BKT-së.

⁷Subjekti ka deklaruar dhe shpenzime për mobilim për pasurinë 1, në vlerën 21.354 euro, me kontribut të përbashkët me bashkëshorten prej 50% secili.

⁸Shtëpi banimi (268,2 m²) dhe truall (330 m²), ndodhur në {***}, Tiranë.

10.2 Lidhur me “shumëne dhuruar” nga familja K., bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, të përdorur për mbylljen e kredisë pranë NBG Bank, në vlerën 20.042 euro, nuk rezulton që të jetë hetuar nga Komisioni nëse është paguar tatimi në burim, në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar.

10.3 Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nuk provon ligjshmërinë e të ardhurave të kursyera prej saj përgjatë vitit 2004 në vlerën rreth 9000 eurodhe të deklaruara si të përdorura si burim të ardhurash për blerjen prej saj të apartamentit të {***} në {***}.

10.4 Në lidhje me vlerën e përfutur nga bashkëshortja e subjektit nga shitja e apartamentit prej 100,9 m², me adresë Rruga e {***}, {***}, Tiranë, duke konsideruar së bashku me rrethanat e faktit dhe ato ligjore që lidhen me: (i) tatimin mbi të ardhurat që është paguar me 10 vite vonesë; (ii) pagimin e tatimit vetëm disa ditë para dorëzimit të deklaratsvetting; (iii) përshkrimine pagesës së tatimit i cili nuk lidhet qartësisht me transaksionin për të cilin paguhet detyrimi; Komisioneri Publik pretendon se do të ishte i nevojshëm interpretimi/orientimi i Kolegjit për të arritur në përfundimin nëse të ardhurat, për të cilat pagesa e detyrimeve tatimore kryhet me vonesë, gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit, do të duhet të konsiderohen ose jo si të ardhura të ligjshme, në interpretim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

- 11. Për pasurinë nr. 4:** (i) *Apartament me sipërfaqe totale 205,33 m² (158 m² sipërfaqe e brendshme dhe 47 m² sipërfaqe verandë), me adresë fshati “{***}”, Durrës, fituar me kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.06.2012, dhe kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.08.2015, me vlerë 82.132 euro, në bashkëpronësi me bashkëshorten me pjesë takuese 50% secili.* (ii) *Trualli mbi të cilin ndodhet apartamenti me sipërfaqe 521,8 m², paguar për procesin e legalizimit në shumën 984.199 lekë, me kontratë sipërmarrjeje⁹ nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.06.2012 dhe kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 20.08.2015, në bashkëpronësi me bashkëshorten me pjesë takuese 50% secili.*

Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të përdorua për blerjen e kësaj pasurie që kanë si origjinë fillestare (i) gjendjen pasurore dhe financiare të subjektit dhe ish-bashkëshortes, në momentin e krijimit të pasurisë bashkëshortore, apartament me sipërfaqe 73 m² në rr. “{***}”, Tiranë dhe (ii) gjendjen pasurore dhe financiare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe familjes së saj, duke qenë se 30.000 euro janë deklaruar si dhuratë nga prindërit e bashkëshortes gjatë shkëputjes nga trangu familjar në vitin 2010, Komisioneri Publik pretendon:

11.1 Nëhetimin e Komisionit ka mangësi përsa u takon të ardhurave që subjekti i rivlerësimit pretendon se janë krijuar duke pasur si burim të ligjshëm pjesëtimin e sendit të paluajtshtëm për shkak të zgjidhjes së martesës, e që lidhen si me interpretimin ligjor të detyrimit të subjektit të rivlerësimit në rastin konkret specifik (pasuri bashkëshortore në pjesë ideale), ashtu dhe me administrimin e rrethanave të faktit (mundësisë financiare).

11.2 Ka mungesë të një interpretimi shterues të ligjit lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave për vlerën prej 30.000 eurosh, të cilat bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se i janë dhuruar nga familja e saj dhe mospagimin e detyrimeve tatimore për këtë shumë, rrethanë e cila e bën të mangët qëndrimin e Komisionit për këto të ardhura.

11.3 Moskonsiderim të vlerës provuese të deklaratave noteriale që shpjegojnë mënyrën e likuidimit të të ardhurave nga shitja e apartamentit të subjektit në {***}, Lezhë, si dhe ai lidhur me dhurimin e shumës 30.000 euro, në vitin 2010, bashkëshortes së subjektit prej babait të saj,

⁹Në kontratën e sipërmarrjes është parashikuar mënyra e pagesës: (i) shuma 40.000 euro është paguar nga porositësi në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe (ii) pagesa e fundit do të bëhet në muajin maj 2013.

të cilat datojnë pas dorëzimit të deklaratës *vetting*. Në këto kushte, ato mbeten thjesht në nivel deklarativ dhe, si të tilla, nuk mund të konfirmojnë të vetme dhe jo në harmoni me prova të tjera, provueshmërinë që faktet e deklaruara në to kanë ndodhur realisht.

12. **Për pasurinë nr. 5:** *Autoveturë, Marka “Daimler Chrysler” Tipi (D) 211, me targë {***}, blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.12.2009. Vlera: 11.000 euro,* Komisioneri Publik pretendon se nga analizimi i dokumentacionit të sjellë prej subjektit të rivlerësimit, mbetet e diskutueshme aftësia financiare e vëllait të subjektit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shumën prej 4000 eurosh, të dhuruara subjektit prej tij në vitin 2009.

B. Vlerësimi për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

13. Komisioneri Publik, lidhur me konfliktin e interesit (rasti “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK) ka pretenduar se:
- (i) Gjykimi prej subjektit i çështjes me palë ndërgjyqëse, ndër të tjerë, edhe shoqërinë “{***}” ShPK, për të cilën prej Gjykatës Administrative të Apelit është dhënë vendimi nr. {***}, datë 20.5.2014, është një rast që nuk është hetuar dhe trajtuar nga ana e Komisionit, që merr rëndësi si për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit, ashtu dhe në vlerësimin e përgjithshëm të trikritereve, apo vlerësimit tërësor të çështjes.
- (ii) Lidhur me gjykimin prej subjektit të çështjes me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK, faktet e analizuar në arsyetimin e Komisionit, nuk përjashtojnë dijeninë e subjektit të një rrethane të tillë, marrëdhënie kontraktuale me bazë interesi pasuror të personit të lidhur, si dhe detyrimin e tij për të marrë masa në kushtet e neneve 72-73 të Kodit të Procedurës Civile, me qëllim shmangien në çdo rast të rrethanave apo arsyeve serioze mbi paanshmërinë e tij.
14. Lidhur me konfliktin e interesit në dukje, Komisioneri Publik, në drejtim të paanshmërisë së subjektit të rivlerësimit lidhur me gjykimin prej tij të çështjeve me palë administratën tatimore, organ në të cilin bashkëshortja e tij në periudha të ndryshme ka mbajtur role të rëndësishme drejtuese, në zbatim të nenit 75, pika 4¹⁰ e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 96/2016), ka pretenduar se sjellja e subjektit për të shmangur çdo rrethanë faktike të konfliktit të interesit apo atij në dukje, jo gjithnjë ka qenë e duhura dhe konstante, për disa raste ka qenë e vonuar dhe në disa raste ka munguar.
15. Për analizimin e denoncimeve nga publikutë analizuara në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, Komisioneri Publik pretendon senga një vlerësim i kujdesshëm i denoncimeve, konstatohen fakte dhe rrethana të cilat mund të marrin rëndësi në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të shërbejnë për vlerësimin tërësor të çështjes, duke u ndalur posaçërisht në rastet e mëposhtme.

15.1 Denoncimi i shtetas D. Sh., denoncimi i një grupi gjyqtarësh, si dhe denoncimi i shtetasit T. B.

15.2 Në analizë të çështjeve të denoncuar prej kantierit të ndërtimit të anijeve (reparti ushtarak 2010) {***}, Vlorë, lidhur me gjykimin në Gjykatën e Apelit Administrativ me palë paditëse K. K. dhe N. N., Komisioneri Publik pretendon senga aktet rezultojnë që vendimmarrja, përveç se duket se ka përdorur dy standarde, shkon përtej kërkimeve të palës

¹⁰ “Paansësia e magistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit [...]”.

paditëse, në shkelje të nenit 459 të K.PR.Civile, sipas të cilit këto kërkime do duhet të ishin konsideruar që kishin rënë në dekadencë¹¹.

15.3 Në denoncimin e paraqitur nga një grup gjyqtarësh, disa çështje si ajo lidhur me pretendimet për manipulim të shortit, rezulton të mos jenë hetuar.

15.4 Për sa i përket vendimit nr. {***}, datë 6.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Komisioneri Publik pretendon se Komisioni nuk ka vlerësuar paraprakisht duke mos arsyetuar në mënyrë shteruese, nëse mangësitë profesionale të konstatuara duhen veçuar dhe t'i shkojnë organit kompetent inspektues apo ato i shërbejnë dhe marrin rëndësi për vlerësimin në tërësi të çështjes për qëllim të procesit të rivlerësimit, që së bashku me problematikat dhe mangësitë e tjera, mund të sjellin një rezultat të ndryshëm për subjektin e rivlerësimit.

16. Denoncimet e mbërritura në Kolegj, pas dhënies së vendimit nr. 161, datë 18.06.2019, të Komisionit¹², për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit, në zbatim të përcaktimeve të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, i hetoi dhe ia nënshtroi debatit gjyqësor, duke u ndalur në denoncimet e sjella nga denoncuesit:

16.1 D. Sh., në të cilin është pretenduar se subjekti ka gabuar në vlerësimin e qëndrimeve të paditëses se ka shtuar objektin e padisë përgjatë gjykimit dhe përcaktimin e afateve të parashkrimit në mënyrë të gabuar për këtë rast.

16.2 K. D., në të cilin denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka gabuar në zbatimin e udhëzimeve të gjykatës më të lartë.

16.3 {***}({***}), në denoncimin e së cilës ngrihet shqetësimi se në aspektin procedural në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit nuk kanë gjetur zbatim konkluzionet e Gjykatës së Lartë për këtë çështje.

16.4 I. S., në të cilin denoncuesi pretendon se vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila nuk e ka shfuqizuar aktin administrativ "Leje legalizimi" nr. {***}, datë 27.05.2011, në favor të pronarit kufitar me paditësin, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin, për të cilin paditësi pretendon se mbart edhe elementet e një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, është një vendim i cili tregon zbatimin e gabuar të ligjit prej subjektit të rivlerësimit.

¹¹Në këtë drejtim, referuar edhe praktikës unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 3/2009, i cili shpreh se: "[...] Fryma që karakterizon Kodin e Procedurës Civile është përcaktimi si rregull i një roli kryesisht pasiv për gjykatën (me përjashtime të mirëpërcaktuara kryesisht sa i përket fazës së hetimit gjyqësor). Konform nenit 6 të K.Pr.Civile, gjykata kur gjykon mosmarrëveshjet e ndryshme duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet [...]. Parimi i përputhjes midis asaj që kërkohet dhe asaj për të cilën shprehet gjykata është parim bazë i së drejtës procedurale civile, pasi nuk mund të ketë ultra petita partium".

¹²Denoncimet e administruara në Kolegj gjithsej kanë qenë:

1. nr. {***} prot., datë 20.05.2019- nga denoncuesja D. Sh.;
2. nr. {***} prot., datë 19.06.2019 - nga denoncuesi S. H.;
3. nr. {***} prot., datë 19.09.2019 - nga denoncuesi K. D.;
4. nr. {***} prot., datë 15.10.2019 - nga denoncuesi K. B.;
5. nr. {***} prot., datë 17.10.2019 (përcjellë nga KPK) - denoncuesi K. B.;
6. nr. {***} prot., datë 24.10.2019 - nga {***}({***});
7. nr. {***} prot., datë 27.11.2019 (përcjellë nga KPK) - {***};
8. nr. {***} prot., datë 29.01.2020 (përcjellë nga KPK) - nga denoncuesi H. T.;
9. nr. {***} prot., datë 18.09.2020 - nga denoncuesi K. M.;
10. nr. {***} prot., datë 10.12.2020 - nga denoncuesja Gj. T.;
11. nr. {***} prot, datë 13.01.2021 - nga denoncuesi I. S.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

17. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Legjitimimi i ankuesit

18. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

19. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 161, datë 18.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke qenë se ai është ushtruar nga Komisioneri Publik, prej Kolegjit kryhet në seancë gjyqësore publike. Përgjatë seancave gjyqësore publike të zhvilluara në Kolegj, Komisioneri Publik, në mbështetje të ankimit të tij, ka kundërshtuar vendimin e Komisionit në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë dhe kriterit të aftësive profesionale duke kërkuar nga Kolegjikryerjen e hetimeve të mëtejshme, rezultatet e të cilave mbështetën kërkimin përfundimtar për një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni të këtyre kriterëve. Subjekti i rivlerësimit Kastriot Selita ka prapësuar pretendimet e Komisionerit duke analizuar në mbështetje të këtyre prapësimeve provat e paraqitura prej tij e të administruara prej Kolegjit në seancat gjyqësore publike të zhvilluara, pas çeljes së hetimit gjyqësor.
20. Kolegji, në përgjigje të kërtimeve të Komisionerit Publik, kërkit të subjektit të rivlerësimit dhe nevojave të trupës gjyqësore për marrje të provave të reja, çeli hetimin gjyqësor duke kryer një veprimtari hetimore që u përmbyll me marrjen me cilësinë e provës të akteve të përcjella në Kolegj prej institucioneve shtetërore dhe atyre të dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji

I. Kontrolli i pasurisë

21. Në lidhje me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik i cili në tërësinë e tij ka të bëjë me verifikimin e burimeve të financimit që kanë shërbyer për blerjen prej subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij të pasurisë nr. 1, apartament me sipërfaqe 124,91 m², tek “{***}”, Tiranë, të blerë më datë 15.12.2015, në vlerën 177.370 euro, Kolegji mori në analizë të gjitha pretendimet e ngritura në ankim dhe përgjatë debatit gjyqësor nga Komisioneri Publik, si dhe

shqyrtoi të gjitha prapësimet dhe provat e paraqitura lidhur me këtë shkak nga subjekti i rivlerësimit si në Komision, ashtu edhe në gjykimin në Kolegj, duke konstatuar sa vijon.

21.1 Për blerjen e pasurisë apartament prej 124,91 m² te pallati “{***}”, Tiranë, subjekti dhe bashkëshortja si burim origjinar të krijimit të të ardhurave të cilat më pas kanë shërbyer për financimin e transaksionit të krijimit të kësaj pasurie, rezulton se kanë pasur të ardhurat e përfituara nga shitjanë vitin 2008, në vlerën 220.000 euro, të objektit dykatësh në pronësi të familjes K.¹³, të ndodhur në {***}, Tiranë.

Referuar dokumentacionit bankar, z.A.K.¹⁴, në datën 31.07.2008 ka derdhur në bankën "Raiffeisen Bank" (cash në sportel) shumën 1.902.430 lekë në favor të agjentit tatimor, zyra e ZRVPP Tiranë, që i korrespondon detyrimit tatimor të përlllogaritur prej zyrës dhe të vjelë prej saj për efekt të kontratës së shitjes së kësaj banese. Kjo shumë monetare është përdorur prej bashkëshortes së subjektit për blerjen e pasurive të tjera, të cilat gjithashtu janë shitur më pas prej saj duke mundësuar përfitimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer në finale si burim për krijimin e pasurisë apartament, të deklaruar prej subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, si më sipër përmendur.

Sipas deklarimeve të subjektit, bashkëshortja e tij ka përfitur nga vlera e shitjes së banesës në {***}, shumën prej 61.758 eurosh të cilën e ka përdorur për blerjen si pronare e vetme e apartamentit me sipërfaqe 94,6 m², në adresën rr. “{***}”, Pallatet “{***}”, Tiranë, me anë të kontratës nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.12.2008, të cilin më pas e ka shitur me anë të kontratës nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 21.10.2015, për çmimin prej 110.000 eurosh, duke financuar me këto të ardhura blerjen e pasurisë në bashkëpronësi me subjektin, të përshkruar më lart.

21.2 Referuar ankimit të Komisionerit Publik, rezulton se në të ngrihen pretendime në drejtim të: **(i)** përcaktimit të kostos dhe kohës së ndërtimit të banesës së familjes K. në {***}; **(ii)** verifikimit të mundësisë financiare në kuptim të të ardhurave të ligjshme, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 19 e ligjit nr.84/2016 të familjes K. për ndërtimin banesës në {***}; **(iii)** përcaktimit të shpenzimeve të familjes K. përgjatë periudhës së ndërtimit të banesës në {***} për jetesë, qëndrimin me qira e mobilimit të kësaj pasurie; **(iv)** vlerësimit tërësor në konkluzion të justifikimit me burime të ligjshme të financimit të kësaj pasurie.

21.3 Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, Kolegji analizoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, mbështetur në provat e administruara përgjatë hetimit administrativ, por edhe ato të administruara përgjatë gjykimin në Kolegj, duke arsyetuar si më poshtë.

21.4 Pasi analizoi shkakun e ankimit që lidhet me kontestimin e vlerës së kostos së ndërtimit të banesës së familjes K. në {***} që është reflektuar në analizën financiare të Komisionit, krahasuar me vlerën e kostos që rezulton nga aktet zyrtare të administruara, Kolegji çmoi se Komisioni ka aplikuar drejt koston e ndërtimit që pasqyrohet në aktet e sjella prej subjektit e që përfaqësojnë vlerat e parashikuara e të konkluduara për ndërtimin, prej shoqërisë “{***}” ShPK, nëpërmjet preventivit e situacioneve përkatëse.

21.5 Përgjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, për të provuar kostot e ndërtimit të banesës së familjes së origjinës së bashkëshortes të përbërë nga 2 kate me papafingo, me sipërfaqe 268,2 m², të ndodhur në Komunën {***}, {***}, ka pretenduar konsiderimin si provë *së pari*, të deklaratës fillestare të pasurisë të vitit 2006 të bashkëshortes së tij, e cila, që prej këtij viti, ka qenë subjekt deklarues, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe

¹³Familja e origjinës së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. M. K.

¹⁴Babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, (në vijim “ligji nr. 9094/2003”); si edhe së dyti, ka paraqitur një sërë aktesh tekniko-ligjore¹⁵ të kohës që është ndërtuar ky objekt, si: leje ndërtimi, projekt teknik, preventiv punimesh, situacion punimesh e fatura shitje të shoqërisë ndërtuese. Sipas këtyre deklarimeve në Komision dhe përgjatë gjyqimit në Kolegj, kostoja e ndërtimit të banesës ka qenë në vlerën 4.754.112 lekë dhe 245.888 lekë të përdorura për shpenzimet në arkitekturë dhe infrastrukturë, në total një vlerë prej 5.000.000 lekësh.

21.6 Në ankim, Komisioneri Publik ka pretenduar se nëse prej Kolegjit do të vlerësohet të kryhet një analizë e re financiare, referuar kostos së ndërtimit, të përlllogaritur bazuar në legjislacionin në fuqi¹⁶, prej 7.241.400 lekësh, zëri i përlllogaritur “pasuri” në analizën e Komisionit, do të rritej me 2.487.288 lekë, çka do të çonte në një rezultat të ndryshëm nga ai i Komisionit, në lidhje me mbulimin me të ardhura të ligjshme të krijimit të kësaj pasurie. Në gjykimin e zhvilluar në Kolegj, Komisioneri Publik ngriti pretendimin se referuar edhe rekomandimit të ONM-së, për të mbetet e paqartë përse në analizën financiare të kryer nga Komisioni është reflektuar si kosto ndërtimi vlera 4.754.112 lekë, kur nga aktet e administruara në dosje reflektohen vlera më të larta lidhur me kostot e banesës në {***}.

21.7 Lidhur me këtë shkak, subjekti i rivlerësimit i propozoi duke u shprehur se referimi të kostoja minimale e ndërtimit apo tevlera e përlllogaritur nga punonjësi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në koston minimale sipas Entit Kombëtar të Banesave (EKB) në lidhje me vlerën e paguar për ndërtimin e kësaj shtëpie, nuk është i saktë përse kohëekziston preventivi, kontrata e sipërmarrjes, faturat tatimore të shitjes dhe situacionet përkatëse¹⁷ (të nënshkruara nga palët pjesëmarrëse në transaksion), sipas të cilave vlera prej 4.754.112 lekë është vlera e ndërtimit të shtëpisë private dhe çdo vlerë tjetër e përlllogaritur nuk mund të përfaqësojë vlerën e cila është paguar për ndërtimin e kësaj shtëpie banimi. Subjekti ka paraqitur si provë, në mbështetje të këtij qëndrimi, edhe kopjen e deklaratës fillestare të deklaramit të pasurisë, të vitit 2003, të babait të bashkëshortes, z. A.K., tek e cila vlera e banesës në {***} është deklaruar po ashtu 5 milionëlekë.

21.8 Në analizë të kësaj situate faktike, bazuar në aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, nga korrespondenca me zyrën vendore të regjistrimit të pasurive dhe kompaninë “{***}” ShPK, Kolegji konstatoi se ka mospërputhje midis vlerës së punimeve sipas projektit, preventivave dhe lejes së ndërtimit¹⁸ dhe asaj mbi të cilën janë përlllogaritur detyrimet tatimore¹⁹ në momentin e shitjes së kësaj pasurie nga familja K. në vitin 2008. Në këto kushte, Kolegji me vendimin e ndërmjetëm të datës 01.04.2021, vendosi të kërkojë informacion nga

¹⁵i) Preventivi i punimeve në lidhje me ndërtimin e kësaj shtëpie në shumën 4.754.112 lekë, sipas zërave përkatës të punimeve. ii) Kontrata noteriale e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr {***} kol., datë 06.02.2004, me shoqërinë ndërtuese “{***}” ShPK. iii) Fatura tatimore e shitjes nr. {***}, datë 30.12.2003, me vlerë totale 3.188.562 lekë, si dhe situacioni përkatës i punimeve, fatura tatimore e shitjes nr. {***}, datë 09.07.2004, me vlerë totale 1.565.550 lekë, si dhe situacioni përfundimtar i punimeve. Në lidhje me këto fatura, është specifikuar se është paguar shuma 4.377.090 lekë deri në datën 31.12.2003, si dhe shuma 377.022 lekë në datën 08.07.2004.

¹⁶Si legjislacion në fuqi, Komisioneri Publik konsideron kostotmesatare të ndërtimit të publikuara në faqen zyrtare në internet të Entit Kombëtar të Banesave për kohën kur është ndërtuar banesa në {***} dhe vlerës së përcaktuar në praktikën e sjellë nga ZRVPP Tiranë.

¹⁷Në mbështetje të këtij qëndrimi, subjekti ka referuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, përkatësisht në vendimin (JR) 15/2019, tek i cili Kolegji ka shprehur se për përlllogaritjen e kostove të banesës: “Referimi që Komisioni ka bërë të kostoja mesatare e ndërtimit, e përcaktuar ndër vite prej EKB-së, çmohet si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi, të sjellë prej subjektit të rivlerësimit”.

¹⁸Sipas të cilave vlera e ndërtimit të banesës në {***}, 2 kate + papafingo, është përafërsisht 4,7 milionë lekë.

¹⁹Sipas praktikës së sjellë nga ZRVPP Tiranë, vlera e regjistrimit të kësaj prone ka qenë përafërsisht 7,2 milionë lekë.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) lidhur me metodologjinë e përdorur prej ish-ZRVPP Tiranë, për përcaktimin e vlerës së tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e banesës dykatëshe në ish-pronësi të familjes së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në momentin e kalimit të pronësisë së kësaj pasurie nga familja K. te blerësi, z. A. M., nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 09.06.2008.

21.9 Në përgjigje të kësaj kërkesë, ASHK²⁰ sqaroi se, duke qenë se banesa në {***} është ndërtuar mbi bazën e lejes së ndërtimit dhe nuk ka pasur një kontratë paraardhëse blerjeje, si dhe është regjistruar në vitin 2006, vlera mbi të cilën janë bërë llogaritjet për të përcaktuar vlerën e tatimit që duhej të paguhej, është 7.224.140 lekë dhe është llogaritur duke iu referuar metodologjisë së përcaktuar në udhëzimin e përbashkët nr. 9, datë 26.02.2008, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe shtojcat e tij.

21.10 Lidhur me këtë shkak ankimi, referuar situatës faktike dhe akteve të administruara, Kolegji arsyeton se përcaktimi i vlerës së kostos së ndërtimit sipas akteve të sjella nga subjekti, është veprimi i duhur për përlllogaritjen e kësaj vlere në kuptim të analizimit të mundësive financiare të familjes për të përballuar ndërtimin. Vlera e pretenduar nga subjekti se përfaqëson koston e ndërtimit të banesës, gjen pasqyrim si e tillë në dokumentacionin teknik të përpiluar në kohën e ndërtimit sipas preventivit të hartuar nga shoqëria ndërtuese dhe është e njëjta edhe me atë që pasqyrohet në situacionin e punimeve të përpiluar po nga e njëjta shoqëri²¹. Duket se nga këto dy akte teknike, vlera e kostos së ndërtimit ka rezultuar të jetë e njëjta në përfundim të punimeve me atë që ishte parashikuar e llogaritur në fillim të saj. Gjithashtu, nëpërmjet dokumentacionit financiar²², rezulton se është paguar e njëjta vlerë e pasqyruar në situacionin e punimeve. Të njëjtën vlerë të kostos së ndërtimit rezulton se kanë deklaruar subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja në deklaratën e para fillimit të detyrës në vitin 2006, si edhe babai i bashkëshortes në deklaratën fillestare si subjekt deklarues në vitin 2003. Të gjitha këto prova, të cilat plotësojnë kriteret e nenit 49, pika, 1 germa “a” dhe nenit 32, pika 5 e ligjit nr.84/2016, sjellin informacion mbi vlerën e kostos së pretenduar nga subjekti, prej 4.754.112 lekësh, dhe nuk rezulton ndonjë akt tjetër i cili të provojë apo sjellë inidicie se vlera e paguar për ndërtimin e banesës ka qenë më e madhe. Vlera e sjellë në vëmendje të Kolegjit prej pretendimit të Komisionerit Publik pasqyron një vlerë hipotetike të konsideruar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë (ZVRPP Tiranë), për përlllogaritjen e vlerës së tatimit që duhej të paguhej në kohën e shitjes së banesës, i aplikueshëm mbi diferencën e çmimit të shitjes me atë të blerjes, në mungesë të këtij të fundit. Ky referim i zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, jo vetëm nuk u referohet akteve shkresore që tregojnë vlerën e kostos së ndërtimit, por edhe referon në mënyrë të gabuar te viti 2006, si vit ndërtimi i banesës për efekt të llogaritjes së çmimit për metër katror sipas standardeve të EKB-së, ndërkohë që rezulton se banesa është ndërtuar në vitet 2003-2004.

21.11 Kolegji, në vijim edhe të logjikës së përdorur në jurisprudencën e mëparshme të tij²³, çmon se në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur mjaftueshëm prova për të provuar pretendimet e tij për koston e ndërtimit të kësaj banese, për pasojë vlera e cila do të konsiderohet në analizën financiare do jetë ajo e deklaruar nga subjekti: 4.754.112 lekë.

²⁰Me shkresën nr. {***} prot., datë 26.4.2021.

²¹Preventiv i punimeve në lidhje me ndërtimin e kësaj shtëpie, referuar praktikës së sjellë nga ZRVPP Tiranë, gjendet bashkëlidhur kontratës së sipërmarrjes me nr. {***} rep., e nr {***} kol., datë 06.02.2004, të lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK në rolin e sipërmarrësit dhe z. A.K. në rolin e investitorit.

²²Faturat e shitjes nr. {***}, datë 30.12.2003, me vlerë 3.188.562 lekë, si dhe situacioni përkatës i punimeve, si dhe faturës tatimore të shitjes nr. {***}, datë 09.07.2004, me vlerë 1.565.500 lekë.

²³Vendimi i Kolegjit (JR) nr.15/2019, paragrafi 32.

21.12 Në ankim, Komisioneri Publik ka pretenduar se gabimisht në analizën financiare të kryer nga Komisioni, lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë banesë në {***}, me sipërfaqe 268,2 m², janë përfshirë të ardhurat e familjes K. për periudhën 1997-2004. Sipas këtij pretendimi, Komisioni duhej të kishte konsideruar dhe reflektuar në analizën financiare të dhënat e pasqyruara në shkresë shoqërisë “{***}” ShPK me nr. {***} prot., datë 07.12.2018, sipas së cilës pagesa për ndërtimin e objektit, është kryerme shumën 4.377.090 lekë të paguar deri më datë 31.12.2003 dhe pjesa tjetër e mbetur, prej 377.022 lekësh, është paguar deri më 08.07.2004.

21.13 Pretendimi i Komisionerit në lidhje me periudhën kohore, e cila duhej përfshirë në analizën financiare të familjes K. në funksion të përcaktimit të burimeve financiare të përdorura nga kjo familje për përballimin e kostos së ndërtimit të banesës së saj në {***}, u pranua edhe nga subjekti i rivlerësimit, i cili në gjykim pohoi se pagesat për ndërtimin e banesës ishin bërë sipas datave dhe vlerave që përcaktoheshin në situacionet e shoqërisë dhe faturat tatimore të shitjes bashkëlidhur atyre²⁴. Në këto kushte, duke konsideruar jo vetëm të dhënat që vijnë nga aktet shkresore të përmendura më lart, situacion dhe fatura tatimore, por edhe duke marrë në konsideratë pohimin e subjektit të rivlerësimit në seancë gjyqësore, Kolegji çmoi që në analizën financiare të përdorë vlerat e pasqyruara në pagesat e kryera për shoqërinë “{***}” ShPK, si dhe bazuar në datat e kryerjes së këtyre pagesave, të fragmentojë analizën financiare të familjes K., për qëllime të këtij procesi në dy periudha: nga viti 1996 deri më 31.12.2003 për vlerën e pasurisë së shpenzuar në 4.377.090 lekë; dhe nga 01.01.2004 – 08.07.2004 për vlerën e shpenzuar për këtë pasuri prej 377.022 lekësh.

21.14 Përgjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit prapësoi pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me burimet e ligjshme të familjes K., duke u shprehur se të gjitha veprimet financiare lidhur me ndërtimin e kësaj shtëpie janë kryer në periudhën 2003-2004 dhe janë deklaruar në DVP-në e A. K. të vitit 2004²⁵, si dhe nga bashkëshortja e tij në DVP-në fillestare të vitit 2006. Lidhur me këtë pretendim të Komisionerit Publik dhe shpjegimit të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me shkakun e ankimit që konteston të ardhurat e ligjshme që duhet të ishin llogaritur për familjen K. në funksion të përballimit të shpenzimeve për ndërtimin e pasurisë banesë në {***}, Kolegji mori në shqyrtim e analizoi ato të ardhura të cilat ishin objekt kundërshtimi e diskutimi nga ankimi i Komisionerit Publik dhe që lidhen kryesisht me të ardhurat e krijuara nga bashkëshortja e subjektit prej fondacionit “{***}” Albania. Gjithashtu Kolegji kreu një vlerësim ligjor për të ardhurat e përfituara prej familjes K. prej shitjes së një apartamenti në Peshkopi e dhënies së tyre hua në firmat piramidale, të cilat gjithashtu kanë shërbyer për financimin e ndërtimit të banesës. Kolegji përfshiu në analizë të gjitha të ardhurat e tjera të llogaritura nga Komisioni për të cilat nuk rezultuan shkaqe të ngritura në ankim.

21.15 Në përgjigje të shkakut të ankimit që lidhet me verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave të përdorura prej familjes së origjinës së bashkëshortes së subjektit, të cilat kanë shërbyer për ndërtimin e banesës në {***} në vitin 2004, Kolegji analizoi burimet e financimit të përmendura nga vetë subjekti se kanë shërbyer si të tilla duke vlerësuar mundësinë e krijimit të të ardhurave të ligjshme në drejtim të kënaqjes së kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr.84/2016, meqenëse nga këto pasuri kanë

²⁴Në shpjegimet e dhëna prej subjektit në seancën gjyqësore të datës 17.03.2021.

²⁵Në shpjegimet e dhëna në seancën gjyqësore të datës 17.03.2021, subjekti i rivlerësimit për të provuar të ardhurat e ligjshme të familjes K., ka paraqitur në cilësinë e provës së re Deklaratën Fillestare të Deklarimit të Pasurisë, të datës 22.03.2004, të babait të bashkëshortes së subjekti, z. A.K.

rrjedhur pasuritë e bashkëshortes së subjektit, person i lidhur për efekt të këtij procesi që mbart detyrimin njësoj si subjekti për provimin e ligjshmërisë së burimeve që kanë krijuar pasuritë e saj, aq më shumë kur këto pasuri të krijuara prej saj kanë shërbyer si burime për krijimin e pasurisë së vetë subjektit të rivlerësimit.

21.16 Lidhur me shkakun e ankimit në drejtim të provueshmërisë dhe ligjshmërisë së të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja e subjektit, znj. M. K., në shumën 1.630.035 lekë nga fondacioni "{***}" Albania, për vitet 2002-2004, të cilat janë pranuar nga Komisioni se kanë shërbyer si një nga burimet e të ardhurave për financimin e ndërtimit të banesës në {***}, Kolegji, pasi analizoi dhe shqyrtoi çdo provë e prapësim të paraqitur rreth këtij shkak, arrin në konkluzionin se të ardhurat e pretenduara gëzojnë vetëm pjesërisht statusin e të ardhurave të ligjshme në kuptim të ligjit.

21.17 Në vendimin e Komisionit është pranuar se në periudhën 1997-2004, anëtarët e familjes së z. A.K. kishin realizuar të ardhura neto në shumën prej 6.465.888 lekë. Në këtë shumë totale, kontributi i bashkëshortes së subjektit ka qenë në shumën 4.565.000 lekë, të përfituar nga puna e saj e kryer përgjatë viteve 1999-2004. Komisioni në vendim ka arsyetuar se për OJF-në "{***}" Albania, pranë së cilës është deklaruar se ka punuar bashkëshortja e subjektit për periudhën 2002-2004, nuk mund të gjendeshin të dhëna në lidhje me pagën dhe tatimin për të ardhurat për individë të veçantë të punësuar te ky fondacion para dhjetorit të vitit 2011. Nga verifikimi i kryer në zyrën e kontabilitetit të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë (DRT Tiranë), rezultonte se fondacioni "{***}" Albania ka kryer pagesa tatimi në burim për shërbime konsulence në periudhën 2002-2004, gjithsej në shumën 181.115 lekë. Sipas arsyetimit të Komisionit, kjo vlerë e paguar si tatim përfaqëson 10% të të ardhurave prej 1.811.150 lekë të deklaruara nga subjekti si të ardhura nga puna e bashkëshortes në këtë fondacion. Nisur nga kjo predispostë, pavarësisht se në aktet e përcjella nga DRT Tiranë²⁶, nuk specifikohen individët për llogari të të cilëve janë bërë pagesat në burim të tatimit, Komisioni ka pranuar se këto pagesa i përkasin bashkëshortes së subjektit, dhe duke zbritur nga shuma prej 1.811.150 lekësh të deklaruara, shumën prej 181.115 lekësh të mbajtur si tatim, ka konkluduar se diferenca prej 1.630.035 lekësh, është shuma neto e përfituar prej bashkëshortes, e cila duhet të njihet si e ardhur e ligjshme në analizën financiare. Për të ardhurat e përfituara nga punësimi në fondacionin "{***}" Albania, përgjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar kontratën e shërbimit "Service Agreement" të datës 15.01.2004 me këtë fondacion, sipas së cilës specifikohet se të ardhurat mujore ishin në vlerën 63.250 lekë.

21.18 Komisioneri Publik në ankim ka pretenduar se nga gjendja e akteve në dosje nuk rezulton të jetë paraqitur dokument justifikues për të vërtetuar ofrimin e shërbimit nga znj. M. K. pranë fondacionit "{***}" Albania për periudhën përkatëse dhe se gjithashtu nuk rezulton i provuar pagimi i detyrimit tatimor prej saj, siç parashikohet në kontratën e shërbimit "Service Agreement" të datës 15.01.2004, lidhur mes fondacionit dhe bashkëshortes së subjektit. Në këto kushte, ka mbetur i papërbushur detyrimi kushtetues dhe ligjor i hetimit të justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të ligjshme në shumën 1.630.035 lekë, referuar pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

21.19 Në gjykim, lidhur me pretendimet e Komisionerit Publik për të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij nga puna në fondacionin "{***}" Albania, subjekti ka prapësuar *së paripretendimin* në lidhje me kohën përgjatë së cilës bashkëshortja e tij ka punuar pranë këtij fondacioni dhe provueshmërinë e ekzistencës së kësaj marrëdhënieje, si dhe *së dyti* lidhur me përbushjen e detyrimit për pagimin e tatimit për këto të ardhura të cilat, sipas pretendimit të tij

²⁶Me shkresën nr. {***} prot., datë 20.11.2018.

e leximit të provave të paraqitura prej vetë atij, i takonte dhe ishte paguar prej fondacionit në burim. Sipas pretendimit të subjektit në gjykim, shërbimet e specifikuar në kontratën e vitit 2004, kanë qenë të njëjta me shërbimet e ofruara edhe në vitet 2002-2003, fakt i cili provohet nga veprimet bankare që bashkëshortja e tij ka kryer në atë periudhë në llogaritë bankare të drejtorëve të këtij fondacioni²⁷. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti paraqiti në Kolegj, në cilësinë e provës²⁸, një sërë aktesh, kryesisht *statement*-e bankare, që dokumentojnë veprimet e kryera nga bashkëshortja e tij për llogari të fondacionit dhe si pjesë e aktivitetit të punës, si dhe një letër reference e fundit të vitit 2003, të lëshuar për personin e lidhur nga drejtori i fondacionit, z. J. C.

21.20 Subjekti, lidhur me detyrimin për të paguar tatimin në burim për shërbimin e ofruar nga bashkëshortja te “{***}” Albania, ka shpjeguar se: “Neni 33 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ka përcaktuar se personi i regjistruar (në këtë rast “{***}” Albania) ka pasur detyrimin ligjor të llogaritjes, mbajtjes dhe derdhjes së shumës së tatimit në burim për llogari të organit tatimor. Ky qëndrim, sipas subjektit, shprehet qartë edhe në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT)²⁹ nr. {***} prot., datë 19.08.2004, me lëndë “Përgjigje shkrese”, drejtuar subjektit “Dhoma Amerikane e Tregtisë”, në të cilën pasqyrohet se: *Për pagesat që Dhoma mund t’u bëjë individëve të ndryshëm (jo të punësuar te Dhoma) për shërbime që ata i bëjnë Dhomës [...] apo shërbime të tjera (si konsulenca etj.), në bazë të ligjit të sipërpërmendur “Për tatimin mbi të ardhurat”, Dhoma duhet të mbajë tatim në burim në masën 10% të pagesës së të ardhurave bruto. Ky është detyrim tatimor i përfituesit të të ardhurave, por meqenëse ky i fundit nuk është i regjistruar në organet tatimore, ligji detyron pagesin (Dhomën) që të mbajë tatimin në burim dhe ta derdhë atë për llogari të organit tatimor ku Dhoma është e regjistruar.*

21.21 Komisioneri Publik i qëndroi pretendimit të tij se detyrimi për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga puna pranë fondacionit i përkiste bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, mbështetur edhe në parashikimin kontraktor përkatës, duke ushprehur se korrespondenca e organeve tatimore me subjekte të tjera që nuk janë pjesë e këtij procesi, është jorelevante për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Gjithashtu, sipas Komisionerit, nga një analizë matematikore dhe logjike e shifrave që përfaqësojnë pagën e pretenduar të bashkëshortes së subjektit dhe tatimit të paguar prej fondacionit, duket se rezultojnë ajo që subjekti pretendon për të ardhurat e përfituara, si edhe për faktin se detyrimi tatimor është paguar prej punëdhënësit. Për më tepër, rezultojnë se shumica e tatimit në burim që është paguar nga “{***}” Albania, në vitin 2004, në total në shumën 61.563 lekë, nuk korrespondon me detyrimin që ka lindur nga kjo kontratë shërbimi (63.250 lekë në muaj x 12 muaj = 759.000 lekë, ku vlera e tatimit në burim duhet të ishte 75.900 lekë për vitin 2004), si dhe është më e ulët se vlera e tatimit në burim për të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e subjektit gjatë vitit 2004.

²⁷z.M. H.dhez.J. C.

²⁸Në seancën gjyqësorë të datës 17.03.2004, subjekti paraqiti: i) *statement-in* e lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank për tërheqjet nga bashkëshortja e subjektit në periudhën nga 27.02.2003 deri më 28.12.2004 në llogaritë bankare të “{***}” Albania, dhe të drejtuesit të tij, z. M. H., për të realizuar shërbimet financiare që ajo kishte marrë përsipër sipas kontratës së saj; ii) shkresën e Bankës Intesa Sanpaolo, e cila vërteton tërheqjet me çek nga bashkëshortja në llogarinë bankare të përbashkët të drejtorit të zyrës, z.M. H. dhe z. J. C. (kur); iii) letrën e rekomandimit nga drejtori i zyrës, z. H., në muajin prill 2004 për znj. M. K., dhe një printim të e-mail-it të z. H. të datës 19.12.2004; iv) vendimin e gjykatës nr.{***}datë 21.04.2004, i cili ka të bëjë me emërimet e drejtorëve të zyrës sipas periudhave përkatëse.

²⁹Kjo shkresë u paraqit prej subjektit të rivlerësimit si provë në seancën gjyqësore të zhvilluar në Kolegj më datë 17.03.2021.

21.22 Kolegji, pasi mori në analizë pretendimet e Komisionerit Publik dhe propësimet e subjektit, si edhe shqyrtoi provat e administruara përgjatë hetimit administrativ, si dhe ato të paraqitura prej subjektit përgjatë gjykimit në Kolegji, arriti në konkluzionin se deklarimet e subjektit në lidhje me këto të ardhura në kuptim të plotësimit të kriterit kushtetues të parashikuar nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si edhe neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, provohen pjesërisht vetëm për sa u përket të ardhurave të përfituara në vitin 2004, në vlerën prej 554.067 lekësh.

21.23 Kolegji, pasi shqyrtoi përmbajtjen e akteve shkresore të administruara në proces, arriti në konkluzionin se subjekti dështoi të provojë të gjitha faktet e deklaruara prej tij në lidhje me këtë çështje. Nga analiza e të dhënave që rezultuan prej akteve të administruara, konstatohet se kagjurmë që tregojnë se bashkëshortja e subjektit ka qenë në një marrëdhënie ndërvepruese me fondacionin “{***}” Albania, përgjatë vitit 2003. Kjo rrethanë evidentohet nga *statement*-i bankar i lëshuar nga Banka Intesa San Paolo, i cili pasqyron lëvizjet në llogaritë bankare të fondacionit për këtë vit, në të cilat ka disa tërheqje shumash në *cash* prej bashkëshortes së subjektit. Kjo e dhënë nuk evidentohet nga *statement*-et bankare të lëshuara nga e njëjta bankë për vitin 2002, pavarësisht faktit të pranuar se fondacioni ka qenë i regjistruar si person juridik dhe më pas ka fituar personalitet juridik që në këtë vit, dhe se shtetasit e huaj, z. M. H. dhe z. J. C., kanë qenë drejtorë të tij dhe se kanë kryer veprime në llogarinë në emër të tyre për nevoja të administrimit të vetë fondacionit. Pretendimi i subjektit se faktin që bashkëshortja ka qenë në të njëjtën marrëdhënie me fondacionin edhe në këtë vit, e provon leximi logjik i tekstit të dërguar prej z. H. në prill të vitit 2004 si një rekomandim punësimi për bashkëshorten e subjektit, gjendet i pamjaftueshëm për Kolegjin për të provuar faktin e pretenduar, marrëdhënien e punësimit/shërbimit dhe aq më tepër të ardhurat e përfituara prej saj. Në këtë vit nuk rezulton gjithashtu që fondacioni të ketë bërë ndonjë pagesë për tatime në burim për individë të cilët kanë ofruar shërbime konsulence për të.

Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit se edhe në vitin 2002, në të cilin nuk gjendet asnjë gjurmë dokumentare që të provojë marrëdhënien, pagën apo pagimin e detyrimeve tatimore, bashkëshortja ka ofruar shërbime ndaj fondacionit me të njëjtat kushte si ato të parashikuara në kontratën e vitit 2004, të paraqitur prej subjektit, vlerësohen prej Kolegjit se mbeten në nivel deklarativ dhe të paprovuara.

21.24 Në vijim të analizës së kësaj çështjeje në vitin 2003, Kolegji konstaton se përveç faktit se nga *statement*-i bankar rezulton se bashkëshortja e subjektit ka tërhequr para nga llogaria e hapur në emër të drejtorëve të fondacionit, rezulton se fondacioni sipas shkresës përcjellë nga DRT Tiranë nr. {***} prot., datë 20.11.2018, ka paguar detyrimin për tatim të mbajtur në burim në këtë vit, në vlerën 119.552 lekë, pa përcaktuar individët të cilët ishin ofrues të shërbimit. Edhe për këtë vit, subjekti pretendon se bashkëshortja ka ofruar të njëjtin shërbim kundrejt të njëjtës pagesë si ajo e pasqyruar në kontratën e shërbimit të vitit 2004. Sipas kësaj kontrate, bashkëshortja e subjektit do të paguhej me një pagë me pagesë mujore 63.250 lekë. Në analizë të vlerës së mbajtur në burim për tatimin nga fondacioni për vitin 2003, rezulton se ajo nuk i korrespondon vlerës së pagës së pretenduar nga subjekti se ka përfitur bashkëshortja e tij këtë vit sipas pagës së parashikuar në kontratën e vitit 2004, por një vlerë më të lartë (99.627 lekë), rrethanë që të çon në arsyetimin se fondacioni ka pasur edhe punonjës të tjerë në të njëjtën marrëdhënie, të cilët edhe mund të kenë qenë përfituesit e të gjithë shumës për të cilën është paguar tatim, por që në çdo rast, kjo e dhënë nuk provon të gjithë pretendimin e subjektit dhe as mund të përcaktojë se në çfarë raporti e provon atë.

21.25 Në këto rrethana, Kolegji arriti në konkluzionin se edhe për sa u përket të ardhurave të pretenduara se janë fituar në vitin 2003 nga fondacioni “{***}” Albania, prej bashkëshortes së subjektit, ato mbetën të paprovuara dhe në nivel deklarativ qoftë për sa i përket vetë marrëdhënies së punës/shërbimit dhe shpërblimit të marrë prej saj për sa kohë që nuk ekziston një kontratë që provon këto elemente, qoftë për sa i përket pagimit të detyrimit tatimor për këto të ardhura, të cilat, referuar vlerave, nuk përkojnë me ato që janë paguar nga fondacioni. Për këto arsye, Kolegji çmon se subjekti dështoi të provojë edhe fitimin e këtyre të ardhurave në kuptim të kriterëve kushtetuese dhe ligjore për ligjshmërinë e të ardhurave në këtë proces.

21.26 Kolegji, në vlerësim të fakteve që rezultuan nga provat e administruara, arriti në konkluzionin se subjekti provoi deklarimet e tij në lidhje me të ardhurat nga puna e bashkëshortes në fondacionin “{***}” Albania në vitin 2004. Për këtë vit, rezultojnë të dhënat si vijon: (i) bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontratën e shërbimit “Service Agreement” të datës 15.01.2004 me këtë fondacion, sipas së cilës specifikohet se të ardhurat mujore ishin në vlerën 63.250 lekë; (ii) nga *statement*-i i bankar i lëshuar prej Bankës “Intesa San Paolo”, rezulton se bashkëshortja ka kryer tërheqje të shumave në *cash* prej llogarisë së fondacionit dhe të drejtuesve të tij; (iii) fondacioni ka paguar detyrime tatimore të mbajtura në burim për individë që kanë ofruar shërbime konsulence shumë prej 61.563 lekësh, e cila përfaqëson pothuajse vlerën korresponduese të tatimit që duhej mbajtur referuar pagës së bashkëshortes, përcaktuar në kontratën e shërbimit.

Nisur nga këto të dhëna, Kolegji çmon se provohet marrëdhënia e shërbimit mes personit të lidhur dhe fondacionit, si edhe paga përfituese për këtë vit, duke konsideruar të paguar në këtë rast edhe pagimin e tatimit prej vetë fondacionit sipas shkresës DRT Tiranë nr. {***} prot., datë 20.11.2018. Kolegji vlerëson se përcaktimi i nenit 4 të kontratës së shërbimit, sipas të cilit ofruesi ishërbimit përgjigjet për pagimin e taksave e detyrimeve³⁰, duhet lexuar sipas pretendimit të subjektit se këto pagesa zbriten/përballohen nga pagesa që fondacioni duhet të kryejë për llogari të personit të lidhur, por jo se detyrimisht është ajo drejtpërdrejt e detyruar të kryejë pagesat në organet tatimore për këtë qëllim. Sipas parashikimit të nenit 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”³¹, i ndryshuar, detyrimi për mbajtjen në burim të detyrimit tatimor në rastet e personave juridikë të cilët përfshihen në shërbime konsulence, i takon vetë personit juridik. Referuar këtij përcaktimi dhe informacionit që vjen nga shkresa e DRT-së Tiranë për pagimin prej fondacionit të tatimit për një vlerë pothuaj të njëjtë me atë që duhej të paguhej për pagën e bashkëshortes së subjektit për këtë vit³², Kolegji

³⁰Kontratës “Service agreement”, të lidhur midis “{***}” Albania dhe znj. M. K., në nenin 4 të saj specifikohet: “the service provider shall be responsible for the covering of all tax and duties on the payment.”

³¹Neni 33 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të emërtuar “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, parashikon:

“Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 15 për qind nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë. (Ndryshuar me ligjin nr. 156/2014, dt. 27.11.2014. Botuar në FL.Z. nr. 195, dt. 24 dhjetor 2014 a.) dividendët; b) ndarjet e fitimit; c) interesat; ç) pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale; d) pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit; dh) pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues; e) pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to; ë) pagesat për qiratë; f) pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre. g) të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë. (Ndryshuar me ligjin nr. 10343, dt. 28.10.2010, Fl.Z. Nr. 159, datë 3 dhjetor 2010)”.

³²Drejtoria e Përgjithshme Tatimore ka konfirmuar kryerjen e dy pagesave të tatimit në burim nga fondacioni “{***}” Albania respektivisht në vitin 2003 në shumën 119.552 lekë dhe në vitin 2004 shumën 61.563 lekë (total

arrin në konkluzionin se janë kryer pagesat e detyrimeve tatimore për këtë të ardhur, duke plotësuar në këtë mënyrë kriteret kushtetuese dhe ligjore për të ardhurën e ligjshme në vlerën 554.067 lekë. Kjo vlerë është llogaritur si e ardhur në analizën financiare të kryer në Kolegj për llogari të kontrollit të burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për financimin e ndërtimit të banesës së familjes së origjinës së personit të lidhur.

21.27 Kolegji vlerësoi, në kuptim të plotësimin të kriterëve kushtetuese dhe ligjore për të ardhurën e ligjshme, edhe shumat e përfituara prej familjes së origjinës së personit të lidhur nga shitja e një banese në vitin 1995 e shumat e përfituara prej përfshirjes së kësaj vlere në firmat piramidale, duke qenë në ankim, mbështetur mbi rekomandimin e vëzhguesve ndërkombëtarë, ndonëse nuk ka një pretendim konkret kundërshtues për këto të ardhura, ngihen dyshime mbi vlerësimin ose jo të tyre si të ardhura të ligjshme, në kuptim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore.

21.28 *Lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e banesës së fituar nëpërmjet ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", rezulton se familja K., me anë të kontratës noteriale të shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.1995, ka shitur banesën në pronësi të saj të ndodhur në Peshkopi. Në kohën e shitjes së kësaj prone, në vitin 1995, tatimi mbi të ardhurat rregullohej nëpërmjet ligjit nr. 7786, datë 27.1.1994, "Për tatimin e të ardhurave personale", i cili nuk parashikonte si të pagueshëm tatimin mbi shitjen e pasurive të paluajtshme, veprimtari e cila u përfshi si një burim që krijon një të ardhur të tatueshme, me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 1673, datë 20.12.1996, "Për një ndryshim në ligjin nr. 7786, datë 27.01.1994, "Për tatimin mbi të ardhurat personale", duke përcaktuar se të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme tatonen në masën 3% të çmimit të shitjes" [...]. Në këto kushte, të ardhurat e krijuara nga ky transaksion në vitin 1995 janë vlerësuar si të ardhura të ligjshme në kuptim të kërkesave të ligjit nr.84/2016dhe, si të tilla, të llogaritshme si të ardhura të ligjshme për familjen K. në vlerësimin më tej të të ardhurave të krijuara prej dhënies hua të tyre.*

21.29 Përgjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat e familjes K. të përfituara nga shitja e apartamentit në Peshkopi janë përfshirë në shumat monetare të përdorura për dhënie huaje në firmat piramidale. Rezulton se familja K. ka përfitur nga këto marrëdhënie huadhënie në total shumën prej 2.069.384 lekë deri më 11.02.1997 sipas përmbajtjes së shkresës së Ministrisë së Financave nr. {***} prot., datë 14.11.2018³³.

21.30 Në analizë të legjitimitetit të këtyre të ardhurave, Kolegji konstaton se në kohën kur firmat piramidale kanë ushtruar aktivitetin e tyre si huamarrës, aktiviteti i cili u përmbyll me dëme të rënda sociale, ekonomike e politike për vendin, e vetmja bazë ligjore që rregullonte këtë aktivitet ishin dispozitat e Kodit Civil, të cilat parashikonin kontratën e huadhënies si një marrëdhënie detyrimi e cila prodhonte për palët të drejtat e detyrimit e përcaktuara në të. Situata e mëpasshme ligjore pas gjendjes së vështirësisë ekonomike të krijuar për shkak të mospasjes së mundësisë së firmave piramidale për shlyerjen e detyrimeve që kishin ndaj publikut të gjerë, determinoi ndërhyrjen e shtetit nëpërmjet miratimit të ligjit nr. 8188 prot., datë 23.01.1997, "Për ndalimin e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes" dhe vënies para

181.115 lekë),ku vlera e paguar në vitin 2004 shkon përfaqësisht me vlerën e kontraktuar prej 63.250 lekësh/muaj, duke përfshirë detyrimet tatimore.

³³Në këtë shkresë jepen të dhëna lidhur me vlerat e investuara dhe të përfituara nga babai i bashkëshortes së subjektit A.K. në firmat piramidale "{***}" dhe "{***}", si dhe bashkëlidhur saj janë vendosur edhe kartelat e pasqyrave financiare të lëshuara nga këto shoqëri lidhur me kreditimet dhe pagesat e kryera në favor të z. A.K.. Nga analizimi i këtyre akteve, rezultoi se A. K. ka përfitur nga këto kompani shumën prej 2.069.384 lekësh deri më 11.02.1997.

përgjegjësishë ligjore të pronarëve të këtyre firmave për veprën penale të mashtrimit në përmasa të mëdha e më shumë se një herë. Në këtë kontekst, vlerësimi i Kolegjit mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, do të ndalet deri në lejimin prej dispozitave të Kodit Civil³⁴ të mundësisë për krijimin e tyre pa analizuar më tej mbi rolin dhe përgjegjësinë e huadhënësve për përmasat kolosale që krijoi këtë aktivitet për publikun e gjerë, duke qenë se në terma makro e të përgjithshëm të dëmtuarit e këtij aktiviteti të konsideruar kriminal, ishin vetë huadhënësit, sipas situatave konkrete të secilit prej tyre. Në këto kushte, gjendur para faktit se subjekti i rivlerësimit ka mundur të paraqesë dokumente të lëshuara nga institucione shtetërore (Ministria e Financave) që provojnë përfitimet periodike të marra nga familja K. nga huamarrja në firmat piramidale, Kolegji vlerëson se të ardhurat e krijuara nga familja K. prej këtij aktiviteti, e të përfituara para miratimit të ligjit nr. 8188, datë 23.01.1997, që ndaloi ushtrimin e kësaj veprimtarie, duhet konsideruar se plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme dhe, për pasojë, janë konsideruar si të tilla në analizën financiare të kryer për kontrollin e burimeve të ligjshme të familjes K. për financimin e ndërtimit të banesës të ndodhur në {***}.

21.31 Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik në ankim se në analizën financiare të kryer prej Komisionit, ka mungesë të përlllogaritjes së shpenzimeve të mobilimit të pasurisë shtëpi banimi (268,2 m²) dhe truall (330 m²), si dhe shpenzime qiraje për familjen K. nga viti 1996-2004, si dhe ka paqartësi lidhur me metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës së familjes K. për periudhën para vitit 2003, Kolegji, pasi analizoi provat e administruara gjatë gjykimit, me kërkesë të subjektit, si edhe dëgjoi qëndrimin e tij mbi këto pretendime të Komisionerit, arriti në konkluzionin se është e pamundur të përcaktohet një vlerë që t'i korrespondojë këtij zëri shpenzimesh.

21.32 Në vendimin objekt shqyrtimi të Komisionit, tek i cili jepen edhe përlllogaritje të analizës financiare të familjes së origjinës së bashkëshortes së subjektit, nuk është përfshirë asnjë shpenzim lidhur me kostot e strehimit të kësaj familjeje para ndërtimit të banesës në {***} dhe as për mobilimin e saj. Duke kontestuar këtë qëndrim të Komisionit, Komisioneri Publik ka pretenduar se Kolegji duhet të hetojë për të përcaktuar vlerat që ka shpenzuar familja K. për këto nevoja, në mënyrë që analiza financiare e familjes të ishte sa më afër realitetit.

21.33 Subjekti, në përgjigje të këtij shkaku ankimi, ka shpjeguar se, bazuar në sqarimet e bashkëshortes dhe të familjarëve të saj, familja e tyre për periudhën 1996 deri në vitin 2003 ka jetuar pa pagesë në katin përdhe të shtëpisë private të mikut të babait të bashkëshortes, z. M. D. Shtëpia e z. D. ndodhej në fshatin {***}, Komuna {***}, dhe jetesa në këtë banesë bëri të mundur edhe ardhjen në dijeni të babait të bashkëshortes për truallin e blerë prej tij, në të cilin u ndërtua banesa, i cili ndodhej shumë afër shtëpisë private të z. D.

21.34 Në mbështetje të këtij qëndrimi, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale³⁵ të z. A. D., djali i të ndjerit, z. M. D., në të cilën konfirmohet ajo që subjekti ka deklaruar në gjykim. Për sa i përket mobilimit të shtëpisë, subjekti ka shpjeguar se ashtu siç tregojnë edhe fotot në raportin e vlerësimit të pasurisë në dosjen e aplikimit për kredi pranë Bankës Kombëtare të Greqisë (NBG) (nëntor 2004), të cilat janë administruar nga Komisioni, janë përdorur mobiliet e banesës së Peshkopisë.

³⁴Të parashikuara në nenet 1050-1055 të Kodit Civil, të miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, Fletore Zyrtare nr. 11.

³⁵Nr.repertori {***}, nr. koleksioni {***}, datë 09.03.2021.

21.35 Në vlerësim të kësaj situatë faktike, Kolegji çmon se është i pamundur përcaktimi i ndonjë vlere që do t'u korrespondonte shpenzimeve për qira dhe mobilim për familjen K. për këtë periudhë. Në mënyrë të ngjashme, Kolegji ka arsyetuar dhe përllogaritur edhe shpenzimet për qira apo mobilim të subjekteve të tjera, mbështetur në deklaratimet e tyre në proces, duke qenë se ka rezultuar e pamundur objektivisht të saktësohen vlerat e shpenzuara për këto nevoja të njëjste familjare, aq më shumë në rastin konkret, kur ato lidhen me familjen e bashkëshortes së subjektit, në një kohë të largët dhe jashtë fokusit për deklarime apo vëmendjes për të ruajtur dokumentacion provues, për sa kohë që ligji nuk parashikonte asgjë për këtë kategori shpenzimesh në kohën e kryerjes së tyre. Në këto rrethana, sado pak realiste të besohet se janë deklaratimet e subjektit për mobilimin e banesës në {***}, Kolegji gjendet në kushtet e pranimit të vërtetësisë së deklaratimeve të subjektit, për sa kohë që nuk mund të konkludojë ndryshe dhe si pasojë nuk do të ngarkojë me shpenzime për këta zëra analizën familjare të familjes së personit të lidhur për vitet 1997-2004.

21.36 Lidhur me pretendimet e Komisionerit Publik në drejtim të orientimit të Komisionit për metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës për periudhën para vitit 2003, Kolegji së pari u ndal për të qartësuar mënyrën e përllogaritjes së kostove të jetesës në rastin objekt shqyrtimi për periudhën e përcaktuar. Referuar rastit konkret, nga aktet e administruara, rezulton se në analizën financiare të Komisionit, kostot e jetesës për periudhën 1997-2002 për familjen K., si dhe për subjektin e rivlerësimit janë përllogaritur me vlerë fikse 5.000 lekë në muaj për person.

21.37 Për një evidentim sa më objektiv të kostove të jetesës që i referohen një periudhe relativisht të largët para vitit 2003, për të cilën institucionet përgjegjëse, si INSTAT-i, nuk kanë të dhëna statistikore, Kolegji i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shprehet se sa përqind të të ardhurave të familjes së origjinës së bashkëshortes kanë zënë shpenzimet e jetesës. Lidhur me këtë kërkesë, subjekti i rivlerësimit përgjati gjykimin në Kolegj³⁶, u shpreh se shpenzimet e jetesës për vitet 1997-1999 kanë qenë në masën 35% deri në 40% të të ardhurave të familjes K.

21.38 Lidhur me këtë pretendim të Komisionerit Publik dhe qëndrimin e subjektit të rivlerësimit, Kolegji mori në konsideratë së pari faktin që për periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2016 ekzistojnë vlera të përcaktuara nga organi shtetëror i ngarkuar posaçërisht me matjen e nivelit të jetesës në vend, të cilat janë përcjellë në Kolegjin ILDKPKI-ja nëpërmjet shkresës nr. {***} port., datë 04.03.2019, protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 04.03.2019. Në këtë korrespondencë janë përcaktuar të dhënat që përdoren për përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën si më lart, që burojnë nga publikimet zyrtare të INSTAT-it. Këto publikime nuk përmbajnë të dhëna lidhur me shpenzimet e jetesës në vend për periudhën para vitit 2000 dhe, në këto kushte, për llogaritjen e tyre në çështje të tjera të gjykuara në Kolegj, shpenzimet janë konsideruar në mënyrë alternative, referuar një mase që i përcakton ato se përbëjnë 30% të të ardhurave të njëjste familjare ose 66% të tyre, kjo e fundit e gjendur si referencë në një raport të Bankës së Shqipërisë të vitit 1995, në të cilin specifikohet se: *[...] të ardhurat vjetore për frymë të popullsisë në fund të vitit 1995 kanë arritur nivelin në afërsisht 800 USD nga 330 USD që ishin në vitin 1993. Sipas disa përllogaritjeve të përafërta, supozohet se përqindja e kursimeve të popullatës në fund të vitit 1995 mund të jetë rreth 34% nga 29% që*

³⁶Përgjatë seancës gjyqësore të datës 28.04.2021, vetë subjekti i rivlerësimit kërkoi nga trupi gjykues t'i jepej kohë për t'u këshilluar me familjarët e bashkëshortes lidhur me kostot e jetesës së kësaj familjeje gjatë periudhës 1997-1999. Në vijim, me anë të komunikimit elektronik (e-mail) subjekti më datë 05.05.2021, i ka përcjellë Kolegjit shpjegimet e tij lidhur me shpenzimet e jetesës së familjes së bashkëshortes për periudhën 1997-1999, tek i cili shpreh se: "Shpenzimet e jetesës së familjes K. për periudhën 1997-1999 kanë qenë në masën 35%-40% të të ardhurave neto vjetore (paga të prindërve dhe të bashkëshortes).

ishte në fund të vitit 1992. Konsideruar sa më sipër, pjesa tjetër e të ardhurave ka shkuar për konsum dhe kjo për këtë vit përbën rreth 66% të të ardhurave.

21.39 Në këto rrethana, Kolegji vlerësoi se për të përcaktuar shpenzimet e jetesës në rastin e familjes K., për periudhën 1997-1999, duhej analizuar situata faktike e të ardhurave të tyre në raport me referencat e kohës, por edhe duke konsideruar qëndrimin që vetë subjekti do të mbante. Subjekti deklaroi në gjykim se shpenzimet për familjen K. në këtë periudhë kanë qenë në nivelin 35%-40% të të ardhurave të familjes. Kolegji e vlerësoi këtë deklaram si të pranueshëm në kushtet e mospasjes së një standardi referues ligjor për përllogaritjen e këtyre shpenzimeve dhe duke konsideruar faktin se familja e origjinës së bashkëshortes së subjektit në periudhën e analizuar nuk ka qenë mbajtëse e ndonjë detyrimi për deklaram, për pasojë mbetet e paqartë dhe e vështirë për t'u përllogaritur situata, qoftë për të ardhurat e përfituara nga kjo familje, qoftë stili apo niveli i saj i jetesës.

21.40 Në lidhje me kërkimin e Komisionerit Publik në ankim, për nevojën e një qëndrimi orientues të Kolegjit për metodologjinë që duhet përdorur për sa i përket llogaritjes së shpenzimeve të jetesës për periudhën për të cilën nuk gjejmë gjurmë në anketat apo publikimet e INSTAT-it, Kolegji vlerësoi këtë kërkim në raport me informacionin që përmban raporti i Bankës së Shqipërisë i vitit 1995, sipas të cilit shtetasit shqiptarë shpenzojnë për jetesë rreth 66% të të ardhurave të tyre nga punësimi në sektorin publik, të cilat përllogariten mesatarisht në vlerën prej 800 USD në vit. Në funksion të një qëndrimi orientues, sipas parashikimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji parashtron arsyetimin në vijim.

Së pari, vlen të nënvizohet se, sipas vlerësimit të Kolegjit, periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend që përkon me vitet 1991-1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshëm, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha. Për pasojë, pasi monedha vendase hyri në një fazë stabiliteti, pas viteve 1992-1993³⁷, mundësia për të kursyer mund të konsiderohet si opsion dhe, për këtë qëllim, nevojitet përcaktimi metodologjisë që përcakton shpenzimet e jetesës si një zë i analizës financiare.

21.41 Nga një vështrim i thjeshtë i të dhënave që disponohen nga burime të hapura, për pagat në vend në këtë periudhë, rezulton se raporti i pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve me ato të funksionarëve të tjerë të sektorit publik, qëndronte përafërsisht në raportin rreth 30% më të larta³⁸. Në këto kushte, duke marrë parasysh këtë raport, krahasuar me informacionin që jep

³⁷Në raportin periodik të Bankës së Shqipërisë për vitin 1995, lidhur me ekonominë e vendit për 5 vitet e fundit, shprehet se: “[...] Në shtator 1991 zhvlerësohet kursi i këmbimit zyrtar duke u fiksuar e dollarin amerikan në 25 lekë/USD nga 10 lekë/USD në fillim të vitit 1991. Më pas zbatimi i regjimit fleksibël i kurseve të këmbimit e zhvlerësojnë monedhën vendase lekë në masën 220%, dhe në fund të 1992 mbyllet me një kurs këmbimi 98.88 lekë/USD. Zhvlerësimet e njëpasnjëshme në vitin 1991 u pasuan nga liberalizimi i plotë i kursit valutor të lekut në korrik 1992. Vitet 1992 dhe 1993 shënuan edhe kalimin në liberalizimin në shkallë të gjerë të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve, por duke ruajtur ende një shportë të kufizuar mallrash konsumi me çmime të kontrolluara nga shteti. Kjo periudhë shënon dhe liberalizimin e tregtisë së jashtme, duke hequr monopolin shtetëror mbi tregtinë e jashtme dhe duke zbatuar regjime të lira importi dhe eksporti. Kursi valutor dhe çmimet e mallrave dhe shërbimeve u vunë nën sundimin e forcave të lira të tregut:

https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raporti_Vjetor/Raporti_Vjetor_1995.html

³⁸Sipas ligjeve ndër vite:

- Ligji nr. 7668, datë 02.02.1993, “Për pagat e gjyqtarëve, të prokurorëve dhe hetuesve”;

Banka e Shqipërisë në Raportin e vitit 1995 të cituar më lart, vlerësohet se në rastin e analizës financiare në të cilat figurojnë të ardhura të siguruara nga puna e gjyqtarëve apo prokurorëve, shpenzimet e jetesës duhet të llogariten në masën 30% të të ardhurave i cili përaftron me masën e shpenzimeve për jetesë në raportin 66% të të ardhurave që i përkasin pagave mesatare të të gjithë sistemit të pagave. Logjika që mbështet këtë konkluzion vjen si pasojë e arsyetimit ligjor se standardi për shpenzimet e jetesës duhet të jetë i njëjtë për shtetasit dhe subjektet e rivlerësimit për sa kohë që nuk rezultojnë të dhëna zyrtare që do të përcaktonin ndryshe. Në këto kushte, individët që fitojnë më shumë të ardhura, duke ruajtur të njëjtin standard për vlerën e shpenzimeve të llogaritura, duhet të kenë potencialisht më shumë mundësi kursimi.

21.42 Organet e rivlerësimit sigurisht që duhet të kryejnë një analizë logjike e të arsyeshme për përllogaritjen e këtyre shpenzimeve në raste në të cilat ndërthuren elemente të tjera, duke mbajtur në çdo rast në konsideratë se masa prej 66% e shpenzimeve në raport me të ardhurat nga punësimi para vitit 2000, do të merrte kuptim vetëm kur të trajtoheshin të ardhura mesatare të sektorit publik që shkojnë përfaqësisht në vlerën rreth 800 USD në vit, sipas referencës së Bankës së Shqipërisë, dhe duke e vlerësuar këtë orientim në drejtim të përcaktimit të një analize logjike dhe jo si një referim ligjor i detyrueshëm për zbatim.

Për sa më lart, kostot e jetesës për familjen K., për periudhën 1997-1999, do të llogariten në nivelin 40% të të ardhurave të tyre, si një prej alternativave të paraqitura prej subjektit dhe në konsideratë të gjithë arsyetimit të mësipërm dhe të një analize garantiste, në mungesë të të dhënave të sakta zyrtare apo të dhënave domethënëse kërkimore.

21.43 Në përmbyllje të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me pasurinë banesë në ish-pronësi të familjes së origjinës së personit të lidhur, me vendndodhje në {***}, Tiranë, duke përdorur konkluzionet e arritura përgjatë arsyetimit të mësipërm, Kolegji arriti në konkluzionin se familja K. ka qenë në pamundësi për të përballuar me burime të ligjshme ndërtimin e banesës dhe shpenzimet e tjera deri më 31.12.2003, për një vlerë prej (-)1.425.020 lekësh.

Në konkluzion të kësaj analize, Kolegji arrin në përfundimin se pasuria “apartament” me sipërfaqe 124,91 m², te pallati “{***}”, Tiranë, blerë më datë 15.12.2015, me vlerën 177.370 euro, financiar pjesërisht me fonde të krijuara nga shitja e banesës së ndodhur në {***} prej familjes së origjinës së bashkëshortes së subjektit, afektohet në ligjshmërinë e burimeve të krijimit të saj për shkak të defektit të mungesës së burimeve të ligjshme, të konstatuar për krijimin e pasurisë së origjinës si më lart arsyetuar. Kolegji ka vlerësuar të konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së subjektit, në përfundim të

-
- *Ligji nr.7800, datë 02.03.1994, “Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektive, prokurorëve dhe hetuesve”;*
 - *VKM nr.587, datë 25.10.1995, “Për disa ndryshime në pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektive dhe prokurorëve”.*
 - *VKM nr. 236, datë 16.04.1996; “Për disa ndryshime në pagat e gjyqtarëve, ndihmës gjyqtarëve efektive dhe Prokurorëve”.*
 - *Ligji nr. 8332, datë 23.04.1998; “Për një ndryshim në ligjin nr.7800, datë 2.3.1994 “Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektive dhe prokurorëve”, ndryshuar me ligjin nr.8082, datë 7.3.1996.*
 - *VKM nr. 235, datë 22.05.1999; “Për rritjen e pagave të gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektive dhe prokurorëve”.*
 - *VKM nr.376, datë 14.07.2000, “Për rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve”.*
 - *VKM nr. 425, datë 11.06.2001, “Për rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve”.*
 - *VKM nr. 299, datë 27.06.2002, “Për rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve”.*
 - *Sipas të dhënave të Institutit të Statistikës mbi pagën minimale zyrtare dhe pagën mesatare mujore bruto në sektorin shtetëror për periudhën 1991-2017.*

kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij, duke dhënë më poshtë edhe arsyet e këtij vlerësimi.

22. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit Komisioneri Publik pretendon se për pasurinë nr. 2³⁹ "apartament" me sipërfaqe 29,86 m², te pallati "{***}", Tiranë dhe për pasurinë nr. 3⁴⁰ "garazh" me sipërfaqe 12,5 m², po te ky objekt, subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e tyre, të cilat si origjinë fillestare kanë të ardhurat e përfituara nga shitja prej bashkëshortes nga kompania "{***}" ShPK të apartamentit prej 102 m², me adresë Rruga e {***}, {***}, Tiranë, dhe kursimet e bashkëshortes me vlerë 9000 euro, Kolegji analizon si më poshtë.

22.1 Nevoja për verifikimin dhe kontrollin e burimeve të krijimit të apartamentit me adresë Rruga e {***}, {***}, Tiranë, kushtëzohet nga fakti se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting e ka deklaruar atë si një nga burimet e krijimit të apartamentit dhe garazhit në pronësi të tij, të përshkruar më lart, te "{***}", së bashku në vlerë totale 70.000 euro, të përfutur nga shitja e apartamentit tjetër⁴¹, me sipërfaqe 115,08 m², në adresën rr. "{***}", pallatet "{***}" Tiranë, shitur z. E. R. në shumën 130.000 euro.

Për blerjen e këtij apartamenti, me sipërfaqe 115,08 m² (te kompania "{***}" ShPK, Tiranë) janë deklaruar si burim të ardhurat e bashkëshortes, përfutur nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 102 m², të ndodhur në adresën Rruga e {***}, {***}, Tiranë, në shumën 50.000 euro. Për blerjen e apartamentit me sipërfaqe⁴² 102 m², subjekti ka deklaruar si burime të përdorura prej bashkëshortes edhe një kredi bankare pranë NBG Bank, në shumën 23.000 euro, marrë në nëntor 2004, për një afat 23 vjet dhe shlyer në vitin 2008 pas shitjes së banesës në {***} nëpërmjet kontributit të babait të bashkëshortes, në shumën prej 20.000 eurosh.

22.2 Për këtë shkak, Komisioneri Publik në ankim dhe përgjatë gjykimit në Kolegj⁴³, ka pretenduar se për pasuritë "apartament me sip. 29,86 m²", dhe "garazh me sipërfaqe 12,5 m²", me adresë rr. "{***}", pallati "{***}", Tiranë, vlerësohet e nevojshme riçelja e hetimit administrativ dhe kontrolli për çështjet që lidhen me: (i) destinacionin e kredisë së marrë nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, nga NBG Bank; (ii) ligjshmërinë e shumës 20.000 euro, të përdorur për shlyerjen e kredisë pranë NBG Bank; (iii) mundësinë financiare të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit, për të kursyer shumën 9.000 euro; (iv) pagimin e detyrimeve tatimore për fitimin e realizuar nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 102 m² në Rrugën e {***}, Tiranë.

22.3 Lidhur me destinacionin e kredisë së marrë nga personi i lidhur në vitin 2004, në NBG Bank, Komisioneri Publik ka pretenduar se në analizë të akteve të administruara në fashikullin e krijuar nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ, duket sikur mungon nevoja financiare e marrjes së kësaj huaje. Ky konstatim vjen nga fakti se, ndërkohë që pretendohet se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit i kishte të papërdorura fondet që mori pa interes

³⁹Pasurisë nr. 2: "Apartament" me sipërfaqe 29,86 m², te "{***}", Tiranë, e fituar me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.12.2016, për vlerën 46.000 euro, me palë shitëse znj. S. C. dhe z. F. C., në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten.

⁴⁰Pasurisë nr. 3: "Garazh" me sipërfaqe 12,5 m², te "{***}", Tiranë, e fituar me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme të datës 23.12.2016, për vlerën 24.000 euro, me palë shitëse znj. S. C. dhe z. F. C., në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten.

⁴¹Në pronësi 100% të bashkëshortes, znj. M. K.

⁴²Ky apartament, në kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., datë 21.07.2005, lidhur midis bashkëshortes së subjektit dhe kompanisë ndërtuese "{***}" ShPK, figuron me sip. 102 m², ndërsa në DVP Fillestare të bashkëshortes së subjektit, ai është deklaruar me sip. 110 m².

⁴³Në seancën gjyqësore të datës 17.03.2021.

nga z. F. Sh., në maj të vitit 2004 (për shkak se sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, nuk u bë e mundur marrja e lejes së ndërtimit), në nëntor të vitit 2004, znj. M. K. merr një kredi bankare (me interes) në shumën 23.000 euro, për të shlyer huanë e marrë (pa interes), fondet e së cilës i kishte gjendje, të papërdorura.

22.4 Lidhur me këtë shkak, subjekti përgjatë gjykimit në Kolegj⁴⁴, ka prapësuar këtë pretendim duke shpjeguar se:

- (i) Aplikimi për marrjen e kësaj kredie në atë kohë, ka pasur si qëllim krijimin e mundësisë për të pasur disponibël një shumë monetare, e cila do të përdorej për ndërtimin e shtëpisë, menjëherë me marrjen e lejes së ndërtimit. Nëse do të veprohej me aplikimin për marrje kredie pas miratimit të lejes së ndërtimit, kjo mund të kërkonte kohë, madje në atë kohë nuk dihej me siguri nëse kredia do të miratohej ose jo. Ndërsa nuk po realizohej miratimi i lejes së ndërtimit, bashkëshortja ka filluar në të njëjtën kohë edhe kërkimet në lidhje me blerjen e një banese, me kusht që banesa të ndodhej afër shtëpisë së prindërve.
- (ii) Sjell në vëmendje se aplikimi për kredi shoqërohet me një serë veprimesh financiare, si: pagesa për vlerësimin e pasurisë e cila vendoset kolateral, komisioni i disbursimit të kredisë, sigurimi i jetës për kredimarrësin, kostot financiare në lidhje me noterizimin e dokumentacionit, dhe veçanërisht kohën e harxhuar për realizimin e këtij procesi. Shlyerja e kredisë, pagesa e penalitetit në rast të shlyerjes së parakohshme të saj (rreth 1%), përgatitja e dokumentacionit nga fillimi për një kredi të re dhe kostot përkatëse, pagesa e komisionit të disbursimit, si dhe koha që do të duhej për të realizuar përsëri këtë proces aplikimi për një kredi të re, janë vlerësuar në atë kohë nga bashkëshortja si më të larta se kostoja e interesit të paguar për periudhën nëntor 2004 - korrik 2005.

22.5 Në analizë të këtij pretendimi të Komisionerit Publik, nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, Kolegji konstaton se situata faktike rezulton të jetë si më poshtë.

- (i) Nga dokumentacioni shkresor, përcjellë Komisionit nga NBG Bank⁴⁵, ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit, me anë të kontratës së kredisë nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 01.11.2004, ka marrë kredi pranë kësaj banke në shumën 23.000 euro, me qëllim blerje apartamenti, disbursuar në llogarinë e saj më datë 22.11.2004. Në aktet e dosjes së kredisë bankare, është depozituar deklarata noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 29.09.2004, e nënshkruar nga z. F. Sh. dhe znj. M. K. Referuar përmbajtjes së deklaratës, huadhënësi, z. F. Sh., deklaron se në maj 2004 i ka dhënë hua pa interes, në shumën 23.000 euro, znj. M. K. për “ndërtimin e një shtëpie” në {***}, Tiranë. Shuma do t’i kthehej huadhënësit brenda vitit 2004. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë, ka rezultuar se, pas disbursimit të kredisë bankare nga NBG Bank, shuma 22.615⁴⁶ euro është transferuar më datë 23.11.2004 në llogarinë e z. F. Sh., me përshkrimin: *Transfer to the account of the lender*⁴⁷.
- (ii) Nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar se kredia nga NBG Bank është përdorur për shlyerjen e huasë së marrë z. F. Sh. Ndërkohë, ndryshe nga sa më lart, në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, bashkëshortja e subjektit, znj. M. K., ka deklaruar se apartamenti me sipërfaqe 110 m², Komuna {***}, {***}, Tiranë (Rruga e {***}), është blerë me këtë kredi bankare, dhe të njëjtin deklaram ka bërë edhe subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*.

⁴⁴Në shpjegimet e tij tëseancës gjyqësore të datës 17.03.2021.

⁴⁵Me shkresën nr. {***}, datë 31.01.2018.

⁴⁶Nga shuma e disbursuar prej 23.000 eurosh, është transferuar te z. F. Sh. shuma 22.615 euro.

⁴⁷Në rubrikën “Kushte speciale të disbursimit”, specifikohet: “Transfer of the funds at the account of Mr. F. Sh. (the lender)”.

22.6 Kolegji, në analizë të këtij pretendimi të Komisionerit, si dhe të prapësimeve të seancës gjyqësore të subjektit të rivlerësimit, vlerëson se situata faktike e përshkruar më lart, provon minimalisht faktin se deklarimi i subjektit në deklaratën *vetting* për deklarimin e kredisë bankare si burim për krijimin e pasurisë së ndodhur në zonën e {***}, {***}, është i pasaktë dhe nuk përputhet me të dhënat që rezultojnë siç u përshkruan më lart. Fondet e kredisë bankare të marra prej NBG Bank, rezultojnë të jenë përdorur për të shlyer huanë që bashkëshortja i kishte z. F. Sh., sipas deklaratës noteriale. Fakti i pretenduar prej subjektit se fondet të cilat ishin marrë prej këtij shtetasi, ishin në posedimin e bashkëshortes dhe ato u përdorën për financimin e blerjes së apartamentit të kompania “{***}” ShPK, meqenëse kredia kishte shërbyer për shlyerjen e tyre, pavarësisht arsyeve që përdor subjekti për të justifikuar këtë veprim apo qëndrimin që mban Komisioni në drejtim të kualifikimit të këtij transaksioni si zëvendësimi i debitorit, çmohen nga Kolegji jobindëse dhe jo të logjikshme.

22.7 Për të shmangur çdo spekulim në lidhje me motivet apo arsyet që kanë shtyrë bashkëshorten e subjektit në një transaksion jobindës dhe logjik sipas arsytimit të një njeriu të zakonshëm, Kolegji çmoi të abstragojë qëndrimin mbi motivet e këtij transaksioni të pazakontë. Për sa i përket vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me përdorimin e kësaj kredie si burim për blerjen e apartamentit, në kuptim të parashikimit të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*, pas analizimit të këtij deklarimi në raport me detyrimin ligjor për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti dështoi të bindë trupën gjyqësore se burimi për krijimin e pasurisë “apartament” prej bashkëshortes së tij, është kredia e marrë në Bankën NBG siç është deklaruar në deklaratë.

22.8 Edhe sikur rrethanat e faktit të provohen se ishin siç i deklaroi subjekti, Kolegji konstaton se mbetet e konfirmuar se kredia e marrë nga NBG Bank është disbursuar në favor të z. F. Sh. dhe nuk ka ndonjë gjurmë dokumentare që të provojë se pas këtij momenti, ajo është përdorur për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, që rridhte nga blerja e apartamentit. Në këtë mënyrë, rezultojnë se minimalisht subjekti ka deklaruar jo në mënyrë të saktë e të plotë burimet e përdorura për blerjen e këtij apartamenti dhe, pavarësisht se ky deklarim derivon nga informacioni që ai ka marrë prej bashkëshortes së tij, ky fakt nuk e zhvesh atë nga përgjegjësia për të deklaruar saktë të gjitha burimet e krijimit të pasurisë së tij.

22.9 Në përfundim të kësaj analize, Kolegji çmon se gjendemi të paktën para një plotësimi të deklaratës *vetting* jo në përputhje me kërkesat e ligjit, për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë; për pasojë, zbatimi i nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr.84/2016 që e konsideron deklaratën *vetting* të saktë, nuk gjen zbatim. Në të njëjtën mënyrë si më lart, Kolegji do e vlerësojë këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë.

22.10 Komisioneri Publik, në drejtim të ligjshmërisë së shumës 20.000 euro, të përdorur për shlyerjen e kredisë pranë NBG Bank, ka pretenduar se nuk rezultojnë që të jetë hetuar nga Komisioni nëse është paguar tatimi në burim, në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8438/1998”). Sipas këtij këndvështrimi, mbetet e paqartë nëse kjo shumë do të kualifikohet si dhurim dhe, nëse kualifikohet si e tillë, a duhet t’i nënshtrohet pagimit të detyrimeve tatimore, sipas ligjit nr. 8438/1998. Komisioneri Publik, me anë të ankimit, ka kërkuar prej Kolegjit një interpretim/orientim lidhur me ligjshmërinë e shumës 20.000 euro, e parë në raport me detyrimin për pagimin e tatimit mbi të ardhurat. I njëjti qëndrim paraqitet edhe në raport me

shumën prej 30.000 eurosh, të deklaruar prej bashkëshortes së subjektit si dhuratë nga babai i saj dhe e përdorur si burim për financimin e pasurisë së subjektit, të ndodhur në {***}.

22.11 Në përgjigje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përgjatë gjykimit në Kolegj, ka shpjeguar *së pari* se shuma prej 20.042 eurosh nuk mund të konsiderohet një "shumë e dhuruar", për sa kohë bashkëshortja, në momentin e kryerjes së këtyre veprimeve, në vitin 2008, ishte pjesë e trungut familjar, së bashku me prindërit dhe vëllain e saj, si dhe kontribuuese në mënyrë të vazhdueshme në ekonominë familjare. *Së dyti*, subjekti ka sjellë në vëmendje të Kolegjit jurisprudencën e tij të deritanishme, sipas së cilës shumat e dhuruara nga personat e tjerë të lidhur janë konsideruar me burime të ligjshme, pa kërkuar si kusht për këtë kualifikim pagimin e detyrimeve tatimore⁴⁸. Subjekti gjithashtu ka mbështetur qëndrimin e mbajtur nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në shkresën nr. {***} prot., datë 16.05.2019, në përgjigje të pyetjes së drejtuar nga Komisioni, se nuk i nënshtrohen tatimit shumat e dhuruara të cilat janë tatuar një herë, ndër të tjera në zbatim të parimit të mostatimit të dyfishtë.

22.12 Në këto kushte, pasi shqyrtoi të gjitha elementet e mësipërme, Kolegji arriti në konkluzionin se shuma prej 20.000 eurosh, e financuar prej babait të bashkëshortes për të shlyer kredinë e marrë në Bankën NBG, në vitin 2008, do të konsiderohet si e krijuar me burime të ligjshme dhe, për pasojë, pa pasoja negative në vlerësimin e burimeve të krijimit të pasurisë "apartment", të ndodhur te zona e {***}, në {***}.

22.13 Kolegji, në funksion të vlerësimit të këtij shkaku ankimi, e konsideron këtë shumë si një të ardhur të përdorur prej bashkëshortes së subjektit për të mundësuar financimin e pasurisë në emër të saj, e cila ishte krijuar nga shitja e një pasurie të përbashkët të familjes, të deklaruar si e tillë në të gjitha deklaratat periodike. Siç rezulton nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, kjo shumë përfaqëson kaparin e paguar nga blerësi i pasurisë si garanci për realizimin e shitjes së banesës së përbashkët. Në momentin që është bërë ky kalim fondesh nga blerësi te babai i bashkëshortes së subjektit dhe nga ky i fundit te banka, përfitimet nga shitja e pasurisë ishin ende të përbashkëta dhe natyrshëm, në kushtet e një ekonomie familjare të përbashkët, nuk mund të përcaktohet se kapari do t'i takonte njërit prej anëtarëve dhe se cili do të ishte ai. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se kjo e ardhur duhet të kontrollohet dhe të vlerësohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë së krijimit të saj, si një e ardhur në të cilën bashkëshortja e subjektit ka përfituar si një prej bashkëpronareve të pasurisë që premtohet për shitje.

22.14 Në këtë kontekst, Kolegji konstaton se nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ të Komisionit, provohet marrja e kësaj shume në zbatim të kontratës së kaparit me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 27.05.2008, dhe se kjo shumë është pjesë e shumës prej 220.000 eurosh, të përfituar prej shitjes së banesës, për të cilën është paguar detyrimi tatimor mbi këtë të ardhur të krijuar nga shitja e pasurisë. Kjo e dhënë rezulton nga praktika e përcjellë nga ZVRPP Tiranë, tek e cila gjendet pagesa e kryer në sportelin e Raiffeisen Bank nga babai i bashkëshortes së subjektit, z. A.K., i cili me datë 31.08.2008, ka kryer në favor të ZVRPP Tiranë pagesën me përshkrimin: "Pagesë takse hipoteke për shitje shtëpie 10% të fitimit kapital". Për shkak të këtij arsyetimi, Kolegji do trajtojë çështjen që lidhet me pagimin e tatimit mbi shumat monetare të dhuruara në analizën që do t'i bëjë shumës së dhuruar bashkëshortes së subjektit prej babait të saj, në vlerën prej 30.000 eurosh.

⁴⁸Nr. 20/2019 (JR), datë 31.07.2019.

22.15 Lidhur me pretendimin tjetër të Komisionerit Publik, për pamundësinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për të kursyer shumën 9.000 euro të përdorur si një prej burimeve të financimit për blerjen prej saj të apartamentit të {***}, {***}, Tiranë, Kolegji analizon sa vijon.

22.16 Në ankim, Komisioneri Publik ka pretenduar se duhet kryer një analizë e plotë financiare mbi të ardhurat, shpenzimet dhe investimet e kryera nga bashkëshortja e subjektit në vitin 2005, për të kontrolluar mundësinë e saj për të kursyer shumën prej 9.000 eurosh, e përdorur si burim për blerjen e pasurisë të {***}. Në këtë analizë, sipas Komisionerit Publik, duhet konsideruar edhe shpjegimi i subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e dhëna më datë 19.10.2018, gjatë hetimit administrativ, në të cilat shprehet se: [...] të gjitha mjetet monetare të realizuara prej bashkëshortes deri në momentin kur mori hua shumën 23.000 euro nga F. Sh. (maj 2004), ishin vënë në dispozicion të ndërtimit të shtëpisë private.

22.17 Lidhur me këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit përgjatë gjykimit në Kolegji, ka kërkuar të merren me cilësinë e provës akte të reja⁴⁹, të cilat identifikojnë të ardhurat e sakta të nënës dhe vëllait të bashkëshortes për periudhën qershor 2004 - janar 2006.

22.18 Kolegji, lidhur me këtë pretendim të Komisionerit, pasi mori në konsideratë edhe provat e reja të paraqitura prej subjektit në gjykim, të cilat dokumentonin të ardhurat e vëllait të bashkëshortes për periudhën në fjalë dhe gjithashtu saktësoi të ardhurat e nënës së bashkëshortes për të njëjtën periudhë, duke pranuar si një moment të rëndësishëm për analizën financiare, deklarimin e subjektit për shpenzimin e çdo fondi monetar për ndërtimin e shtëpisë, kreu analizën financiare duke e startuar atë nga muaji qershor 2004 deri në muajin janar 2006, në të cilin është bërë pagesa e shumës 9.000 euro. Sipas këtij vlerësimi, rezultoi se bashkëshortja e subjektit kishte mundësi të krijonte me burime të ligjshme shumën prej 9.000 eurosh, të përdorur si burim për blerjen e apartamentit nga shoqëria “{***}” ShPK⁵⁰.

22.19 Kolegji mori në analizë pretendimin e Komisionerit Publik në drejtim të ligjshmërisë së vlerës së përfiturar prej bashkëshortes së subjektit nga shitja e apartamentit prej 100,9 m², me adresë Rruga e {***}, {***}, Tiranë, në vitin 2007, e cila duhet konsideruar në këndvështrim të rrethanave të faktit dhe ligjore që lidhen me (i) tatimin mbi të ardhurat i cili është paguar me 10 vite vonesë; (ii) si dhe pagesën e tij vetëm disa ditë para dorëzimit të deklaratës vetting; (iii) përshkrimin e pagesës së tatimit që nuk lidhet qartësisht me transaksionin për të cilin paguhet detyrimi, si edhe kërkimin për një interpretim/orientim të Kolegjit lidhur me trajtimin e të ardhurave për të cilat detyrimet tatimore kryhen me vonesë gjatë procesit të rivlerësimit.

⁴⁹i) Shkresa nr. {***} prot., datë 22.02.2021, e ISSH-së, sipas së cilës përcaktohen të ardhurat nga paga e vëllait të bashkëshortes, z. F.K., për vitin 2005 deri në mars 2006. ii) Shkresa nr. {***} prot., datë 23.02.2021, e ISSH-së. Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme mbi pagën neto mesatare të H.K., vitet 2005 dhe 2006.

⁵⁰Për periudhën qershor 2004 - janar 2006, u morën në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet si më poshtë vijojnë:

- Të ardhura në total, shuma prej 3.843.672 lekësh, e cila ishte e përbërë nga: të ardhura si kontabël i miratuar për vitet 2004 dhe 2005, në shumën 1.465.957 lekë; të ardhura nga puna në kompaninë “{***}”, në shumën 610.493 lekë; të ardhura nga pagat nga A., H. dhe F.K., në shumën 1.172.324 lekë; të ardhura nga puna në kompaninë “{***}” për vitin 2005 (5 muaj), në shumën 271.692 lekë; të ardhura nga Fondacioni {***} për vitin 2004 (7 muaj), në shumën 323.206 lekë.

Shpenzime në total, shuma prej 3.367.810 lekësh, shumë e cila është e përbërë nga: shpenzime jetese për periudhën qershor 2004 - janar 2006, në shumën 693.776 lekë; shpenzime për blerjen e makinës Ford, sipas faturës tatimore nr. {***}, datë 19.01.2006, në vlerën 1.200.000 lekë; shpenzimi për shlyerjen e kësteve të kredisë së marrë pranë NBG Bank, në vlerën 3.029 euro, si dhe shuma prej 9.000 eurosh, e përdorur për pagesën e kështit të shtëpisë më datë 19.01.2006. Shuma në euro të konvertuara në lekë, ekuivalente me shumën 1.474.034 lekë.

Diferenca e të ardhurave me shpenzimet = 3.843.672 lekë - 3.367.810 lekë = 475.862 lekë.

22.20 Subjekti, në përgjigje të këtyre pretendimeve, ka prapësuar duke kërkuar prej Kolegjit të marrë në konsideratë faktin se ky është një veprim i cili ka ndodhur në vitin 2007 dhe pakujdesia ka ardhur më së shumti se, megjithëse në gjuhën e përditshme bëhej fjalë për shitjen e një pasurie të paluajtshme (apartament), në aspektin juridik është realizuar shitja e të drejtave reale mbi këtë pasuri. Rregulli i përgjithshëm se shitja e pasurive të paluajtshme nuk mund të realizohet pa paguar tatimin në burim për shkak të ZVRPP-së, e cila në këtë rast vepron si agjent tatimor, ka krijuar perceptimin te bashkëshortja, në atë kohë, se çdo veprim ishte realizuar në përputhje të plotë me ligjin. Sipas subjektit, ky fakt nuk ka qenë një fenomen i cili e ka vënë atë në kushte të vazhdueshme paligjshmërie, përderisa ai nuk ka pasur dijeni, pasi shitja e këtyre të drejtave reale ka ndodhur disa vite para martesës.

Subjekti gjithashtu ka arsyetuar se, në këndvështrimin e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit pagesa e detyrimeve tatimore është kusht provueshmërie për sa i përket ligjshmërisë së të ardhurave, nga pikëpamja formale dhe procedurale, ky detyrim tatimor është paguar para datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting* sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84.2016.

22.21 Për këtë shkak ankimi, Kolegji analizoi rrethanat e faktit që e përcaktojnë atë, për t'ia nënshtruar më pas këto rrethana një analize ligjore mbi kërkimet e Komisionerit Publik. Nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. K., ka lidhur me z. Xh. M., një kontratë shitjeje me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.04.2007, për një apartament me sipërfaqe 102 m², ndodhur në Rrugën e{***}, {***}, Tiranë, për një vlerë prej 50.000 eurosh. Ky apartament ishte përfituar nga bashkëshortja e subjektit nga shoqëria “{***}” ShPK, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., datë 21.07.2005, për çmimin 32.000 euro dhe, në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes, apartamenti nuk ishte ende i regjistruar në ZVRPP Tiranë. Si dokument provues për shlyerjen e detyrimeve tatimore për fitimin e realizuar nga shitja e këtij aseti⁵¹, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën e DRT Tiranë nr. {***} prot., datë 13.08.2018. Referuar përmbajtjes së kësaj shkrese, znj. M. K. ka deklaruar në “Deklaratën e tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat”, në zërin: “Pagesat për ndërtimin, instalimin, mobilimin, ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to dhe për kalimin e të drejtës së pronësisë për periudhën dhjetor 2016, vlerën 378.000 lekë, të cilën e ka paguar më 24 janar 2017”.

22.22 Kolegji, në analizë të pretendimeve, prapësimeve, si dhe të situatës faktike lidhur me pagesën e tatimit për të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të {***}, në vlerën 50.000 euro, çmon se pretendimi i Komisionerit Publik në rastin konkret është i drejtë dhe se pagimi i tatimit mbi të ardhurat personale në janar të vitit 2017, për një transaksion që ka krijuar të ardhurën në vitin 2007, duket se është kryer vetëm për t'i shërbyer procesit të rivlerësimit, në kushtet e shmangies së pagimit të tij në kohën kur ky detyrim kishte lindur.

22.23 Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., datë 21.07.2005, lidhur mes bashkëshortes së subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, ajo ka porositur ndërtimin e apartamentit në zonën e {***} në {***}, për një çmim prej 32.000 eurosh. Në datën 23.04.2007, bashkëshortja e subjektit ka lidhur me z. Xh. M. kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme “apartament banimi” me rezervë nr. {***} rep., e nr. {***} kol., për një çmim prej 50.000 eurosh. Në përmbajtje të kësaj kontrate, në nenin 3, ndër të tjera, përcaktohet: *[...] detyrimi i shitëses, znj. K., të nënshkruajë kontratën e shitjes dhe mundësojë kalimin e pronësisë së apartamentit të shitësi, në momentin që ajo do të disponojë dokumentacionin e pronësisë së objektit të shitjes. Në këtë kusht ka konsistuar edhe vetë rezerva e kontratës së shitjes, e cila është përpiluar para se prona të regjistrohet në regjistrat publikë. Vetëm pak muaj më vonë,*

⁵¹Rezultoni se apartamenti është blerë për vlerën 32.000 euro dhe është shitur në vlerën 50.000 euro.

më datë 01.08.2007, kjo pronë është regjistruar në regjistrat e ZVRPP Tiranë, në emër të shoqërisë “{***}” ShPK dhe është shitur formalisht prej kësaj shoqërie te blerësi Xh. M., me kontratën nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 24.10.2007, për një çmim prej 3.710.000 lekësh. Kjo pronë, me këtë vlerë, është regjistruar në ZVRPP Tiranë në emër të Xh. M., duke shmangur dijeninë e kësaj zyre si agjent tatimor për vjeljen e detyrimit tatimor mbi fitimin prej 18.000 euro (50.000 euro - 32.000 euro) që kishte realizuar bashkëshortja e subjektit nga transaksioni i përshkruar më lart.

22.24 Në vështrim të këtyre fakteve, Kolegji konstaton se: **(i)** kontrata e lidhur mes personit të lidhur dhe z. Xh. M. nuk është një kontratë me anë të së cilës kalohen të drejta reale, por që synon të kalojë të drejtat e pronësisë me rezervën që kjo do të ndodhë sapo të sigurohet kushti i pajisjes së shitëses me dokumentacionin që certifikon këtë të drejtë të saj. Nga kryerja e këtij veprimi juridik, dukej se shitësja, personi i lidhur, po realizonte një fitim që konsistonte në diferencën mes çmimit të paguar për blerjen/porositjen e kësaj prone dhe shitjen e saj, për të cilin duhej të paguhej tatimi, sipas parashikimit të nenit 8, pika 1, germa “dh” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; **(ii)** kontrata e shitjes, e realizuar mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe blerësit Xh. M., duket si një kontratë që ka simuluar kontratën e vërtetë që duhej të kryhej mes personit të lidhur dhe blerësit, sipas detyrimeve të kontratës së shitjes me rezervë, me qëllim shmangien nga ardhja në dijeni e agjentit tatimor, fitimi i realizuar dhe pagimi i tatimit për këtë fitim; **(iii)** pagimi në vitin 2017 i një detyrimi të lindur në vitin 2007, duket se është bërë vetëm për qëllime të procesit të rivlerësimit dhe për të shëruar shmangien nga ky detyrim në vitin 2007, jo për mungesë të njohurive mbi ligjin apo paqartësisë për përgjegjësinë e pagimit të tij, nëpërmjet veprimeve të kalkuluara e të menduara në funksion të realizimit të kësaj shmangieje, aq më tepër duke pasur në konsideratë profilin profesional të personit të lidhur.

22.25 Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret, pagimi i tatimit për shumën prej 18.000 eurosh, në janar të vitit 2017, për shkak të rrethanave të mësipërme që lidhen me qasjen dhe sjelljen e personit të lidhur për mospagimin në kohë të tij, nuk shëron paligjshmërinë e kësaj të ardhure në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Kolegji edhe për këtë afektim të burimeve të ligjshme të përdorura për financimin e pasurisë “apartament” dhe “garazh” në pronësi të subjektit, do të vlerësojë peshën e saj në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, për shkak të një vlerësimi që lidhet me të gjitha rrethanat e çështjes.

23. Për sa i përket një qëndrimi orientues, në referim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr.84/2016, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të ardhurave të krijuara, Kolegji çmon se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar disa rrethana. *Së pari*, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. *Së dyti*, në konsideratë të organeve të rivlerësimit duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie apo një qëllim për t’u arritur. Në çdo rast, këto të ardhura nuk mund të legjitimohen nëse subjektet, personat e lidhur apo personat e tjerë të lidhur kanë qenë në kushte keqbesimi, në kufijtë e kryerjes së një vepre penale. Komisioneri Publik ka ngritur pretendime në ankim lidhur me burimet e krijimit të pasurisë (i) “apartament” me sipërfaqe totale ndërtimi 205,33 m² (158 m² sipërfaqe e brendshme dhe 47 m² sipërfaqe verandë), me adresë fshati “{***}”, fituar me kontratë shitblerjeje më datë

20.08.2015, me vlerë 82.132 euro ndërtimi, dhe (ii) truall me sipërfaqe 521,8 m², paguar për shumën 984.199 lekë, në datën 20.08.2015, në drejtim të ligjshmërisë së të ardhurave të përdorura për blerjen e kësaj pasurie që kanë si origjinë fillestare (iii) gjendjen pasurore dhe financiare të subjektit dhe ish-bashkëshortes, në momentin e krijimit të pasurisë bashkëshortore “apartament”, me sipërfaqe 73 m², në rr. “{***}”, Tiranë, dhe (iv) gjendja pasurore dhe financiare e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe e familjes së saj, duke qenë se 30.000 euro janë deklaruar si dhuratë nga prindërit e bashkëshortes, gjatë shkëputjes nga trangu familjar në vitin 2010.

23.1 Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* se si burime financiare për blerjen e saj kanë shërbyer: (i) 35.000 euro, të ardhura nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 48,27 m² në {***} Lezhë, i cili ishte blerë në shumën 2 (dy) milionë lekë, përfituar nga vendimi i pjesëtimit të pasurisë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. {***}, datë 19.06.2006; (ii) 30.000 euro, kursime të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, krijuar para martesë të ardhura të marra nga prindërit pas ndarjes nga trangu familjar në vitin 2010, siguruar nga shitja në shumën 220.000 euro e shtëpisë private 2 kate + papafingo, 268,2 m² + truall me sip. 330 m².

23.2 Në ankim, si dhe përgjatë gjykimit në Kolegj, Komisioneri Publik ka pretenduar se në hetimin e Komisionit ka mangësi në drejtim të ligjshmërisë së të ardhurave që subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga pjesëtimi i sendit të paluajtshëm në bashkëpronësi me ish-bashkëshorten, si pasojë e zgjidhjes së martesës. Ky pretendim i Komisionerit Publik lidhet si me interpretimin ligjor të detyrimit të subjektit të rivlerësimit në rastin konkret, pasuri bashkëshortore në pjesë ideale, ashtu dhe me mundësinë financiare të ish-bashkëshortëve për të krijuar këtë pasuri, si dhe aftësinë e ish-bashkëshortes për t'i paguar subjektit vlerën prej 2 900 000 lekësh.

Përgjatë gjykimit në Kolegj, Komisioneri Publik ka shprehur se është e vërtetë që subjekti i rivlerësimit, në momentin e përfitimit të shumës prej 2.900.000 lekësh, ka zgjidhur martesën me ish-bashkëshorten e tij, por në vlerësimin e Komisionerit Publik, kjo pasuri (likuiditet) e ka origjinën nga një pasuri në bashkëpronësi bashkëshortore ligjore, në pjesë ideale, dhe mbetet detyrim i subjektit të rivlerësimit për t'u provuar ligjshmëria e kësaj pasurie. I njëjti interpretim ligjor sipas Komisionerit Publik vlen dhe për hetimin e burimit të krijimit të të ardhurave, në vlerën prej 2.000.000 lekësh, në vitin 2003, që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në Tiranë, në rr. “{***}”, për të cilin Komisioneri sjell në vëmendje se është vetë subjekti, që në deklarinë fillestar të pasurisë në vitin 2004, si burim për krijimin e kësaj pasurie, ka deklaruar kursimet familjare, të tij dhe të bashkëshortes, në një regjim bashkëpronësie ligjore në pjesë ideale.

23.3 Subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pretendim të Komisionerit Publik, në gjykimin në Kolegj ka prapësuar këto qëndrime, duke u shprehur se në fazën e dytë të zgjidhjes së martesës, atë të pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore, në kushtet kur sendi nuk mund të pjesëtohej në natyrë, është bërë aktmarrëveshja, nëpërmjet së cilës ai ka hequr dorë nga e drejta e pronësisë mbi apartamentin (e mobiluar) dhe mbi një pjesë të investimit të bërë në të, në këmbim të përfitimit të shumës prej 2.900.000 lekësh. Ky fakt është i pasqyruar në aktmarrëveshjen dhe në vendimin nr. {***}, datë 19.06.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Subjekti gjithashtu ka parashtruar elementet përbërëse të kësaj shume dhe arsyet pse u arrit në marrëveshje të dakordësohej për këtë vlerë⁵².

⁵² (i) Çmimet e shitjes së apartamenteve në atë kohë pësuan një rritje të menjëhershme dhe shumë të konsiderueshme, me një marzh prej 50%-60%, krahasuar me vitin 2003. Në lidhje me rritjen në përqindje, ju lutem referojuni tendencës së rritjes së çmimeve mesatare të shitjes në qytetin e Tiranës, sipas udhëzimit nr. 1, datë

23.4 Lidhur me modalitetet e pagesës së kësaj shume, subjekti ka sqaruar se ketë shumë ish-bashkëshortja ia ka dorëzuar në *cash* avokates së tij, dhe kjo e fundit ia ka dorëzuar subjektit brenda së njëjtës ditë⁵³ në të cilën është shpallur vendimi i mësipërm i gjykatës, i cili miratoi marrëveshjen për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore. Përgjatë gjykimit në Kolegj, në mbështetje të prapësimeve të tij lidhur me vlerën e përfituar nga pjesëtimi i pasurisë bashkëshortore, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës së re kërkesëpadinë për zgjidhje martesë të datës 25.01.2006, të nënshkruar prej tij.

23.5 Në përmbledhje të situatës faktike të këtij shkak, ashtu siç është shprehur në paragrafin 23.1, referuar deklarimeve periodike të subjektit, si dhe deklaratës së pasurisë *vetting*, shuma prej 2.900.000 lekësh është përdorur prej tij për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 48,27 m² në {***}, Lezhë, me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 25.1.2010, të blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, për çmimin 2.000.000 lekë.

Më pas subjekti i rivlerësimit, me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 24.05.2011, i ka shitur apartamentin në {***}, Lezhë, me sipërfaqe 48,27 m², z. M. I. për një vlerë prej 38.000 eurosh⁵⁴ (në çmimin e shitjes prej 38.000 eurosh, janë përfshirë dhe shpenzimet e mobilimit në shumën 3.000 euro) dhe e gjithë vlera e përfituar nga shitja ka shkuar për financimin e apartamentit dubleks në {***}, Durrës, të blerë prej subjektit e bashkëshortes në vitin 2015.

23.6 Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, të prapësimeve të subjektit dhe të rrethanave faktike që kanë rezultuar nga aktet e administruara, Kolegji mori në shqyrtim së pari statusin e ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. A. Gj., në këtë proces, për të përcaktuar më tej, në funksion të këtij statusi, edhe detyrimin e subjektit të rivlerësimit në raport me shumën prej 2.900.000 lekësh, dhënë atij prej saj. Kolegji, nga analiza e rrethanave të faktit, konstatoi se subjekti ka zgjidhur martesën me znj. A. Gj. më datë 11.05.2006, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, ish-bashkëshortët kanë pjesëtuar pasurinë e përbashkët të gjendur në regjimin e bashkësisë ligjore, në kuptim të nenit 72 e vijues të Kodit të Familjes, duke i dhënë fund bashkëpronësisë me marrëveshje, e cila është miratuar me vendimin nr. {***}, datë 19.06.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas kësaj marrëveshjeje të miratuar, ish-bashkëshortja ka marrë në pronësi apartamentin ish-pronë e përbashkët dhe pajisjet brenda tij, ndërsa subjekti ka humbur të drejtat mbi këtë pasuri duke u kompensuar për pjesën tij në bashkëpronësi, me 2.900.000 lekë. Rezulton se kjo shumë i është

08.05.2003, "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave [...]" dhe udhëzimit nr. 5, datë 07.09.2006, "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave [...]", një referencë kjo statistikore e cila llogaritet prej 50%. Pra, vetëm vlera e apartamentit në qershor të vitit 2006, referuar kësaj rritjeje, llogaritej të ishte 3.000.000 lekë, pra pjesa ime takuese prej 50% llogaritej të ishte në shumën 1.500.000 lekë.

(ii) Shuma e shpenzuar 100% nga ana ime në lidhje me shpenzimet e mobilimit prej 900.000 lekësh, në vitin 2004. Vlera prej 300.000 lekësh, e cila paraqiste ½ e depozitës bankare në zotërim të ish-bashkëshortes, në shumën 600.000 lekë.

(iii) Gjithashtu shuma e mbetur prej 200.000 lekësh i referohet situatës faktike në atë kohë, sipas së cilës është realizuar përdorimi vetëm nga ish-bashkëshortja i apartamentit nga fillimi i vitit 2005 (kjo për shkak të marrëdhënieve jo të mira të cilat ishin shfaqur që në fillim të vitit 2005 e të cilat çuan edhe drejt zgjidhjes së martesës), e veçanërisht përdorimi i banesës pas zgjidhjes së martesës gusht 2005 deri në muajin qershor 2006.

⁵³Me shkresën nr. {***} prot., datë 15.01.2019, të Raiffeisen Bank, konfirmohet derdhja *cash* e shumës 2.900.000 lekë në datën 13.06.2006, nga znj.A. Gj. dhe tërheqja e po kësaj shume prej saj në datën 19.06.2006.

⁵⁴Nga aktet e administruara, rezulton se është kryer transferta bankare pranë Raiffeisen Bank më datë 24.05.2011, në shumën 29.900 euro, nga z. M. I., me përfitues z. Kastriot Selita, me përshkrimin e veprimit: "Kalim fondi për blerje shtëpie".

dhënë në dorë subjektit *cash* nga avokatja e tij, e cila e ka marrë atë prej ish-bashkëshortes, në zbatim të disponimit të gjykatës për ekzekutimin e vendimit brenda ditës së shpalljes së tij. Kjo shumë i është vënë në dispozicion subjektit, në datën 19.06.2006, ndërsa martesë ishte zgjidhur në datën 11.05.2006 dhe bashkëjetesa, sipas deklarimeve të subjektit, ishte ndërprerë *de facto* edhe më herët.

23.7 Në këto rrethana, Kolegji çmon se periudha në të cilën ish-bashkëshortja e subjektit ka disponuar dhe ka vënë në dispozicion të tij shumën prej 2.900.000 lekësh, ka qenë përtej kohës kur subjekti dhe ajo ishin në kushtet e bashkësisë ligjore, pasi martesë ishte zgjidhur dhe palët vepronin financiarisht në autonomi të plotë. Në këto kushte, përveç faktit se nuk rezultoi që subjektit t'i jetë shtuar ndonjë pasuri në momentin e përfitimit të shumës prej 2.900.000 lekësh, por vetëm të jetë kompensuar me një pasuri likuiditet në vlerën korresponduese të të drejtave të tij pasurore në bashkësinë ligjore nga e cila ai ka dalë, gjithashtu edhe ish-bashkëshortja e tij nuk gëzonte në këtë moment ndonjë status relevant për procesin e rivlerësimit, për sa kohë që lidhja mes saj dhe subjektit kishte përfunduar dhe palët nuk kishin më asnjë lidhje të ndonjë natyre nga ato që parashikojnë pikat 13 e 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se në kushtet kur subjekti e ka përfituar shumën prej 2.900.000 lekësh, si një konvertim i pjesës së tij ideale në bashkësinë ligjore të krijuar prej martesës, dhe ajo nuk ka përfaqësuar pasuri të kësaj bashkësie, ai nuk mund të ngarkohet me detyrimin që të provojë në këtë proces mundësinë e ish-bashkëshortes së tij për të krijuar me burime të ligjshme këtë shumë.

23.8 Kolegji mori në shqyrtim edhe mundësinë e subjektit dhe ish-bashkëshortes së tij për të krijuar me burime të ligjshme pasurinë apartament prej 73 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, të blerë në vitin 2003, duke qenë se kjo ishte një nga pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit.

Kolegji ia nënshtroi analizës financiare të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe ish-bashkëshortes për periudhën 1999-2003 dhe konkludoi në finale me të njëjtin rezultat negativ që tregon për mungesë të burimeve të ligjshme të subjektit për të përballuar shpenzimet dhe krijuar pasurinë në të njëjtën masë sa edhe Komisioni, në vlerën prej (-) 239.626 lekësh.

Ndonëse kjo diferencë negative duket e vogël, konsideruar kohën kur është krijuar, të ardhurat e familjes në atë kohë dhe vlerën e investimit të kryer, në vlerësimin e Kolegjit është një vlerë e cila duhet të vlerësohet gjithashtu në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

23.9 Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin tjetër të Komisionerit Publik në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë së të ardhurave që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë doubleks me sip. 205,33 m² në {***}, Durrës, që është shuma 30.000 euro, si kursime të bashkëshortes të krijuara para martesë dhe të marra nga prindërit pas ndarjes nga trugu familjar në vitin 2010, siguruar nga shitja në shumën 220.000 euro e shtëpisë private me 2 kate në {***}, {***}. Komisioneri Publik vlerëson se mbetet e paqartë nëse kjo shumë do të kualifikohet si dhurim dhe, nëse kualifikohet si e tillë, eventualisht do të duhet t'i nënshtrohet pagimit të detyrimeve tatimore, sipas ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Për pasojë, Komisioneri Publik ka çmuar të nevojshëm një interpretim/orientim nga Kolegji lidhur me ligjshmërinë shumëve monetare të dhuruara në raport me pagimin e tatimit për to.

23.10 Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë qëndrim të Komisionerit duke arsyetuar se, në lidhje me trajtimin tatimor të "dhurimit të shumëve monetare", në sqarimet e dërguara Komisionit në datën 10.06.2019, ka shprehur se, bazuar në pikën "g" të nenit 8 të ligjit nr. 8438,

datë 28.12.1998, "Për tatimin për të ardhurat" (i ndryshuar), si dhe në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, "Për tatimin për të ardhurat" (i ndryshuar), transaksioni nuk siguron të ardhura tatimore shtesë nëse baza tatimore mbi të cilën llogaritet tatimi është "0" (shuma e marrë – shumën për të cilën është paguar tatim), pra, për rrjedhojë, edhe tatimi është "0" lekë. Në këto kushte, nuk rezulton të ketë detyrim për pagesë të tatimit për dhurimin e shumës monetare, për sa kohë që është paguar më parë tatimi për këtë shumë⁵⁵.

23.11 Kolegji, në vlerësim të situatës faktike dhe nevojës për mbajtjen e një qëndrimi orientues, referuar nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, konstaton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar si dhuratë nga familja e saj, shumën prej 30.000 eurosh në deklaratën periodike të vitit 2010. Kjo shumë gjenerohet prej shumës 220.000 euro, të përfituar nga shitja e pasurisë së përbashkët e cila i është nënshtruar pagimit të detyrimeve tatimore në kohën e krijimit.

Kolegji vlerëson të abstragojë çështjen e përcaktimit të pjesës takuese të personit të lidhur në pasurinë likuiditet, të krijuar nga shitja e shtëpisë, për sa kohë që kjo shumë është deklaruar si dhurim në deklaratën periodike të pasurisë dhe nuk është lidhur me të drejta pasurore të saj mbi të, por me vullnetin e bashkëpronarëve të tjerë për të bërë këtë lloj shpërndarje të të ardhurave të krijuara nga shitja. Duke e konsideruar si të tillë, babai i bashkëshortes së subjektit, z. A.K., gëzon statusin e personit tjetër të lidhur për këtë pasuri dhe, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ekziston detyrimi për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume.

23.12 Siç është deklaruar edhe nga subjekti dhe pranuar edhe nga Komisioni dhe Komisioneri Publik⁵⁶, babai i bashkëshortes i ka dhuruar asaj 30.000 euro në momentin që ajo është ndarë prej trungut familjar, nga shuma e mbetur prej 60.000 eurosh, të gjeneruara prej shitjes së shtëpisë në {***}, në shumën prej 220.000 eurosh. Duke e konsideruar këtë pohim të pranuar prej organeve të rivlerësimit si të tillë, Kolegji vlerëson se dhuruesi në këtë rast konfirmon faktin e deklaruar prej subjektit dhe, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duhet të verifikohet burimi i krijimit të kësaj pasurie. Sipas historikut të krijimit të saj e të elaboruar gjerësisht në këtë vendim, konstatohet se kjo shumë është krijuar/ekstraktuar prej një pasurie likuiditet të krijuar nga një transaksion i ligjshëm, siç është kontrata e shitblerjes së pasurisë "banesë", në pronësi të familjes në {***}, si edhe janë paguar detyrimet tatimore në kohën e krijimit të saj, siç rezulton nga dokumentet e administruara⁵⁷. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se plotësohen kërkesat e dispozitës së cituar për garantimin e ligjshmërisë së krijimit të kësaj pasurie, e cila i është dhuruar bashkëshortes së subjektit.

23.13 Në analizë të pretendimit nëse një tjetër kusht për ligjshmërinë e kësaj pasurie duhet të ishte ose jo pagimi i detyrimeve tatimore që duheshin aplikuar mbi vetë këtë shumë, Kolegji vlerëson se është një pretendim që nuk qëndron, duke arsyetuar si më poshtë.

⁵⁵Në këtë rast referohet në faktin që për të gjithë shumën e përfituar nga shitja e banesës së familjes së origjinës së bashkëshortes në {***}, Tiranë, me qëllim kalimin e pronësisë shitësit A. M. pranë agentit tatimor ZRVPP – Tiranë, prej babait të bashkëshortes është paguar tatimi për kalim pronësie (diferenca midis vlerës së shitjet së pronës 220.000 euro – 7,2 milionë lekë vlera e regjistrimit të saj;për më tepër shih trajtimin për shkakun 1 të ankimit të Komisionerit Publik).

⁵⁶Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.04.2019, sipas së cilës vërtetohet që bashkëshortja, znj. M. K., ka marrë cash shumën 30.000 euro nga babai i saj (shih poshtëshënimin nr. 36 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi).

⁵⁷Referuar dokumentacionit bankar, A.K., në datën 31.07.2008, në Bankën Raiffeisen ka derdhur (cash në sportel) shumën 1.902.430 lekë, e vjelë nga agjenti tatimor zyra e ZRVPP Tiranë, që i korrespondon detyrimit tatimor të përlllogaritur prej zyrës dhe të vjelë prej saj, për efekt të kontratës së shitjes së banesës.

23.14 Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon vetëm detyrimin e subjektit dhe personit tjetër të lidhur për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë prej personit tjetër të lidhur. Në këtë kuptim, verifikimi i ligjshmërisë së krijimit duhet të ndalet deri te burimi i krijimit të saj, që është mënyra se si personi tjetër i lidhur e ka krijuar atë. Referuar përmbajtjes së dispozitës së cituar, subjekti nuk është individ i qytetar që e ka krijuar këtë pasuri, por atë e ka përfutur bashkëshortja e tij nëpërmjet dhurimit që, sipas përkufizimit të nenit 761/1 të Kodit Civil: *Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale, të cilat kjo i pranon, i ka sjellë atij të drejta pasurore mbi këtë pasuri, pa pasur ndonjë detyrim lidhur me të. Për pasojë, në këtë kuptim, subjekti është i zhveshur në kuptim të këtij ligji nga ndonjë detyrim i cili do të kondiciononte ligjshmërinë e pasurisë përtej provimit të krijimit të saj prej personit të lidhur nga burime të ligjshme e të verifikueshme.*

23.15 Përtej arsyesimit të përdorur në lart, Kolegji mori në shqyrtim edhe parashikimet e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të cilat u thirrën në analizë për shkak të kërimit të Komisionerit Publik. Në nenin 8 të këtij ligji, i cili parashikon të ardhurat për të cilat ekziston detyrimi për pagimin e tatimit, nuk gjendet një parashikim i posaçëm që të kualifikojë shumat monetare të dhuruara si të ardhurat që u nënshtohen detyrimeve tatimore. Neni 8 parashikon, ndonjëse jo në mënyrë shteruese, listën e transaksioneve që krijojnë të ardhura të tatueshme, pa përfshirë në to dhurimet e shumave monetare. Në këndvështrim të parashikimit të nenit 8, germa “g” e tij, e cila ka lënë hapur mundësinë e parashikimit të të ardhurave të ndryshme nga ato që krijohen sipas germave të tjera, Kolegji vlerëson se kjo dispozitë duhet parë lidhur me aktet nënligjore të cilat kanë dalë në zbatim të këtij ligji e që kanë definuar të ardhura të tjera, të cilat mund dhe duhet të përfshihen në parashikimin e nenit 8, germa “g” e ligjit. Sipas udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, pika 2.3.9, të Ministrisë së Financave, për aplikimin e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, sqaron se me “të ardhura të tjera” duhet të konsiderojmë: *[...] Të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen (pika g). Në këtë grup përfshihet çdo lloj e ardhure me burim në Republikën e Shqipërisë, e realizuar nga individë rezidentë ose jorezidentë, por që nuk identifikohet në format e paraqitura më lart. Në këtë grup përfshihen të ardhurat nga sponsorizimet (p.sh., individë të ndryshëm që nuk janë të regjistruar në organet tatimore marrin sponsorizime nga burime të ndryshme dhe i përdorin për aktivitete artistike apo sportive), të ardhura nga aktiviteti profesional, si: mësimdhënie, trajnime, shkrime në gazeta etj., kur përfutuesi nuk është i regjistruar në organet tatimore (dhe aktivitete të tilla i ka të përkohshme apo dytësore). Siç shihet, në të gjitha rastet personi përfutues nuk është i regjistruar në organet tatimore, pra nuk i deklaroi ato të ardhura në të ardhurat e tatueshme të biznesit.*

Kjo do të thotë se organet tatimore të cilat kanë detyrimin të garantojnë pagimin e detyrimeve tatimore nga çdo taksapagues e të vjelin çdo detyrim të kërkueshëm e të pagueshëm sipas ligjit, nuk kanë pasur tagër ligjor të angazhohen në drejtim të vjeljes së ndonjë detyrimi të kësaj natyre.

23.16 Mbështetur në legjisllacionin e sipërcituar që rregullon tatimin mbi të ardhurat (pa kryer vlerësimin) nëse është shumë e tatuar në momentin e krijimit të saj si e ardhur apo jo), konstatohet se “dhurimi i vlerave monetare” nuk listohet te kategoritë që bëjnë pjesë te “të ardhura të tjera”, për të cilat mund të aplikohet tatimi në burim (*sipas pikës “g” të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”*) pasi dhurimet e vlerave monetare në përgjithësi, nuk përfshihen në pikat e specifikuar të nenit 8 mbi të ardhurat e tatueshme, por as në kategorinë e “të ardhurave të tjera”, të cilat përfshijnë të ardhura nga sponsorizimet, mësimdhënia, aktivitete sportive, trajnime, shkrime në gazeta etj., të cilat janë të

ardhura që krijohen pas kryerjes së një aktiviteti të përkohshëm apo dytësor. E njëjta situatë paraqitet edhe me modulën e dhënë në platformën elektronike DIVA, e aplikueshme që prej vitit 2011, mbi vetëdeklarimin e të ardhurave, e detyrueshme për t'u plotësuar nga ata persona me të ardhura vjetore vlerën 2.000.000 lekë, tek e cila konstatohet se nuk ka rubrikë që kërkon deklaram mbi dhurimet e shumave monetare. Në vijim të këtij arsyetimi, vlerësohet si i padrejtë pretendimi i Komisionerit Publik se kjo e ardhur nuk përfshihet në ato të parashikuara nganeni 8/1 i ligjit nr. 8438/1998, të cilat janë të përjashtuara nga pagimi i tatimit mbi të ardhurat personale. Kolegji vlerëson se kategorizimi në këtë dispozitë do të ishte relevant për të ardhura për të cilat parashikohet se duhet paguar tatimi e që përfshihen në nenin 8 të analizuar më lart, por, për sa kohë që kjo e ardhur nuk përfshihet në këtë kategori, nuk konsiderohet i aplikueshëm në raport me të as zbatimi i këtij neni të ligjit.

23.17 Arsyetimi i mësipërm gjendet në pajtueshmëri edhe me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 18, datë 25.07.2008⁵⁸, në të cilin arsyetohet sa vijon:

[...] Taksat dhe tatimet nuk janë detyrime të negociueshme dhe mbliidhen nga organet tatimore, me mënyrat e përcaktuara me ligj. Marrëdhëniet e tatim-taksave janë marrëdhënie ligjore detyrimi ndërmjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe, si të tilla, ato mund të përcaktohen vetëm me ligj. Megjithatë, thjesht përcaktimi i tatim-taksave si marrëdhënie detyrimi nuk është i mjaftueshëm që të passjellë automatikisht pagesën dhe mbledhjen e tyre në kohën dhe mënyrën e duhur. Është gjithashtu e nevojshme të rregullohet procedura për pagesën e tyre, e cila inter alia do të përfshinte jo vetëm përmbajtjen e detyrimit, por gjithashtu çështjet organizative të administratës tatimore, metodat e llogaritjes të pagesës së tatimeve etj., pra rregullimi ligjor përfshin jo vetëm përcaktimin e tyre me ligj, por edhe procedurën e ekzekutimit të tyre.

Ky arsyetim që përmban frymën e parashikimit të nenit 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, tek i cili përcaktohet se: *Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre, caktohen me ligj*, potencon argumentin/interpretimin se në kushtet e paparashikueshmërisë së detyrimit në mënyrë eksplicite dhe të qartë, taksapaguesit nuk mund të ngarkohen me këtë detyrim dhe as të ndëshkohen disiplinarisht sepse nuk kanë supozuar/nënkuptuar apo zgjedhur si opsion pagimin vullnetar të këtij “detyrimi”.

23.18 Pavarësisht arsyetimit të mësipërm, për t'i dhënë përgjigje pretendimit të Komisionerit Publik në drejtim të ligjshmërisë së shumës së dhuruar në mungesë të pagimit të ndonjë tatimi mbi të nga përfituesja, personi i lidhur, Kolegji, për të pasur një panoramë sa më të plotë rreth zbatimit ndër vite të legjislacionit lidhur me tatimin e shumave monetare të fituara nëpërmjet dhurimit, me vendim të ndërmjetëm të datës 31.05.2021, bazuar në përcaktimet e nenit F të Aneksit të Kushtetutës, nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi të kërkojë nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, informacion: *Nëse në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të legjislacionit në fuqi ndër vite, a janë tatuar apo tatohen shumat monetare të përfituara nga individët nëpërmjet dhurimit*. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Ministria e Financave me shkresën nr. {***} prot., datë 16.06.2021, shpjegon se konkretisht neni 8 i ligjit nr. 8438/1998, liston llojet e të ardhurave personale të cilat janë objekt i tatimit mbi të ardhurat personale dhe se në dispozitat e këtij neni “shumat monetare të përfituara si e ardhur nga një individ nëpërmjet dhurimit”, nuk janë parashikuar në mënyrë eksplicite si kategori e tatueshme. Këto shuma nuk janë trajtuar si të tatueshme as në udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i dalë në zbatim të ligjit nr. 8438/1998. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Drejtoria

⁵⁸Shih:http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

e Përgjithshme e Tatimeve në përgjigjen e saj të përcjellë Kolegjit me shkresën nr. {***} prot., datë 15.06.2021, tek e cila ka shpjeguar gjithashtu se ky ka qenë në vazhdimësi qëndrimi i kësaj drejtorie lidhur me tatimin e vlerave monetare të dhuruara dhe se në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të legjislacionit në fuqi ndër vite, individit përfitues nga dhurimi i shumave monetare nuk i nënshtrohet nenit 8 të ligjit nr. 8438/1998 dhe se, sipas parimit të dispozitave ligjore në fuqi, e njëjta e ardhur nuk mund të tatóhet më shumë se një herë.

Së fundmi, Kolegji vlen të sjellë në vëmendje jurisprudencën e tij në lidhje me një çështje të ngjashme, e cila ka qenë po ashtu në linjën e arsytimit të bërë më lart⁵⁹.

23.19 Për sa më sipër, Kolegji çmoi se kërkimi i Komisionerit i lidhur me këtë shkak, nuk është i mbështetur dhe se shuma prej 30.000 eurosh, në çfarëdo statusi të konsiderohet, qoftë si pjesë takuese e bashkëshortes, qoftë si dhurim nga babai i saj, duket se i plotëson kushtet formale të ligjshmërisë së krijimit, duke u konsideruar për pasojë si një burim i ligjshëm në financimin e pasurisë së blerë në fshatin turistik “{***}”, të ndodhur në {***}, Durrës.

23.20 Në ankim, Komisioneri Publik sjell në vëmendje se nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, rezulton se jo e gjithë vlera e përfituar prej subjektit të rivlerësimit nga shitja e apartamentit në {***}, Lezhë, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.05.2011, blerësit M. I., të jetë paguar nëpërmjet sistemit bankar. Vetëm vlera 29.000 euro është paguar në këtë rrugë, ndërsa pjesa tjetër rezulton të jetë paguar *cash*. Për këtë pagesë, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime dhe ky i fundit në parashtrimet e tij të datës 16.04.2019, i është përgjigjur se: *[...] në lidhje me pagesën në cash të shumës 8.100 euro, si pjesë përbërëse e çmimit të apartamentit në {***} të Lezhës, përveç kontratës së shitjes të cilën jua kemi dërguar më parë, ju vëmë në dispozicion edhe deklaratën noteriale, repertori nr. {***}, koleksioni nr. {***}, datë 04.04.2019, të blerësit, z. M. I., sipas së cilës vërtetohet kjo pagesë cash.*

23.21 Lidhur me këtë situatë faktike, Komisioneri Publik në ankim shpreh se, referuar jurisprudencës së Kolegjit në lidhje me situata të ngjashme në procesin e rivlerësimit të subjekteve të tjera, vlerëson se kjo deklaratë noteriale daton pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, është administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si e tillë, ashtu sikurse edhe pretendimet e subjektit mbeten thjesht në nivel deklarativ, nuk mund të konfirmojë e vetme dhe jo në harmoni me prova të tjera, faktet e deklaruara në të kanë ndodhur realisht.

23.22 Lidhur me këtë qëndrim të Komisionerit Publik, Kolegji konstaton *së pari* se qëndrimi dhe arsytimi i deritanishëm i Kolegjit në gjykimin e çështjeve, duke iu referuar analizës dhe rrethanave specifike të çështjeve, ka qenë se të vetme, deklaratat noteriale të përpiluara përgjatë procesit të rivlerësimit, nuk mund të provojnë një fakt të caktuar, por ato marrin vlerë kur mbështeten nga të dhëna, fakte apo indicie të dëshmuara/provuara nga dokumente të tjera. Duke iu rikthyer çështjes objekt shqyrtimi, deklaratat noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., e datës 04.04.2019, e lëshuar nga blerësi M. I. lidhur me modalitetet e pagesës së apartamentit në {***}, konfirmon çmimin e përcaktuar në kontratën e shitblerjes së kësaj prone, si edhe i jep

⁵⁹Në vendimin e Kolegjit nr. 1/2/2018 (JR), datë 17.12.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit B. D., Kolegji ka arsyetuar sa vijon: “25.2.Lidhur me shkakun e ankimit, në të cilin Komisioneri Publik kërkoi që Kolegji i Apelit të vlerësojë nëse janë objekt i tatimit të ardhurat që rrjedhin nga huat, trupi gjykues i Kolegjit të Apelit vlerëson se Kushtetuta nuk e ka lënë në diskrecion të organeve ligjzbatuese përcaktimin e të ardhurave “të tatueshme”, por ia ka njohur vetëm ligjit. Për këtë arsye, pjesa e shkëputur e fjalisë “të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e parashikuara në këtë nen” mund të gjejë zbatim vetëm brenda një norme pozitive ligjore, jo akti nënligjor dhe as diskrecional të organeve publike. Neni 155 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj”.

kuptim pagesës së tatimit të kryer mbi vlerën e plotë të shitjes së apartamentit prej 35.000 eurosh. Në këtë kuptim, kjo deklaratë noteriale nuk sjell ndonjë element të ri të panjohur, të cilin synon ta provojë si e vetme, por konfirmon ato informacione që i gjejmë edhe në aktet e cituara, për pasojë vlera e saj provuese ka relevancë në qëndrimet që mbahen për këtë çështje.

24. *Kolegji mori në shqyrtim shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, që lidhet me blerjen prej subjektit të automjetit Dimler në vitin 2009, për të cilin ai pretendon se në analizë të dokumentacionit të administruar, si dhe bazuar në praktikën e deritanishme të Kolegjit për raste analoge, në analizimin e mundësisë financiare të personave të tjerë të lidhur, vlerëson se të ardhurat e realizuara nga z. H. S. (vëllai i subjektit të rivlerësimit) në vitin 2009, janë të pamjaftueshme për të justifikuar me burime të ligjshme, shumën e dhuruar subjektit të rivlerësimit.*

24.1 Lidhur me këtë pretendim të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar para Kolegjit, ashtu siç ka shprehur edhe para Komisionit se vëllai i tij ka jetuar në Itali nga viti 2004, dhe vetëm në fillim të vitit 2009 ka mundur të pajiset me leje qëndrimi në shtetin italian, dhe kjo është arsyeja që pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga puna në ndërtim ka filluar në këtë periudhë. Ndërkohë subjekti ka pretenduar se përgjatë hetimit administrativ, ka dokumentuar shumat e dërguara prej vëllait për periudhën që ai ndodhej në Itali, përmes institucioneve financiare jobankare. Subjekti gjithashtu ka shprehur se është e vërtetë që të ardhurat e deklaruara prej vëllait pranë organeve tatimore janë në shumën 4.204,2 euro, por të ardhurat e fituara nga puna e tij në sektorin e ndërtimit janë të tilla që kanë përballuar shpenzimet e tij për jetesë, madje ai ka ndihmuar me të ardhura prindërit në mënyrë të vazhdueshme, provuar kjo me dokumentacionin dërguar pranë Komisionit. Gjithashtu, në shpjegimet e tij në Kolegj, subjekti ka nënvizuar faktin se, megjithëse ka pasur mundësi për të përballuar blerjen e makinës tërësisht me kursimet e tij (kursime 100.000lekë + 200.000 lekë + 200.000 lekë), të deklaruara përkatësisht në deklaratat periodike të viteve 2007, 2008, 2009, ai ka deklaruar të vërtetën, ashtu siç ka ndodhur.

24.2 Në analizim të këtij shkak, Kolegji e sheh të nevojshme të arsyetojë në dy drejtime. *Së pari*, Kolegji konstaton se vëllai i subjektit ka konfirmuar dhënien e shumës 4.000 euro si dhuratë vëllait të tij, duke plotësuar kushtin e parë që parashikon neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. *Së dyti*, Kolegji vlerëson se kjo shumë duhet t'i nënshtrohet verifikimit të testit ligjor, të parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të ligjshmërisë së krijimit të saj prej vëllait të subjektit, me cilësinë e personit tjetër të lidhur.

Në këtë kuptim, rezulton se vëllai i subjektit ka krijuar këtë shumë të dhuruar nëpërmjet burimeve të ligjshme dhe se ka deklaruar konform legjislacionit vendas fitimin e kësaj të ardhure nëpërmjet punësimit në Itali, duke iu nënshtuar për këtë shumë edhe ndalesave për sigurime e detyrime tatimore. Në këto kushte, duket se ai provon ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, referuar gjithashtu edhe qëndrimeve të mbajtura më parë në jurisprudencën e Kolegjit për çështje të ngjashme, arrihet në konkluzionin se subjekti dhe personi tjetër i lidhur provojnë ligjshmërinë e shumës së dhuruar që ka shërbyer si burim i deklaruar për blerjen e automjetit.

24.3 Kolegji e analizoi këtë çështje edhe në drejtim të mundësisë së vëllait të subjektit për ta dhënë këtë shumë si dhuratë. Në këtë kontekst, Kolegji mban në konsideratë se, ashtu siç edhe subjekti ka deklaruar, për vëllain e tij ka qenë e pamundur të jetonte në Itali vetëm me këto të ardhura të deklaruara e të tatuara për të gjithë periudhën e marrë në analizë, 2004-2009. Në këtë logjikë, vëllai i subjektit duket se ka realizuar të ardhura të tjera që i kanë mundësuar atij jetesën dhe mbështetjen për familjarët e origjinës në Shqipëri. Për pasojë, do të ishte jorealiste nëse do

vlerësohej ngushtësisht kjo mundësi për t'i dhënë këto para jashtë një vlerësimi logjik e të arsyeshëm brenda kontekstit të marrëdhënieve familjare shumë të afërta e dhënies së një shume përgjithësisht me një efekt relativ në jetesën e një individi. Përveç sa më lart, edhe fakti se subjekti kishte fonde monetare të vetat, të cilat mund t'i përdorte për blerjen e automjetit dhe dhurata e vëllait nuk e nxjerr atë nga ndonjë situatë negative financiare, është një element tjetër që mbështet konkluzionin se vëllai i subjektit arsyeshëm duket të ketë dhuruar këtë shumë subjektit, për të cilën ai provon burimin e ligjshëm të krijimit.

24.4 Në përfundim, Kolegji çmon të drejtë qëndrimin e Komisionit për trajtimin e kësaj dhurate në kuptim të parashikimeve ligjore të këtij procesi.

25. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, Kolegji, ndryshe nga Komisioni, vlerëson se subjekti u gjend me probleme në drejtim të verifikimit e kontrollit të kriterit të pasurisë, të cilat konsistojnë në:
- a) Mungesën e burimeve të ligjshme për të financuar ndërtimin e banesës të ndodhur në {***}, Tiranë (me sipërfaqe ndërtimi 268,2 m² dhe truall 330 m²) nga familja e origjinës së personit të lidhur, në shumën prej 1.425.020 lekësh, në fund të vitit 2003.
 - b) Konstatimin e mungesës së ligjshmërisë së të ardhurës prej 18.000 eurosh, të fituar nga personi i lidhur në vitin 2007, nëpërmjet shitjes së apartamentit me anë të kontratës nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 23.04.2007, për shkak të mospagimit të detyrimeve tatimore sipas nenit 8, germa “dh” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.
 - c) Mungesën e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}” në vitin 2003, në shumën prej (-) 239.626 lekësh, duke u kualifikuar kjo situatë sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
 - ç) Deklarimin jo të saktë e në përputhje me ligjin të burimit të financimit të apartamentit të blerë prej personit të lidhur nga shoqëria “{***}” ShPK, me kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., datë 21.07.2005, duke u kualifikuar kjo situatë jo në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

25.1 Në vlerësim të konkluzioneve të mësipërme, Kolegji çmon se këto defekte nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit. Problematikat të cilat lidhen me pasuritë e personit të lidhur të krijuara para martesës me subjektin e rivlerësimit, nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në këtë proces për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit. Ndërsa problematikat që lidhen me pasuritë e vëna prej tij apo defektet në deklarinin e saj, të cilat përsëri konsistojnë në një situatë të mbarsur nga pasuritë e personit të lidhur, të krijuara para martesë, gjithashtu nuk janë të mjaftueshme e proporcionale me vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit në raport me kontrollin e këtij kriteri.

25.2 Në këto kushte, Kolegji çmon se këto çështje, ndonëse nuk mjaftojnë për të arritur në konkluzionin e mësipërm si një shkak më vete shkarkimi, mjaftojnë për të arritur në konkluzionin se subjekti nuk arriti një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë dhe, sipas nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ato do të vlerësohen prej Kolegjit në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj subjektit.

II. Vlerësimi për kontrollin e aftësive profesionale

26. Nga një vështrim tërësor i shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik në drejtim të kontrollit të aftësive profesionale, Kolegji konstaton se pretendimet e ngritura për këtë kriter të rivlerësimit janë: (i) në drejtim të kujdesit të subjektit për të shmangur gjykimin në kushtet e konfliktit të interesit; (ii) në drejtim të sjelljes/kujdesit të subjektit për të shmangur çdo situatë të konfliktit të interesit në dukje; (iii) në drejtim të pretendimeve për mungesë të aftësisë për të zbatuar drejt ligjin dhe për të shmangur standarde të dyfishta në gjykimin e çështjeve për të cilat janë paraqitur denoncime nga qytetarët, ente publike e shoqata si gjatë gjykimit në Komision, ashtu edhe në Kolegj.

26.1 Lidhur me pretendimin se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit çështjet me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, Komisioneri Publik ka argumentuar se:

- (i) Gjykimi prej subjektit i çështjes me palë ndërgjyqëse, ndër të tjera, edhe shoqërinë “{***}” ShPK, për të cilën prej Gjykatës Administrative të Apelit është dhënë vendimi nr. {***}, datë 20.5.2014, është një rast që nuk është hetuar dhe trajtuar nga ana e Komisionit, që merr rëndësi si për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit, ashtu dhe në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve apo vlerësimit tërësor të çështjes.
- (ii) Lidhur me gjykimin prej subjektit të çështjes me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK, faktet e analizuara në arsyetimin e Komisionit, nuk përjashtojnë dijeninë e subjektit të një rrethane të tillë, marrëdhënien kontraktuale me bazë interesë pasuror të personit të lidhur dhe detyrimin e tij për të marrë masa në kushtet e neneve 72-73 të Kodit të Procedurës Civile, me qëllim shmangien në çdo rast të rrethanave apo arsyeve serioze mbi paanshmërinë e tij.

26.2 Komisioneri Publik në ankim, lidhur me këtë pretendim, ka vlerësuar se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është në pajtueshmëri me situatën faktike të konstatuar, pasi edhe pas kalimit të barrës së provës, mbetet e paqartë nëse subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Duket se Komisioni i ka dhënë rëndësi vlerësimit të rrethanave jo të drejtpërdrejta, duke mos vlerësuar nëse subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit apo jo, në referencë edhe të nenit 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016.

26.3 Në funksion të analizës së këtij shkaku, Kolegji pati në konsideratë disa rrethana faktike që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ. Nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit relator të trupit gjykues, me vendimin nr. {***}, datë 15.3.2017, ka gjykuar çështjen me palë ankuese, paditës shoqëria tregtare “{***}” ShPK, dhe palë e paditur Bashkia {***}, me objekt padie “Pavlefshmërinë absolute të urdhrin të kryetarit të Bashkisë {***} nr. {***}, datë 26.11.2009, “Urdhër zhdëmtimi”, për ndalimin e shumës 1.825.471 lekë si titull ekzekutiv, si dhe të akteve të mëpasshme të nxjerra për zbatimin e tij përkatësisht aktin nr. {***}, datë 09.01.2015, të Bashkisë {***}, me objekt “Njoftim për shlyerje detyrimi” drejtuar shoqërisë “{***}” Shpk”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 14.04.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së shoqërisë “{***}” ShPK, si të pabazuar në prova dhe në ligj. Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur në ankimin e shoqërisë “{***}” ShPK, me vendimin nr. {***}, datë 15.03.2017, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së paditësit “{***}” ShPK, duke e konstatuar si absolutisht të pavlefshëm urdhrin nr. {***}, datë 26.11.2009, si titull ekzekutiv të Kryetarit të Bashkisë {***} për ndalimin e shumës 1.825.471 lekë, dhe rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.

26.4 Gjithashtu rezulton se, me kontratën noteriale të shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.10.2015, administratori i kësaj shoqërie, z. Sh.K. ka blerë apartamentin në pronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit (zgj. M. K.), në shumën e 110.000 eurove.

26.5 Në drejtim të verifikimit të një situatë të mundshme të konfliktit të interesit për këtë rast, Komisioni ka kërkuar vlerësimin e ILDKPKI-së, si institucion përgjegjës i ngarkuar nga ligji për evidentimin e situatave të konfliktit të interesit sipas ligjit nr. 9376/2005, nëse kjo situatë duhej apo mund të konsiderohej si e tillë. Në përgjigje të kësaj kërkesë, ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***}, datë 11.02.2019, është përgjigjur se:

- Marrëdhënia kontraktuale e shitblerjes së apartamentit të bashkëshortes së subjektit dhe z. Sh.K., ortak i vetëm i “{***}” ShPK, është një marrëdhënie e cila, bazuar në përcaktimin e nenit 5, pika 1 e ligjit nr. 9376, datë 07.04.2005⁶⁰, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9376/2005”) klasifikohet si konflikt interesi i ardhur prej një marrëdhënieje juridiko-civile me të drejta dhe detyrime pasurore, marrëdhënie kjo e njohur mes palëve.
- Në këto kushte, ILDKPKI-ja, referuar përmbajtjes së pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 9376/2005, e cila përcakton se: *Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër (në këtë rast nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile), sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë*, si dhe duke konsideruar faktin se trupa gjyqësore, pjesë e së cilës ka qenë subjekti i rivlerësimit, ka dhënë një vendim në favor të Kompanisë “{***}” ShPK, ka vlerësuar se subjekti, duke mos hequr dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje gjyqësore dhe duke dhënë një vendim në favor të palës me të cilën ka një marrëdhënie juridiko-civile me karakter pasuror, ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit dhe të papajtueshmërisë së funksionit.
- Nga të dhënat e fashikullit konstatohet se, ashtu siç ka shprehur në ankim Komisioneri Publik, Komisioni nuk i ka kaluar subjektit barrën e provës lidhur me gjykimin prej tij të çështjes gjyqësore me palë ndërgjyqësore, ndër të tjerë, edhe shoqërinë “{***}” ShPK, në kushtet e konfliktit të interesit, pasi me këtë kompani dhe ortakun e vetëm të saj, siç është shprehur edhe në këtë vendim, rezulton se subjekti ka lidhur ndër vite 4 (katër) kontrata shitblerjesh pasurish të paluajtshme (*apartamenti i {***}, apartamenti te {***} Tiranë, shtesë apartamenti tek {***} dhe garazhi po me të njëjtën vendndodhje*).

26.6 Lidhur me pretendimet e Komisionerit Publik për gjykim në kushtet e konfliktit të interesit, subjekti i rivlerësimit në gjykimin në Kolegj ka prapësuar këto pretendime, duke u shprehur se, referuar fakteve të vërtetuara me aktet konkrete, shpjegimeve të bëra prej tij para Komisionit, faktit se në kohën e gjyimit nuk ekzistonte asnjë lloj marrëdhënieje juridike prej së cilës personi i lidhur të kishte të drejta apo detyrime apo çfarëdo lloj interesi tjetër, bazuar në përcaktimet ligjore përkatëse, ai nuk ka qenë në kushtet e nenit 72, pika 6 e K.Pr.Civile, pasi nuk ka pasur asnjë arsye, duke pretenduar se, referuar edhe praktikës së Kolegjit⁶¹, ky pretendim i Komisionerit Publik duhet të konsiderohet si i pabazuar në fakte dhe në ligj.

⁶⁰Në këtë nen përcaktohet se: “[...] Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale”.

⁶¹Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit referon në vendimin e Kolegjit nr. 16/2020 (JR), tek i cili, ndër të tjera, Kolegji ka shprehur se: “Kolegji konsideron se zgjidhja e çështjes e pretenduar nga subjekti duhet parë në raport me dispozitat e ligjit nr. 9367/2005, të cilat përcaktojnë institutin e interesit pasuror dhe gjendjen e konfliktit të interesit, si edhe kushtet dhe procedurat si një zyrtar duhet ta deklarojë dhe shmangë atë”.

26.7 Kolegji, në vlerësim të këtij shkaku ankimi, konstaton se, pavarësisht se subjekti nuk gjendet në situatat e parashikuara nga neni 72, në pikat nga 1 deri 5 të tij, mbetet për t'u vlerësuar zbatimi i pikës 6 të kësaj dispozite, e cila parashikon rastin se gjyqtari detyrohet të dorëhiqet në rast se ekzistojnë arsye serioze njëanshmërie.

Kolegji çmon se analiza e kësaj situatë do të duhej të bëhej mbi vlerësime të testit objektiv e subjektiv, duke qenë se situata në vetvete nuk përfaqëson një nga rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji. Në konsideratë të vlerësimit të testit objektiv, Kolegji vlerëson se natyra e marrëdhënies që personi i lidhur kishte pasur me ortakun e vetëm të shoqërisë “{***}” ShPK, e cila i kishte mundësuar shitjen e një prone me një çmim shumë të kënaqshëm, dukshëm më të lartë, referuar çmimit fillestar të blerjes së pronës (*pasuria ishte blerë për 61.758 euro dhe u shitte “{***}” për 110.000 mijë euro*) dhe fakti që pikërisht të ardhurat e realizuara nga kjo shitje ishin një nga burimet e financimit të pasurisë “apartament”, të blerë prej paditësit në vitin 2015, pra para zhvillimit të gjykimit të çështjes, duket se e vënë në diskutim nga syri i një vëzhguesi të jashtëm të zakonshëm, paanësinë e subjektit në gjykimin e një çështjeje në të cilën shoqëria ishte palë.

26.8 Në këtë kuptim, pavarësisht deklarimit të subjektit se ai kapërcente testin e kriterit subjektiv sepse nuk ndihej i njëanshëm në gjykimin e çështjes, Kolegji çmon se mjaftojnë rrethanat objektive për ta stimuluar te subjekti një reagim në drejtim të garantimit jo vetëm të paanësisë së tij, por edhe të parimit se drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe të duket se jepet, për më tepër kur marrëdhënia objektive që duket se e prek këtë paanësi, vjen për shkak të një transaksioni që ka siguruar fonde për krijimin e pasurisë së subjektit.

Në mbështetje të këtij arsyetimi vjen edhe fakti se shoqëria “{***}” ShPK ka rezultuar të jetë gjyqfituese nga procesi në të cilin ka marrë pjesë subjekti, me cilësinë e gjyqtarit relator, ndryshe nga sa kishte rezultuar në gjykimin në shkallë të parë, duke mos zhgënjyer në këtë mënyrë skepticizmin e vëzhguesit të jashtëm për paanësinë e subjektit të rivlerësimit në gjykimin e rastit. Po në të njëjtën linjë, konstatohet se është edhe qëndrimi që ka mbajtur ILDKPKI-ja, si organi i specializuar për evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit nga këndvështrimi i zbatimit të ligjit nr. 9376/2005, duke përforcuar qasjen e të gjitha organeve që kontrollojnë këtë kategori të sjelljes së subjekteve nga këndvështrime e qëllime të ndryshme, se subjekti duhej ta kishte trajtuar këtë rast me diligjencën e duhur, e cila, e ndërthurur edhe me testin subjektiv mund ta kishte çuar atë në një konkluzion të ndryshëm nga ai që ai ka mbajtur në proces.

26.9 Për pasojë, ndryshe nga qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, se faktet dhe rrethanat dëshmojnë garanci të paanshmërisë së subjektit dhe se vlerësimi i kësaj situatë varet tërësisht nga bindja e brendshme e gjyqtarit, Kolegji konkludon referuar edhe qëndrimeve të mbajtura nga jurisprudenca e GjEDNj-së⁶², për të vlerësuar paanshmërinë nuk mjafton vetëm verifikimi i testit subjektiv, por edhe atij objektiv, në të cilin në rastin konkret, mundej që subjekti të dështonte.

26.10 Nga ky qëndrim i Komisionit, konstatohet se vlerësimi e arsyetimi i tij për të konkluduar për paanshmëri të subjektit në gjykimin e çështjes me palë ndërgjyqëse “{***}” ShPK, lidhet së pari, me elemente që nuk analizojnë apo evidentojnë situatat lidhur me konfliktin e interesit, por e lidhin me kohën kur ka ndodhur marrëdhënia juridiko-civile e bashkëshortes së tij me palën ndërgjyqëse dhe me analizën se si ka qenë përfitimi pasuror në raport me tregun e shitjet e mëtejshme të kësaj prone. Ndërsa së dyti, ligji nr. 9376/2005, me qëllim shmangien e analizave

⁶²Shih vendimet e GjEDNj-së: *Driza kundër Shqipërisë, paragrafët 71-84; Morice kundër Francës (viti 2015) paragrafi 75; Micallef kundër Maltës.*

të tilla, ka evidentuar qartë rastet kur një situatë apo marrëdhënie konsiderohet për nëpunësin publik si një konflikt interesi duke parashikuar ndër to, ekzistencën e një marrëdhënieje juridiko-civile me karakter pasuror, siç është ajo e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme.

26.11 Në lidhje me situatën e pretenduar në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak të pjesëmarrjes së subjektit me cilësinë e relatorit të trupit gjykues në gjykimin e çështjes që i përket palës ankuese, paditësi, shoqëria “{***}” ShPK kundër {***} dhe {***}⁶³, konstatohet se me vendimin nr. {***}, datë 20.5.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, dhënë në favor të palës së tretë.

26.12 Për këtë çështje, Kolegji mori në shqyrtim, krahas pretendimeve të palëve, edhe rrethanat faktike që rezultojnë nga provat dhe bazën ligjore të aplikueshme.

Nga aktet e administruara, rezulton se më herët, subjekti i rivlerësimit, me kontratën noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 25.01.2010, ka blerë apartamentin në {***}, Lezhë për çmimin 2.000.000 lekë, nga shoqëria “{***}” ShPK, me ortak të vetëm shtetasin F. C. Më pas, në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja M. K., me anë të kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.12.2015, kanë blerë nga shtetasi F. C. dhe bashkëshortja e tij apartamentin në rr. “{***}”, Tiranë, për vlerën 177.370 euro. Ndërsa në vitin 2016, në të njëjtën adresë, nga ky shtetas kanë blerë apartamentin shtesë dhe garazh, për shumën totale 70.000 euro.

26.13 Kolegji analizoi në mënyrë të njëjtë edhe rrethanat e këtij rasti, si ato të rastit më lart, duke kontrolluar testin objektiv dhe atë subjektiv në drejtim të përcaktimit të paanësisë së subjektit në gjykimin e çështjes në të cilën ka qenë palë shoqëria “{***}” ShPK. Në vështrim të situatës faktike lidhur me këtë çështje, rezulton se marrëdhënia e subjektit me shoqërinë “{***}” ShPK dhe ortakun e tij të vetëm, z. F. C., referuar akteve të administruara dhe shpjegimeve të subjektit, duket se ka filluar që në vitin 2008, me prenotimin prej subjektit të një apartamenti në {***}, Lezhë, për të cilin në këtë vit ka paguar këstin e parë me vlerë 1.200.000 lekë, duke lidhur kontratën e shitblerjes më datë 25.01.2010, me vlerë totale 2.000.000 lekë. Më pas, nga ortaku i vetëm i shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, z. F. C., e bashkëshortja e tij, subjekti ka blerë në dhjetor 2015 apartament me vlerë 177.370 euro dhe në vitin 2016 ka blerë apartament 29 m² me vlerë 46.000 euro e garazh me vlerë 24.000 euro.

26.14 Nga këto akte të administruara, konstatohet se prej vitit 2008 e deri në vitin 2016, ndërmjet subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK kanë ekzistuar marrëdhënie me karakter pasuror, të finalizuara me akte juridiko-civile (kontrata shitblerjesh), në të cilat shoqëria “{***}” ShPK apo ortaku i vetëm i saj figurojnë në rolin e shitësit. Nga këto të dhëna, në ndryshim nga rasti i gjykimit të çështjes “{***}” ShPK, përveçse subjekti ka qenë vetë në rolin e palës kontraktore me shoqërinë “{***}” ShPK, para dhënies së vendimit objekt verifikimi, rezulton që edhe pasi ai ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 20.5.2014, ka rinisur sërish një marrëdhënie kontraktuale me ortakun e kësaj kompanie, z. F. C., prej të cilit rezulton se ka blerë pasuritë e deklaruar në deklaratën *vetting*.

26.15 Edhe në analizën e këtij rasti, Kolegji konstaton se, ndonëse nuk gjendemi para ndonjë prej rasteve të parashikuara nga neni 72, pikat nga 1 deri në 5 të Kodit të Procedurës Civile, aplikimi i pikës 6 të këtij neni meriton vëmendje e diskutim.

Në kuptim të vlerësimit të testit objektiv në raport me përcaktimin e paanësisë së gjyqtarit në gjykimin e çështjes, Kolegji vëren shtrirjen në kohë të marrëdhënies mes subjektit dhe ortakut të

⁶³Në këtë çështje, si person i tretë, bashkimi i operatorëve ekonomikë, shoqëria “{***}” ShPK, shoqëria “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe shoqëria “{***}” ShPK.

vetëm të shoqërisë “{***}” ShPK, në drejtim të realizimit të interesave pasurorë të përbashkët. Ky element analizohet edhe në raport me faktin se nga kontrata e shitblerjes së apartamentit në {***}, subjekti i rivlerësimit ka përfutuar dhe ka mundësuar një transaksion me leverdi ekonomike, për sa kohë që ka blerë prej shoqërisë “{***}” SHPK apartamentin me një çmim më të ulët se çmimi i referencës, sipas vlerave të përcaktuara me udhëzimin nr. 3, datë 03.02.2010, të Këshillit të Ministrave⁶⁴ dhe e ka shitur këtë pronë me dyfishin e çmimit të blerjes, përsëri me çmim më të lartë se ai i referencës.

I gjithë ky transaksion ka shërbyer më pas për krijimin e të ardhurave të përdorura prej subjektit në financimin e shtëpisë së blerë prej tij në kompleksin “{***}”, të ndodhur në {***}. Kjo marrëdhënie pasurore, e cila ka ekzistuar mes subjektit dhe shoqërisë para zhvillimit të gjykimit të çështjes, duhet ta kishte shtyrë subjektin, në këndvështrimin e një vëzhguesi të jashtëm, të kishte konsideruar mundësinë e dorëheqjes prej gjykimit të çështjes, edhe pse, sipas pretendimit të tij, në kushtet e paanësisë subjektive në raport me palët. Nën optikën e parimit se drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe të duket se jepet, kjo rrethanë meritonte në kohën e gjykimit një vlerësim më të kujdesshëm e të përgjegjshëm prej subjektit të rivlerësimit.

Nën dritën e rrethanave që kanë ndodhur më pas, përfshirja sërish e subjektit dhe e ortakut të shoqërisë në një marrëdhënie tjetër pasurore, të rëndësishme për financat e subjektit (për shkak të blerjes së shtëpisë së banimit të tij dhe familjes), duket se e përforcon arsyetimin e mësipërm dhe është një indicie e rëndësishme për të krijuar bindjen se marrëdhënia mes subjektit dhe ortakut të vetëm, z. F. C., nuk ishte e lokalizuar vetëm në transaksionin e vitit 2010, por ka vazhduar edhe më pas në kohë, duke e vënë edhe më shumë në dyshim paanësinë e subjektit në gjykimin e çështjes në të cilën palë ishte e njëjta shoqëri.

26.16 Për sa më sipër, edhe në lidhje me këtë rast, Kolegji ndan qëndrim të ndryshëm nga vlerësimi që ka bërë Komisioni, duke konkluduar se subjekti nuk ka treguar kujdesin e duhur për të vlerësuar me objektivitet, ashtu si edhe në rastin me shoqërinë “{***}” ShPK, mundësinë e dorëheqjes nga këto procese për të shmangur çdo dyshim për paanësinë e tij në gjykimin e tyre, sipas një vlerësimi të një vëzhguesi të jashtëm të zakonshëm. Në të dyja situatat e trajtuara më lart, Kolegji çmon se subjekti nuk ka treguar kujdesin e duhur në raport me vlerësimin e konfliktit të interesit dhe shmangies së tij nëpërmjet dorëheqjes nga këto çështje, duke marrë një vlerësim negativ të indikatorit të integritetit dhe paanësisë sipas përcaktimeve të nenit 75, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016, si edhe në papajtueshmëri me parimet e Bangalores për sjelljen e gjyqtarit⁶⁵.

26.17 Në ankim, Komisioneri Publik ka ngritur pretendime edhe në drejtim të konfliktit të interesit në dukje⁶⁶, të cilat i lidh me rastet e gjykuara prej subjektit të rivlerësimit, te të cilat

⁶⁴Udhëzimi nr.3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010” përcakton se çmimi mesatar i shitjes për metër katror, i sipërfaqes së shfrytëzuar në tregun e lirë për vitin 2010, në qytetin e Lezhës, është në vlerën 52.200 lekë/m² (sipërfaqja e apartamentit 48,27 metra x 52.200 lekë = 2.519.694 lekë).

⁶⁵Parimet e Bangalores përcaktojnë standarde të njohura ndërkombëtarisht për sjelljen gjyqësore, të miratuara nga Grupi Gjyqësor për Forcimin e Integritetit Gjyqësor (2002), te të cilat, lidhur me parimin e paanshmërisë së gjyqtarit, ndër të tjera, në pikën 2, paragrafi 2.5, përcaktohet se:

“2.5Gjyqtari duhet të përjashtojë veten nga pjesëmarrja në çdo procedurë në të cilën ai nuk është në gjendje ta gjykojë atë në mënyrë të paanshme ose në të cilën për një vëzhgues të arsyeshëm mund të duket se gjyqtari nuk është në gjendje të gjykojë e vendosë në mënyrë të paanshme. Procedura të tilla përfshijnë, por nuk kufizohen në, rastet e listuara në këtë dispozitë të parimeve të Bangalores”.

(Shih: https://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial_group/Bangalore_principles.pdf.)

⁶⁶Në ligjin nr. 9367/2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 4/b, përkufizohet:

palë ndërgjyqëse ka qenë administrata tatimore në të cilën bashkëshortja e tij në periudha të ndryshme ka ushtruar funksione të larta drejtuese, duke e adresuar konkretisht këtë pretendim të çështjet me palë ndërgjyqëse administratën tatimore dhe respektivisht “{***}”, shoqërinë “{***}” ShPK, shoqërinë “{***}” ShPK, “{***}”, shoqërinë “{***}” ShPK, shoqërinë “{***}” ShPK dhe shoqërinë “{***}” ShPK.

26.18 Në këtë drejtim, Komisioneri Publik, përgjatë gjykimit, ka pretenduar se nga një vlerësim në tërësi i çështjes, konstatohen rastet që subjekti nuk ka vepruar për të shmangur situata të konfliktit faktik të interesit apo atij në dukje, porë kjo edhe me rëndësinë që ka besimi dhe perceptimi i publikut në pavarësinë, etikën, integritetin dhe paanshmërinë që magjistrati duhet të kujdeset të reflektojë. Ky detyrim, përveç se gjen rregullim specifik në dispozitat përkatëse të kreut V të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjin nr. 9367/2005, për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, ka gjetur vend edhe në ligjin e posaçëm nr. 96/2016, për statusin e magjistratëve, nenet 3⁶⁷, 4⁶⁸ e në vijim të tij. Për sa më sipër, referuar edhe në kriteret e vlerësimit sipas nenit 75, pika 4⁶⁹ e ligjit nr. 96/2016, Komisioneri Publik ka shprehur se rezulton se jo në të gjitha rastet subjekti është kujdesur për shmangien e konfliktit të interesit faktik dhe atij në dukje. Raste në të cilat, në pamje të parë, më së paku do të paragjykonin paanshmërinë e vendimmarrjes, pasi në to ndërthuret gjykimi i subjektit gjatë procedurave gjyqësore, me vendimmarrjet apo ndikimet e mundshme, të drejtpërdrejta apo të tërthorta për shkak funksioni drejtues, të personit të lidhur me të, bashkëshortes. Një situatë e tillë eventualisht mund të minojë besimin që gjykatat duhet të frymëzojnë të shoqëria dhe publiku.

26.19 Lidhur me këtë konstatim dhe qëndrim të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit përgjatë gjykimit në Kolegj, ka shprehur se pretendimi i Komisionerit për mungesën e kujdesit apo vonësën në paraqitjen e kërkesës për heqje dorë, është i pabazuar, pasi nuk ka asnjë rast në të cilin të ketë munguar kujdesi në lidhje me këtë çështje. Subjekti ka shpjeguar se ka pasur një qasje të drejtë në lidhje me konfliktin e interesit, për sa referuar të dhënave konkrete, ka dhënë dorëheqje nga 201 raste kur janë vërtetuar rrethana që kanë pasur lidhje me detyrën e mbajtur nga bashkëshortja e tij në organet tatimore. Nga këto dorëheqje të parashtruara përpara Komisionit dhe që ndodhen në dosjen përkatëse, rezulton se janë 7 raste, për të cilat kryetari i Gjykatës së Lartë ka refuzuar kërkesën e paraqitur nga ana e subjektit, të cilat konfirmojnë jo vetëm faktin se prej tij është ushtruar detyra në përputhje të plotë me përcaktimet e ligjit, por rënë në konflikt interesi, por edhe u japin përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në lidhje me këtë çështje. Subjekti ka potencuar faktin që bashkëshortja ka qenë në një detyrë të caktuar në administratën tatimore, është mbajtur në konsideratë prej tij në lidhje me shmangien e konfliktit të interesit në dy shtylla kryesore, që gjejnë referencë në parashikimet e neneve 72 dhe 73 të K.Pr.Civile dhe në lidhje me ligjin nr. 9367/2005.

26.20 Për të shqyrtuar në mënyrë sa më të plotë pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me konfliktin në dukje të interesit, trupi gjykues i Kolegjit, me vendimin e ndërmjetëm të datës

“b) “konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë”.

⁶⁷“4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime. 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces”.

⁶⁸“2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit”.

⁶⁹“Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit [...].

01.04.2021, kërkoi prej gjykatave⁷⁰ pranë të cilave gjendeshin të administruar fashikujt gjyqësorë të këtyre çështjeve, kopje të akteve që gjenden në këto dosje gjyqësore. Kjo veprimtari hetimore synoi të evidentonte nëse në aktet e administruara në fashikujt gjyqësorë të këtyre çështjeve, gjendeshin akte të cilat ishin nënshkruar nga bashkëshortja e subjektit në cilësinë e personit të përfshirë në vendimmarrjen e akteve objekt ankimi apo edhe në cilësinë e titullarit në funksion të përfaqësimit të organit tatimor pranë gjykatës.

26.21 Nga shqyrtimi i akteve të paraqitura në përgjigje të vendimit të ndërmjetëm të marrë prej trupit gjykues, rezultoi se bashkëshortja e subjektit nuk kishte pasur ndonjë rol vendimmarrës dhe as kishte nënshkruar ndonjë akt përfaqësimi për llogari të administratës tatimore në çështjet në të cilat institucioni ishte palë dhe që u përkisnin palëve paditëse: “{***}”; shoqëria “{***}” ShPK; shoqëria “{***}” ShPK; “{***}” ShPK⁷¹ dhe shoqëria “{***}”. Për këto raste të verifikuara nëpërmjet hetimit gjyqësor, nuk rezultoi asnjë e dhënë që të vinte subjektin si anëtar i trupës gjyqësore që kishte gjykuar çështjet, në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, për shkak të përfshirjes së bashkëshortes së tij në procedurat tatimore të kontestuara gjyqësisht.

26.22 Në lidhje me çështjet që i përkisnin konfliktit me administratën tatimore, në të cilën bashkëshortja e subjektit kishte ushtruar funksionet e saj drejtuese dhe shoqërive “{***}” ShA dhe “{***}” ShA, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte dhënë dorëheqjen nga gjykimi i tyre, pas kalimit të një kohe prej 8 muajsh nga shortimi i çështjes që i përket “{***}” dhe prej 7 muajsh nga shortimi për çështjen që i përkiste shoqërisë “{***}” ShA.

26.23 Subjekti ka shpjeguar përgjatë procesit se dorëheqjet me vonesë i atribuohen momentit të ardhjes në dijeni për palët ndërgjyqëse apo përgatitjes së çështjes, përfshi këtu edhe ngarkesën e madhe të punës në gjykatë, që e ka penguar atë të bëjë një vlerësim më të shpejtë të situatave.

26.24 Kolegji, duke analizuar situatën e përshkruar më lart, vlerëson se sjellja e subjektit nuk përmbush në nivelin e duhur diligjencën që nevojitet për ushtrimin e funksionit të tij si gjyqtar e figurë drejtuese në institucion. Pretendimi i subjektit se ai vinte në dijeni të palëve vetëm pasi çështja përgatitej për gjykim, duket një arsye jo e qenësishme, për sa kohë që subjekti, duke qenë në rol drejtues në gjykatë, kishte detyrimin të organizonte e monitoronte hedhjen e shortit dhe të ndiqte këtë proces së bashku me kancelarin e gjykatës, në zbatim të vendimit nr. {***} datë 24.12.2008, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë⁷² dhe urdhrin nr. {***}⁷³ të kryetarit të Gjykatës, datë 16.01.2015, “Për organizimin e shortit nëpërmjet sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve ICMIC”.

26.25 Në këto kushte, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të tregonte një vëmendje të shtuar në drejtim të trajtimit me koherencë të të gjitha situatave tij të mundshme të

⁷⁰Përkatësisht pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e asaj Durrës.

⁷¹Komisioneri Publik, në parashtrimet e datës 28.04.2021, për këtë çështje u shpreh se në praktikën e përcjellë nga Gjykata e Lartë për këtë çështje, nuk gjendeshin kopje të vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për shoqërinë “{***}” ShPK. Për verifikimin e këtij kërkimi të Komisionerit Publik, Kolegji kërkoi nga administrata tatimore paraqitjen e vendimit nr. {***} prot., datë 17.08.2012, të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, që i përket subjektit “{***}” ShPK, me NIPT {***}.

⁷²“Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore” në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në nenin 2 “Specifikat e hedhjes së shortit”, pika 3, përcaktohet se: “Çështjet gjyqësore duhet të hidhen në short, jo më vonë se shtatë ditë nga data e paraqitjes në gjykatë. Kryetari i gjykatës, mbi bazën e këtij afati dhe ngarkesës së punës, cakton periodicitetin e hedhjes së shortit në gjykatën që ai drejton”.

⁷³Shih në faqen zyrtare në internet të Gjykatës Administrative të Apelit, seksioni urdhra të brendshëm: <http://gjykataadministrativeapelit.al/wp-content/uploads/2014/07/Urdher-per-aktim-shorti.pdf>.

konfliktit të interesit, edhe atij në dukje për shkak të funksioneve drejtuese të bashkëshortes në administratën tatimore, jo vetëm në drejtim të garantimit të paanësisë së trupave gjykues që do të gjykonin çështjet e kësaj natyre, por edhe të garantimit të perceptimit të publikut se drejtësia jo vetëm po jepej, por edhe të dukej se po jepej. Rrethana e përmendur prej subjektit se ai ka qenë i detyruar të dorëhiqet për rreth 201 çështje, në të cilat bashkëshortja e tij ka qenë pjesë e vendimmarrjes së organeve tatimore të konstatuara në gjykatën që drejtohej nga subjekti, rrit ndjeshmërinë e publikut rreth vijueshmërisë së trajtimit të këtyre konflikteve dhe për të shmangur një perceptim defektoz të mënyrës se si drejtësia është realizuar në këto procese, subjekti duhej të përgjigjej me të njëjtin kujdes e ndjenjë përgjegjësie.

26.26 Në përfundim, Kolegji vëren se edhe këto dy raste të evidentuara më lart, pasqyrojnë mungesën e kujdesit të prishëm për trajtimin e rasteve të konfliktit për shkak të funksioneve të bashkëshortes dhe afektimin negativisht të indikatorit të integritetit e paanësisë të vlerësimit të aftësive profesionale të parashikuar nga neni 74, pikat 4 e 5 të ligjit nr. 96/2016.

26.27 Kolegji analizozi në këtë proces, për llogari të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me denoncimet e depozituara ndaj subjektit përgjatë hetimit administrativ, si edhe denoncimet e depozituara pas dhënies së vendimit të Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit, për të cilat vlerësoi se kishin informacione të vlefshme për hetime, në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

- 27.** Në drejtim të denoncimeve të administruara përgjatë hetimit administrativ, Komisioneri Publik ka pretenduar se nga analiza e këtyre denoncimeve, konstatojmë se jo të gjitha kanë gjetur trajtim të plotë nga ana e Komisionit apo edhe kur janë trajtuar, përgjigjet e subjektit nuk janë shteruese për të gjitha çështjet e ngritura. Nga vlerësimi i përmbajtjes së denoncimeve, pretendohen fakte dhe rrethana të cilat mund të marrin rëndësi në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, apo vlerësimin tërësor të çështjes, duke u shprehur në mënyrë më të detajuar se:

27.1 Në lidhje me denoncimin e paraqitur prej shtetases D. Sh., Komisioneri Publik ka pretenduar se duket që subjekti, në cilësinë e relatorit të trupit gjykues që ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 23.10.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk ka përmbushur kërkesat e dispozitave e Kodit të Procedurës Civile dhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese mbi të drejtën e paditësit për të disponuar mbi objektin e padisë "[...] për ta ndryshuar, zgjeruar ose zvogëluar atë sipas interesave të tij/saj" (vendimi nr. 16/2013 i Gjykatës Kushtetuese).

27.2 Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë qëndrim duke arsyetuar se vendimi i Gjykatës së Apelit, i cili ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka qenë i drejtë për sa ka konkluduar se paditësja/denoncuesja ka përcaktuar objektin e padisë për kundërshtimin e VKM-së, objekt gjykimi përtej afatit 30-ditor të parashikuar nga ligji, për pasojë kjo padi ka qenë e parashkruar.

27.3 Nga analizimi i rrethanave të faktit që evidentohen nga aktet e administruara edhe përgjatë gjykimit, Kolegji konstaton se denoncuesja D. Sh. ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë padinë me objekt detyrimin për pagimin e dëmshpërblimit për truallin e shpronësuar me VKM-të nr.129, datë 12.02.2012 dhe nr. 408, datë 08.06.2012 për një diferencë vlere në krahasim me atë që kishin përcaktuar këto dy vendime. Pas një kohe që çështja ishte e varur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, paditësja ka ndrequr ndërgjyqësinë dhe ka saktësuar/ndryshuar objektin e padisë duke kërkuar anulimin pjesërisht të vendimeve të Këshillit të Ministrave që kishin bërë shpronësimin e truallit në pronësi të saj, duke pretenduar dëmshpërblim në vlerën fillestare të padisë. Ky veprim procedural rezulton të jetë bërë tej afatit procedural prej 30 ditësh, brenda të cilit palët kishin të drejtë të kundërshtonin gjyqësisht akte të

tilla administrative. Ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Administrative e ka rrëzuar padinë, për shkak se ka arsyetuar se pretendimi i paditëses për aplikim të tarifave të ndryshme për dëmshpërblim nuk ishte i mbështetur në ligj, Gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi këtë vendim me një arsyetim të ndryshëm, duke konsideruar se rrëzimi i padisë duhej të ishte vendosur për shkak të parashkrimit të padisë.

27.4 Kolegji e vlerësoi këtë qëndrim të mbajtur nga subjekti në gjykimin e kësaj çështjeje si një interpretim të gabuar të dispozitave ligjore që rregullojnë të drejtën e paditësit për disponimin e padisë dhe të kërtimeve të tjera që lidhen me të. Sipas përmbajtjes së akteve të analizuara, konstatohet se kërkitimi i paditëses D. Sh. që në krye të herës ka qenë i lidhur me pretendimin se Vendimet e Këshillit të Ministrave që kishin vendosur shpronësimin e pronës së saj nuk kishin disponuar drejt për sa i përket masës së dëmshpërblimit, duke pretenduar me anë të padisë gjyqësore, pikërisht vendosjen e kësaj të drejte sipas pretendimit të paditëses.

Gjatë gjykimit të çështjes, paditësja ka ndrequr ndërgjyqësinë dhe ka saktësuar objektin e padisë, duke formalizuar e veshur ligjërisht kërkimin e saj, pa ndryshuar shkakun ligjor të padisë. Situata, në vlerësimin e Kolegjit, është tipikisht ajo e parashikuar nga neni 185 i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *Paditësi gjatë hetimit gjyqësor ka të drejtë të ndryshojë shkakun ligjor të padisë. Ai, pa e ndryshuar shkakun ligjor të saj, mund të shtojë, të pakësojë ose të ndryshojë objektin e padisë.*

Kolegji çmon se ky kërkim është pjesë integrale e së njëjtës padi të paraqitur e regjistruar në gjykatë brenda afateve të përcaktuara me ligj dhe se ndryshimet e ndodhura përgjatë gjykimit brenda kontekstit të së njëjtës padi, nuk mund të konsiderohen si padi e re e cila duhet t'u nënshtrohet rregullave procedurale të një padie tjetër, por si pjesë e të njëjtit objekt të mosmarrëveshjes, në kuptim të nenit 5 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *Objekti i mosmarrëveshjes përcaktohet në pretendimet e palëve. Pretendimet parashtrihen në aktin për fillimin e procesit gjyqësor, si dhe gjatë ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga ky proces. Objekti i mosmarrëveshjes mund të ndryshojë sipas kërkesave që lindin gjatë procesit, kur këto të fundit kanë lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit.*

27.5 Për sa më sipër, Kolegji e gjen të gabuar shkakun ligjor të përdorur nga subjekti i rivlerësimit në vendimin e analizuar më lart, duke demonstruar në këtë mënyrë defekte në aspektin e njohurive të ligjit, në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

27.6 Lidhur me denoncimin e paraqitur prej shtetasit T. B. e që i adresohet vendimit nr. {***}, datë 6.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në të cilin subjekti ka qenë me cilësinë e relatorit të trupit gjykues, Komisioneri Publik ka pretenduar se mbetet e paqartë nëse subjekti ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ngritura nga paditësi në gjykim dhe nëse ai veprimi në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Subjekti, përgjatë gjykimit në Kolegj, ka prapësuar me shpjegimet se kërkimet e paditësit T. B. në çështjen objekt shqyrtimi, mbështeteshin në një bazë ligjore të shpallur antikushtetuese nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 12/2000⁷⁴ dhe, si të tilla, nuk kishin shkak ligjor, bazuar në legjisllacionin në fuqi, prandaj dhe duheshin rrëzuar.

27.7 Nga analiza e rrethanave të faktit lidhur me këtë çështje, ka rezultuar se denoncuesi, me cilësinë e paditësit, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë për të kërkuar dëmshpërblim për banesën e blerë dhe poseduar prej tij prej vitesh, e cila i është kaluar

⁷⁴Me anë të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, është shpallur antikushtetuese fraza e nenit 10 të ligjit nr. 7698/1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", i cili parashikonte se: "[...] ndërsa personave të tretë shteti u kthen masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit, e konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve".

në pronësi dhe posedim ish-pronarit për shkak të zbatimit të ligjit nr. 7698/1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Paditësi ka pretenduar një dëmshpërblim të drejtë e real të pronës së kthyer ish-pronarit dhe, me vendimin nr. {***}, datë 22.09.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Korçë, është pranuar padia duke iu njohur kjo e drejtë. Gjykata e Apelit Administrativ me vendimin nr. {***}, datë 10.12.2015, në trupin gjykues të të cilit subjekti ka qenë me cilësinë e relatorit, ka ndryshuar vendimin, duke rrëzuar padinë e paditësit. Arsyetimi i përdorur nga gjykata për marrjen e këtij vendimi, mbështetej mbi faktin se neni 10 i ligjit nr. 7698/1993, i cili ishte edhe baza ligjore që mbështet pretendimin e paditësit, në pjesën e dytë të tij ishte shfuqizuar me vendimin nr. 12/2000 të Gjykatës Kushtetuese, për pasojë pretendimi i paditësit mbetet pa mbështetje ligjore.

27.8 Kolegji, duke analizuar situatën e mësipërme, çmon se arsyetimi i përdorur prej subjektit për zgjidhjen e çështjes, është në interpretim të gabuar të legjislacionit e fuqisë detyruese të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Nga arsyetimi i vendimit nr. 12/2000 të Gjykatës Kushtetuese, konstatohet se gjykata ka konkluduar për shfuqizimin si antikushtetuese të frazës së dytë të nenit 10 të ligjit nr. 7698/1993 që parashikonte se: *[...]Ndërsa personave të tretë shteti u kthen masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit, e konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, pikërisht duke arsyetuar se kjo mënyrë shpërblimi nuk përfaqësonte një shpërblim të drejtë për zhveshjen e tyre nga të drejtat mbi banesat e ish-pronarëve. Në frymën e parimeve kushtetuese dhe atyre të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata Kushtetuese rezulton të ketë shfuqizuar këtë normë, duke orientuar nën këtë frymë organin legjislativ për rregullimet e plotësimet e nevojshme të legjislacionit*⁷⁵.

Subjekti, duke arsyetuar se shfuqizimi i dispozitës e linte pa bazë ligjore pretendimin e paditësit, për pasojë ai duhej rrëzuar, ka anashkaluar detyrimin ligjor që buron prej nenit 1, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënë ose është i paqartë.*

27.9 Përveç sa më sipër, konstatohet se arsyetimi i përdorur dhe konkluzioni i gjykatës bien ndesh me vetë frymën dhe arsyetimin që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj dhe vetë qëllimin që ky vendim synon të arrijë, garantimin e të shpërblimi të drejtë të personave të tretë, banesat e të cilëve janë trajtuar nga ligji nr.7698/1993. Kolegji çmon se aftësia dhe detyra e një gjyqtari është të zbatojë ligjin dhe ta interpretojë atë krahas jurisprudencës së detyrueshme, nën frymën e qëllimit të tij, jo në mënyrë të fragmentarizuar e jashtë kontekstit për të cilin ai është miratuar. Neni 132 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (para ndryshimeve), i cili parashikon se: *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare, duhet zbatuar edhe në konsideratë të arsyetimit të jurisprudencës që ato vendime krijojnë.*

27.10 Në këto kushte, Kolegji vlerëson se analiza ligjore e përdorur në vendimin e marrë prej subjektit, demonstroi dobësi të tij në drejtëm të aspektit të njohurive mbi ligjin dhe të aftësive për të interpretuar jurisprudencën, në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

⁷⁵Në vendimin nr. 12/2000 të Gjykatës Kushtetuese, në pjesën e konkluzioneve të tij, shprehet se: “Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e shoqatës “Barazi para Ligjit” duhet pranuar pjesërisht, duke shfuqizuar atë pjesë të nenit 10, paragrafi i I-rë i ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, që ka të bëjë me masën e shpërblimit për ndërtesat ish-pronë private që janë tjetërsuar nga persona të tretë. Duke bërë këtë shfuqizim, i takon organit që ka iniciativën ligjvënëse dhe organit ligjvënës, që në përputhje me përmbajtjen e këtij vendimi, të bëjnë plotësimet përkatëse të dispozitës së nenit 10, paragrafi i I-rë i ligjit të sipërcituar”.

27.11 Lidhur me denoncimin e paraqitur prej {***}, i cili u adresohet vendimeve të Gjykatës së Apelit Administrativ me nr. vendimi nr. {***}, datë 02.03.2016; vendimit nr. {***}, datë 26.10.2016 dhe nr. {***}, datë 24.5.2017, Komisioneri Publik ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka mbajtur të njëjtin standard të interpretimit ligjor, analizimit të jurisprudencës, argumentimit logjik dhe zgjidhjes së drejtë të rasteve të njëjta, parë kjo dhe në raport të kujdesit dhe cenimit ose jo të të drejtave të palëve procedurale. Gjithashtu është pretenduar se subjekti në zgjidhjen e këtyre çështjeve nuk ka mbajtur parasysht parashikimet e neneve 456 e 459 të Kodit të Procedurës Civile, që kanë çuar në rëndimin e pozitës së palës ndërgjyqëse.

27.12 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të këtij pretendimi, ka shpjeguar se në rastet konkrete të referuara në denoncim nga {***}, kërkimet e palëve kanë qenë të ndryshme, për pasojë edhe zgjidhjet e çështjeve. Në rastin e padisë së shtetasit K. K., është kërkuar "Pagimi i dëmshpërblimeve dhe shpërblimeve të tjera që rrjedhin nga kontrata e punës (në përfundim të kontratës me afat të caktuar)" dhe nuk rezulton të ketë kërkuar dëmshpërblimet nga zgjidhja e menjëhershme dhe e pajustificuar e kontratës së punës. Ndërsa në rastin e padisë së shtetasit N. N., është kërkuar: *Detyrimin e të paditurit të më dëmshpërblejë për zgjidhjen e menjëhershme, të pajustificuar të kontratës së punës.* Në nenin 151 të Kodit të Punës përcaktohet se, kur ndërmjet palëve kanë qenë lidhur disa kontrata të njëpasnjëshme me afat të caktuar, për jo me pak se tre vjet, mospërsëritja e kontratës së fundit nga punëdhënësi vlerësohet si zgjidhje e kontratës me afat të pacaktuar. Sipas subjektit, për shkak objektit të ndryshëm të kërimit, si dhe përcaktimeve të nenit 151/1 të Kodit të Punës, zgjidhja ka qenë e ndryshme dhe, për pasojë, rezulton e qartë se pretendimi i Komisionerit është i pabazuar.

27.13 Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, të lidhura me denoncimin e entit shtetëror "{***}" {***}, Vlorë, Kolegji duke shqyrtuar të dhënat që rezultuan nga aktet e administruara edhe gjatë hetimit gjyqësor, konstatoi se shtetasit K. K., N. N. e M. K. kanë qenë në marrëdhënie punësimi pranë denoncuesit për periudha të gjata kohe, në pozicione të ndryshme pune. Punëdhënësi, pasi ka zgjidhur kontratat pa afat të punës për një kategori punonjësish, përfshi edhe tre shtetasit e lartpërmendur, ka lidhur me këta të fundit kontrata pune me afat 3- (tre) mujor. Pas përfundimit të këtij afati, punëdhënësi rezulton të ketë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këta shtetas. Të tre personat e lartpërmendur i janë drejtuar gjykatës duke kërkuar të dëmshpërblehen për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, sipas përcaktimeve të dispozitave të Kodit të Punës. Nga leximi i akteve të administruara nga Kolegji gjatë gjykimit, ndryshe nga sa pretendon subjekti, rezulton se kërkimet e të tre shtetasve janë të mbështetura në të njëjtin shkak ligjor, atë të konsiderimit të kontratës me afat 3- (tre) mujor si një kontratë pa afat të përcaktuar, duke qenë se plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 151 i Kodit të Punës e, për pasojë, përfitimin e të gjitha dëmshpërblimeve që rrjedhin nga kjo paligjshmëri.

27.14 Pavarësisht kësaj rrethane të verifikuar në gjykim, trupat gjykues të Gjykatës së Apelit Administrativ, në të cilët subjekti ka qenë, në dy raste me cilësinë e relatorit dhe në një me cilësinë e anëtarit, kanë arsyetuar në mënyra të ndryshme për zgjidhjen e çështjes. Ndërsa në rastin e paditësit K. K., subjekti ka arsyetuar se nuk gjendemi para zbatimit të nenit 151 të Kodit të Punës, në rastin e paditësve N. N. dhe M. K., subjekti ka arsyetuar se gjendemi para situatës së parashikuar nga neni 151 i Kodit të Punës. Në varësi të këtij arsytimi, vendimet kanë disponime të ndryshme për sa u përket të drejtave të punëmarrësve nga zgjidhja e kontratës së punës, ndërsa paditësi K. K. është dëmshpërblyer vetëm me dy muaj e pesëmbëdhjetë ditë pagë dhe 45.000 lekë për shpenzimet për ushqim, dy paditësit e tjerë janë dëmshpërblyer me përkatësisht 13,5 muaj pagë për N. N. dhe 32 muaj pagë për M. K. Kolegji, duke konsideruar

jashtë juridiksionit të tij mbajtjen e një qëndrimi për zgjidhjen e çështjeve dhe analizën ligjore, mbështetur në bindjen e brendshme, vlerëson të evidentojë për efekt të këtij procesi, qëndrimet e ndryshme të subjektit të rivlerësimit për çështje të njëjta të ligjit dhe, për më tepër, për të njëjtat palë, duke ekspozuar dukshëm perceptimin negativ për dhënien e drejtësisë në këto raste.

27.15 Përveç sa më sipër, Kolegji analizoi në mënyrë të veçantë çështjen gjyqësore që i përkiste paditësit N. N., në drejtim të verifikimit të dispozitave procedurale që lidhen me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel. Padia e këtij shtetasi është gjykuar me vendimin nr. {***}, datë 28.05.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila ka vendosur të dëmshpërblejë paditësin vetëm me tre muaj pagë. Ndaj këtij vendimi, nuk rezulton të ketë ushtruar ankim pala paditëse, por vetëm pala e paditur, {***}, {***}, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë. Pavarësisht kësaj situatë, trupi gjykues në të cilin subjekti ishte me cilësinë e relatorit të çështjes, ka trajtuar e marrë në shqyrtim, pa pasur një kërkim të paditësit, të gjitha kërkimet e paraqitura prej paditësit në padinë e tij, të cilat ishin rrëzuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, duke marrë një vendim në favor të palës paditëse. Kolegji vlerëson se vendimi i marrë nga trupa gjykuese me subjektin relator të saj, është marrë në tejkalim të tagrave e kompetencave që ka një gjykatë që shqyrton çështjen në shkallë të dytë. Kjo vendimmarrje vjen në kundërshtim qoftë me parimin e parashikuar nga neni 6 i Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen duhet të përgjigjet për gjithçka që i kërkohet dhe vetëm për atë që i kërkohet, por edhe me një sërë dispozitash që përcaktojnë kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel, si nenet 454, 459, 460 e 463 të Kodit të Procedurës Civile. Garantimi i parimit të sigurisë juridike, nuk e lejon një gjykatë të dalë jashtë kufijve të juridiksionit të saj, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e palës kundërshtare, e cila mbetet e pambrojtur nga kërkime për të cilat nuk vihet në dijeni, dhe duke cenuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Në të njëjtën linjë është edhe praktika unifikuese e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 3/2009⁷⁶. Pretendimi i subjektit se kjo situatë ka qenë edhe për shkak të ngarkesës së madhe, nuk konsiderohet se e zhvesh atë nga përgjegjësia për zbatimin korrekt të ligjit e garantimin e të drejtave të palëve në proces, por evidenton një element që duket se afekton kriterin e aftësive organizative të subjektit në kuptim të procesit të rivlerësimit.

27.16 Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se me shkeljet e konstatuara edhe në lidhje me trajtimin e këtyre rasteve, subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2, dhe mangësi në drejtim të aftësive organizative, sipas përcaktimeve të nenit 73, pikat 1, 2 e 3 të ligjit nr. 96/2016.

27.17 Në lidhje me denoncimin e paraqitur nga një grup gjyqtarësh, Komisioneri Publik ka pretenduar se ka pasur mangësi në hetimin nga Komisioni të të gjitha çështjeve të përmendura në të, të cilat duhet të konsiderohen prej Kolegjit. Gjithashtu, Komisioneri ka pretenduar se qëndrimi i mbajtur prej Komisionit në lidhje me vendimin nr. {***}, datë 06.02.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, që i përket konfliktit gjyqësor të shtetasit B. V. me {***} e {***}, duket se nuk ka vlerësuar paraprakisht, duke arsyetuar në mënyrë shteruese nëse mangësitë profesionale të konstatuara duhen veçuar dhe t'i shkojnë organit kompetent inspektues apo ato i shërbejnë dhe marrin rëndësi për vlerësimin në tërësi të çështjes për qëllim

⁷⁶[...] Fryma që karakterizon Kodin e Procedurës Civile është përcaktimi si rregull i një roli kryesisht pasiv për gjykatën (me përjashtime të mirëpërcaktuara kryesisht sa i përket fazës së hetimit gjyqësor). Konform nenit 6 të K.Pr.Civile, gjykata kur gjykon mosmarrëveshjet e ndryshme, duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet [...]. Parimi i përputhjes midis asaj që kërkohet dhe asaj për të cilën shprehet gjykata, është parim bazë i së drejtës procedurale civile, pasi nuk mund të ketë ultra petita partium”.

të procesit të rivlerësimit, që së bashku me problematikat dhe mangësitë e tjera, mund të sjellin një rezultat të ndryshëm për subjektin e rivlerësimit.

27.18 Në gjykimin në Kolegj, subjekti i rivlerësimit lidhur me pretendimet e Komisionerit Publik në drejtim të denoncimit të një grupi gjyqtarësh të administruar prej Komisionit, ka kundërshtuar faktet e pasqyruara në të, duke deklaruar se ato janë të pavërteta, si edhe ka shpjeguar nën optikën e tij drejtësinë e vendimit të marrë për rastin në fjalë dhe mosdakordësinë me qëndrimin e Komisionit në raport me këtë çështje.

27.19 Kolegji verifikoi nëpërmjet hetimit gjyqësor të gjitha çështjet e ngritura në denoncimin e një grupi gjyqtarësh për të cilat Komisioneri kishte pretenduar hetime të paplota nga Komisioni. Nga këto hetime të zhvilluara dhe të dhënave që u përfutuan prej akteve të administruara nga veprimtaria hetimore e Kolegjit, rezultuan konkluzionet e mëposhtme.

27.20 Së pari, pretendimi i ngritur në denoncim se subjekti kishte gjykuar të gjitha ose pjesën dërrmuese të çështjeve që u përkisnin shoqërive “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK duke shpërdoruar funksionet drejtuese e manipulimin e shortit për këtë qëllim, rezultoi i paprovuar. Nga shkresa nr. {***}, datë 12.04.2021, e përcjellë prej Gjykatës Administrative të Apelit në përgjigje të kërkesës së trupit gjykues, rezultoi se pjesëmarrja e subjektit në çështjet gjyqësore që u përkasin shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK është në një nivel të moderuar që nuk krijon dyshime për manipulim të shortit, në mungesë të të dhënave apo provave që do të tregonin të kundërtën, ndërsa ka rezultuar se shoqëria “{***}” nuk ka pasur çështje të regjistruara në gjykatë për periudhën e kërkuar për verifikim.

27.21 Për sa i përket çështjes që lidhet me gjykimin e konfliktit mes familjes P. dhe {***} e {***}, zgjidhur me vendimin nr. {***}, datë 13.11.2017, të Gjykatës së Apelit Administrativ, në trupin gjykues të të cilit subjekti ishte me cilësinë e relatorit, pasi verifikoi natyrën e mosmarrëveshjes dhe problematikën e prezantuar në denoncim, konstatoi se pretendimet e denoncuesve për shkelje të ligjit i adresoheshin themelit të çështjes dhe meritojnë trajtimin e vlerësimit të një gjykate më të lartë, për sa kohë që vendimi i kontestuar është pasojë e interpretimit të ligjit e vlerësimit të fakteve që kanë rezultuar nga gjykimi, formimit të bindjes së brendshme të trupit gjykues. Në këto kushte, Kolegji vlerësoi se analizimi i këtyre pretendimeve do të dilte jashtë juridiksionit kontrollues të Kolegjit, në kuptim të nenit 72, pika 4 e ligjit nr.96/2016, për pasojë konkludoi të mos trajtojë në këtë vendim analizën e këtyre pretendimeve.

27.22 Për sa i përket çështjes që i përket z.B. V., për të cilën Komisioni ka konkluduar në evidentimin e një sërë shkeljeve të natyrës procedurale e dërgimin e kësaj çështjeje për shqyrtim nga organet kompetente sipas parashikimit të nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2014, Kolegji ndan në terma të përgjithshëm të njëjtin qëndrim me konkluzionet e Komisionit në lidhje me këtë çështje dhe, për pasojë, gjen me vend pretendimin e Komisionerit Publik, që në panoramën e përgjithshme të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, këto shkelje duhen konsideruar e vlerësuar për të mundësuar përcaktimin e nivelit të këtij kriteri për subjektin e rivlerësimit, në funksion të procesit të rivlerësimit.

28. Pranë Kolegjit, pas dhënies së vendimit nr. 161, datë 18.06.2019, të Komisionit, me anë të të cilit u konfirmua në detyrë subjekti i rivlerësimit Kastriot Selita, janë administruar disa denoncime⁷⁷, të cilat kanë të bëjnë si me çështje të trajtuara në vendimin e Komisionit, por edhe

⁷⁷Denoncimet e administruara në Kolegj janë me të dhënat si në vijim:

1. nr. {***} prot., datë 20.05.2019, denoncuese D. Sh.;

2. nr. {***} prot., datë 19.06.2019, denoncues S. H.;

me çështje të reja të patrajtuara prej tij. Pasi të gjitha denoncimet iu njoftuan subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik dhe pasi subjekti parashtrori qëndrimet e tij rreth fakteve të përmendura në to, Kolegji vlerësoi se denoncimet e paraqitura prej shtetasve K. D. dhe I. S., si dhe nga shoqata {***} plotësonin kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe ia nënshtroi analizës së tij faktet e përmendura në to, në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit.

28.1 Lidhur me denoncimin e z. K. D., Komisioneri Publik ka pretenduar se, në referencë të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, duket se subjekti i rivlerësimit paraqet mangësi në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, posaçërisht lidhur me fuqinë detyruese për zbatim të vendimeve të gjykatave më të larta, respektimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, nenit 64 të tij, si dhe respektimin e parimeve të pranuarra të së drejtës, siç është parimi i gjësë së gjykuar, *res-judicata*, duke passjellë zvarritje të panevojshme të procesit gjyqësor, në cenim të interesave të palëve ndërgjyqëse.

Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë denoncim, ka parashtruar seka rezultuar se, duke qenë se në kohën e gjykimit kishin filluar efektet juridike të ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe pala e paditur {***} e kishte përmbushur detyrimin ligjor dhe kishte bërë vlerësimin e pronës së familjes D., pra kishte ekzekutuar atë çfarë pala kërkonte në gjykatë, si dhe në kushtet kur pala paditëse kërkoi pushimin e gjykimit të çështjes lidhur me vlerësimin financiar të vlerësimit të kësaj prone, gjykata konstatoi se pala paditëse nuk kishte më objekt gjykimi dhe vendosi pushimin e çështjes. Në këto kushte, Komisioni i ka gjetur të paarsyeshme pretendimet e ngritura në denoncim.

28.2 Kolegji analizoi faktet e paraqitura në denoncim nga pikëpamja e zbatimit të urdhërimeve të Gjykatës së Lartë dhe pa analizuar zgjidhjen e çështjes. Nga aktet bashkëlidhur denoncimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, ka marrë vendimin “Mbi ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës para Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë”, me nr. {***} regjistri themeltar, datë 15.2.2017, megjithëse ndërkohë, sikurse pranon dhe subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij të datës 17.03.2021, mbi bazën e ankimit të palës së paditur, Gjykata e Lartë, me vendimin e saj me nr. {***}, datë 12.12.2016, kishte vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 05.10.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila kishte vendosur shpalljen e moskompetencës për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Më pas, Gjykata e Lartë, tashmë Kolegji Administrativ, me vendimin nr. {***}, datë 30.01.2018, në zgjidhjen e çështjes së kompetencës lëndore midis Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ngritur nga kjo e fundit, ndër të tjera, ka vlerësuar se: *[...] për sa kohë kemi një vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. {***}, datë 12.12.2016, i cili ka zgjidhur në themel konfliktin e kompetencës lëndore, atëherë jemi përpara gjësë së gjykuar. Në këto kushte, çështja objekt gjykimi, për këtë shkak ligjor dhe për këtë objekt nuk duhet të ishte ngritur përsëri, pasi jemi përpara rastit që çështja është shqyrtuar njëherë*

3. nr. {***} prot., datë 19.09.2019, denoncues K. D.;

4. nr. {***} prot., datë 15.10.2019, denoncues K. B.;

5. nr. {***} prot., datë 17.10.2019 (përcjellë nga KPK), denoncues K. B.;

6. nr. {***} prot., datë 24.10.2019, denoncues {***};

7. nr. {***} prot., datë 27.11.2019 (përcjellë nga KPK), denoncues {***};

8. nr. {***} prot., datë 29.01.2020 (përcjellë nga KPK), denoncues H. T.;

9. nr. {***} prot., datë 18.09.2020, denoncues K. M.;

10. nr. {***} prot., datë 10.12.2020, denoncuese Gj. T.;

11. nr. {***} prot, datë 13.01.2021 - denoncues I. S.

nga Gjykata e Lartë [...]. Prandaj, gjykatës së cilës i dërgohet çështja për shqyrtim nga një gjykatë më e lartë, ka detyrimin imperativ të marrë dhe të shqyrtojë çështjen dhe jo të ngrejë përsëri konfliktin e kompetencës/juridiksionit.

28.3 Nisur nga këto disponime gjyqësore, Kolegji konstaton se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit, e materializuar në vendimin nr. {***} regjistri themeltar, datë 15.2.2017, është marrë duke anashkaluar urdhërimet që Gjykata e Lartë kishte shpallur me një vendim të mëparshëm të saj, lidhur me kompetencën e Gjykatës Administrative të Apelit për gjykimin e çështjes që i përkiste paditësit K. D. Madje vendimi i Gjykatës së Lartë me nr. {***}, datë 12.12.2016, kishte zgjidhur pikërisht konfliktin e kompetencës mes Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit për gjykimin e çështjes, duke përbërë në këtë kuptim *res giudica* për sa ngrihet sërish në vendimin e marrë prej subjektit.

28.4 Vendimmarrja e subjektit në këtë rast duket se vjen në kundërshtim me parashikimet e neneve 63, 64, 486, 493/2 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat detyronin subjektin të pranonte për shqyrtim gjykimin e çështjes, pavarësisht opinionit apo mendimit të ndryshëm, për sa kohë që Gjykata e Lartë, me cilësinë e gjykatës që ka të drejtën të zgjidhë konfliktet e kompetencës, e kishte shpallur qëndrimin e saj për rastin në fjalë. Vendimmarrja e subjektit në shmangie të detyrimit ligjor për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, ka prodhuar tejzgjatje të procesitgjyqësor në kohë në mënyrë të paarsyeshme të padrejtë, duke cenuar të drejtën e palës për një proces të zhvilluar brenda një kohe të arsyeshme, në kuptim të parimit të procesit të rregullt ligjor, sipas përcaktimit të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNj-së.

28.5 Kolegji vëren se në këtë rast subjekti, nëpërmjet marrjes së vendimit për të parashtruar sërish një mosmarrëveshje kompetence, e cila kishte marrë zgjidhje me vendim po të Gjykatës së Lartë, ka treguar dobësi që afektojnë aspektin e njohurive mbi ligjin në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr.96/2016.

28.6 Në lidhje me denoncimin e përcjellë prej shoqatës {***}, Komisioneri Publik vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë denoncim, nuk janë bindëse dhe shteruese. Në analizë të përmbajtjes së këtij denoncimi dhe akteve bashkëlidhur tij, sërish mbetet e paqartë nëse në rigjykimin e çështjes për rastin me paditës L. R., ku subjekti i rivlerësimit rezulton në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, në kuptim të nenit 443 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 46 të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar, afati i ankimit është vlerësuar dhe respektuar apo të metat e këtij mjeti ankimi të palës së paditur janë shëruar.

28.7 Subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë denoncim, ka parashtruar qëndrimin që lidhet me themelin e çështjes duke nënvizuar faktin se në rastin konkret, është zbatuar përcaktimi i vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka dhënë një zgjidhje përfundimtare në lidhje me përlllogaritjene masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ish-ushtarakët.

28.8 Kolegji analizoi faktet e lidhura me këtë denoncim në raport me zbatimin e ligjit procedural që përcakton fuqinë detyruese të urdhërimeve e konkluzioneve të Gjykatës së Lartë në rastet e dërgimit të çështjeve për rigjykim, pa shqyrtuar dhe analizuar thelbin e vendimmarrjes, si një çështje që del jashtë juridiksionit rivlerësues të Kolegjit, në zbatim të nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

28.9 Në këtë këndvështrim, nga aktet e bashkëngjitura denoncimit, çështja gjyqësore e kontestuar i përket padisë së paditësit L. R. kundër palës së paditur {***}, me objekt detyrimin

për pagimin e diferencave që rrjedhin nga llogaritja e pensionit të parakohshëm, përfituar prej paditësit me statusin e ish-ushtarakut. Kjo çështje është gjykuar me vendimin nr. {***}, datë 29.03.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila i ka njohur paditësit si të drejtë për t'iu fituar vlerën prej 926.455 lekësh. Ndaj këtij vendimi kanë ushtruar ankim të dyja palët ndërgjyqëse dhe, pas shpalljes së moskompetencës prej Gjykatës së Apelit Tiranë, meqenëse kishte filluar funksionimi i Gjykatave Administrative, çështja është gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. {***}, datë 22.06.2015, e cila ka vendosur të ndryshojë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe t'i njohë paditësit si diferencë të papaguar pensioni vetëm vlerën prej 161.261 lekësh. Në arsyetimin e këtij vendimi, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur mospranimin e ankimit të palës së paditur, duke qenëse ankimi nuk ishte nënshkruar nga personi i titulluar me këtë të drejtë.

28.10 Vendimi i mësipërm është rekursuar në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. {***}, datë 25.01.2017, ka konstatuar se ankimi i palës së paditur, për shkak të mospranimit të tij dhe marrjes formë të prerë të këtij vendimi pa ankim të veçantë, do të konsiderohet ligjërish se nuk është paraqitur asnjëherë në apel. Gjithashtu, në këtë vendim nënvizohet fakti se rekursi i palës së paditur nuk është ngritur për të ankimuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, që ka vendosur të mospranojë për shqyrtim ankimin e palës së paditur, {***}, duke konkluduar për sa më lart, se vendimi i mospranimit të ankimit i gjykatës së shkallës së dytë ka marrë formë të prerë. Mbi orientimin për rigjykim të verifikimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e palës paditëse, Gjykata e Lartë ka prishur vendimin dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në po të njëjtën gjykatë me një trup tjetër gjykuës.

Në rigjykim, trupa gjykuëse në të cilën subjekti ka qenë me cilësinë e anëtarit, ka marrë në shqyrtim kërkesën e paditësit për të hequr dorë nga ankimi dhe ka vendosur me vendimin nr. {***}, datë 09.04.2019, [...] *pushimin e shqyrtimit të çështjes për ankimin e palës së paditur për shkak të heqjes dorë nga ankimi dhe ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi ankimin e palës së paditur dhe rrëzimin e padisë [...].*

28.11 Referuar këtij vendimi, Kolegji konstaton se ai është marrë në kundërshtim jo vetëm me parashikimet e dispozitave procedurale që rregullojnë efektet e një vendimi për mospranimin e ankimit, i cili në terma praktikë dhe ligjorë, prodhon si pasojë mosekzistencën e ankimit dhe shkaqeve të tij si një mjet për t'iu drejtuar gjykatës, por aq më tepër në kundërshtim me një konkluzion të marrë nga Gjykata e Lartë për këtë çështje e të arsyetuar qartësisht në vendimin e saj që kthen çështjen për rigjykim. Edhe në kushtet kur trupa gjykuëse do të kishte një qëndrim të ndryshëm për efektin e vendimit të mospranimit të ankimit, fakti që në lidhje me këtë efekt ishte shprehur Gjykata e Lartë në vendimin e detyrueshëm për zbatim sipas neneve 486 e 493 të Kodit të Procedurës Civile, do të duhej të konsiderohej e zbatohet në zgjidhjen e çështjes në rigjykim. Kjo vendimmarrje ka rezultuar me pasojë negative e në shkelje të parimit të sigurisë juridike për palën paditëse e cila, nisur nga orientimi i Gjykatës së Lartë e konkluzioneve të arritura prej saj, ka tërhequr ankimin ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, në pritje të lënies në fuqi të vendimit të marrë prej saj. Kolegji çmon se subjekti, duke qenë pjesë e trupës gjykuëse që ka marrë këtë vendim, ka demonstruar mangësi në drejtim të njohurive të ligjit në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

28.12 Në lidhje me denoncimin e paraqitur nga shtetasi I. S., për të cilin Kolegji vendosi të analizojë pretendimet, subjekti parashtrori rrethanat në të cilat ai është përcaktuar në rolin e gjyqtarit relator të çështjes, për shkak të zëvendësimit të gjyqtarës që ishte në këtë funksion. Lidhur me pretendimin e denoncuesit se gjykata duhej të shqyrtonte dhe konsideronte lejen e legalizimit si një akt absolutisht të pavlefshëm, subjekti potencoi në gjykim të njëjtin qëndrim e

arsyetim të mbajtur në vendimin objekt denoncimi, se është konstatuar mungesa e legjitimitetit aktiv të paditësit I. S. dhe, në këto kushte, nuk janë marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në padinë e tij, si në lidhje me lejen e legalizimit. Sipas subjektit, gjykata ka vlerësuar se paditësi ka mungesë të legjitimitetit aktiv për sa i përket objektit të padisë si pavlefshmëri e lejes së legalizimit, duke qenë se konstatohet që thelbi i mosmarrëveshjes është një konflikt civil dhe jo administrativ, i cili duhet mbrojtur me padi civile të pushimit të cenimit, për pasojë padia e ngritur me objektin e gabuar, është rrëzuar.

28.13 Kolegji analizoi pretendimet e denoncuesit në këndvështrim të dispozitave procedurale të thirrura për zbatim e larg analizës së fakteve mbi të cilat mbështetet bindja e brendshme e gjyqtarit, si një proces që del jashtë juridiksionit rivlerësues të Kolegjit, në zbatim të nenit 72, pika 4 e ligjit nr.96/2016. Kolegji analizoi këtë denoncim edhe në drejtim të matjes së perceptimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, duke qenë se dukshëm dhe në afat të paarsyeshëm, çështja gjyqësore dhe administrative e shtetasit denoncues, është mbajtur e varur në institucionet e drejtësisë, pa gjetur ende një zgjidhje përfundimtare.

28.14 Nga aktet e bashkëngjitura denoncimit, por edhe atyre të paraqitura në gjykim nga subjekti, rezulton se shtetasi I. S. ka parashtruar para gjykatës një padi me anë të cilës ka kontestuar legalizimin, sipas pretendimit të tij të paligjshëm të një ndërtimi shtesë mbi një objekt, të ndodhur në rrugën “{***}” në Tiranë, shumë pranë me banesën në pronësi të tij, e cila është një objekt i shpallur monument kulture i kategorisë së parë dhe i mbrojtur nga ligji “Për trashëgiminë kulturore”. Çështja është paraqitur para gjykatave që në vitin 2011, me pretendimin se vetëdeklarimi i palës ndërtuese/i padituri është i falsifikuar e, për pasojë, edhe vetë leja e legalizimit të këtij objekti është e pavlefshme dhe duhet shfuqizuar. Përpos kësaj shkeljeje, rezulton se ndërtimi i kryer dhe i legalizuar si i ligjshëm për shkak të vetëdeklarimit të falsifikuar, cenon paditësin në gëzimin e plotë të sendit në pronësi të tij, duke qenë se kufizohet diellëzimi, ajrosja e fushëpamja, në shkelje të kondicioneve të urbanistikës. Pretendimi për falsifikim të vetë deklarimit është pranuar dhe nga organi i akuzës, pas një hetimi të kryer në përfundim të të cilit është konkluduar se falsifikimi ka ndodhur, por ndjekja penale nuk mund të ushtrohet pasi kanë kaluar afatet e parashkrimit të saj dhe çështja penale është pushuar për këtë shkak.

28.15 Në përgjigje të këtyre pretendimeve, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin nr. {***}, datë 05.07.2017, ka vendosur pranimin e padisë dhe shfuqizimin e lejes së legalizimit nr.{***}, datë 27.05.2011, në favor të palës së paditur/denoncuesit. Gjykata Administrative e Apelit, në trupin gjykues të të cilit subjekti ka qenë me cilësinë e relatorit, me vendimin nr. {***}, datë 06.11.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe rrëzimin e padisë. Ky vendim është mbështetur në arsyetimin se paditësit i mungon legjitimiteti aktiv në ngritjen e padisë për shfuqizimin e lejes së legalizimit, pasi i vetmi interes i prekur palës paditëse vjen nga ndërtimi dhe jo legalizimi dhe duhet të kategorizohet nën mbrojtjen e të drejtave civile dhe jo ato që mbrohen sipas së drejtës administrative. Duke arsyetuar në këtë mënyrë, gjykata ka konkluduar se padia që duhej të ngrihej ishte ajo e pushimit të cenimit dhe jo shfuqizimi i aktit administrativ dhe, për pasojë, ka rrëzuar padinë e denoncuesit.

28.16 Në analizë të këtyre rrethanave, Kolegji çmon se vendimi i mësipërm i marrë nga trupa gjykuese në të cilën subjekti ka qenë me cilësinë e relatorit, përmban kontradikta dhe mungesë arsyetimi në brendinë e tij, ashtu si edhe zbatim të gabuar të dispozitave procedurale që rregullojnë gjykimin administrativ dhe kompetencat e Gjykatës Administrative.

28.17 Siç rezulton nga leximi i pjesës arsyetuese të vendimit, gjykata ka argumentuar në vendimin e saj mungesën e interesit të ligjshëm të paditësit I. S. për të kërkuar gjyqësisht shfuqizimin e lejes së legalizimit të objektit të ndërtuar nga pala e paditur, duke qenë se sipas vlerësimit të gjykatës, dëmet e ardhura paditësit në gëzimin e pronës së tij nuk vijnë drejtpërsëdrejti nga akti administrativ, por nga vetë ndërtimi i kryer nga palaepaditur. Duke analizuar në këtë linjë, që tregon se gjykata nuk bindet për legjitimitimin e paditësit në gjykimin administrativ, që do të thotë se sipas saj mungon interesi i ligjshëm për goditjen e aktit, Gjykata Administrative e Apelit ka konkluduar në finale me një vendim për rrëzimin e padisë, i cili duhej të përfaqësonte qëndrimin se në thelb, paditësi nuk gëzon mbrojtje ligjore për të drejtat e pretenduara në proces. Mungesa e interesit të ligjshëm, sipas arsyetimit të gjykatës, është përkufizuar si mungesë e legjitimitetit aktiv, institutqë përdoret në gjykimet civile e që i korrespondon situatës kur paditësi nuk gëzon ligjërisht mbrojtje për të drejtën e pretenduar.

28.18 Sipas vlerësimit të Kolegjit, situata e përshkruar dhe argumentuar në vendimin objekt analize, edhe në versionin që Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar drejt, i korrespondon legjitimitetit si një kusht formal për ngritjen e padisë në gjykim administrativ. Kjo situatë edhe në versionin që gjykimi është i saktë, do të duhej të cilësohej sipas dispozitave procedurale që e atashojnë me atë që parashikon neni 15, germa “a” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”⁷⁸. Ky cilësim do të duhej të çonte Gjykatën drejt një vendimi për pushimin e gjykimit sipas parashikimit të nenit 50, germa “d” e ligjit nr. 49/2012⁷⁹ dhe duhet të ishte pjesë e shqyrtimit paraprak të çështjes. Gjykata në vendim ka përdorur një arsyetim të sforcuar për të barazuar mungesën e legjitimitetit në ngritjen e padisë si një aspekt formal me mungesën e legjitimitetit aktiv si një element i meritës së çështjes e trajtim doktrinar i së drejtës civile. Vlen të veçohet fakti se, në mënyrë të posaçme ligji nr.49/2012 ka parashikuar të drejtën e Gjykatës Administrative për të marrë një vendim jopërfundimtar në rastet kur mungon interesi i ligjshëm në goditjen e një akti të caktuar administrativ dhe të drejtën e Gjykatës së Apelit për të pushuar gjykimin në raste të tilla, ashtu si në mënyrë të ngjashme Kodi i Procedurës Civile në nenet 176 e 299, germa “c” ka parashikuar detyrën e gjykatës për të verifikuar legjitimitimin e palëve në proces, duke pasur kompetencën të vendosë pushimin e gjykimit në rastin e një padie që nuk mund të ngrihet. Për më tepër, në vështrim të nenit 40, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr.49/2012⁸⁰, dispozitë e cila përcakton llojet e vendimeve përfundimtare që mund të marrë gjykata administrative, duket se rrëzimi i padisë mund të vendoset nga kjo gjykatë vetëm pasi ajo ka shqyrtuar në themel ligjshmërinë e aktit administrativ dhe vetëm kur ajo mund të marrë një qëndrim përfundimtar drejt paligjshmërisë së këtij akti. Sipas këtij parashikimi, gjykata nuk rezulton të ketë të drejtën të shprehet për rrëzimin e një padie që pretendon shfuqizimin e një akti administrativ për mungesë legjitimiteti, pa e shqyrtuar aktin në drejtim të ligjshmërisë së tij.

28.19 Arsyetimit të mësipërm, Kolegji çmon t’i asociojë edhe rrethanën e dukshme që për gati nëntë vite, paditësi/denoncues nuk ka arritur të gjejë një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen që ai ka, si me organin administrativ, ashtu edhe me palën e paditur, duke demonstruar në këtë mënyrë dështimin e sistemit të drejtësisë për t’u shërbyer qytetarëve në përmbushje të misionit të tij. Për sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti edhe në

⁷⁸Të drejtën e ngritjes së padisë e ka: a) çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

⁷⁹Gjykata vendos mospranimin e padisë, kur padia nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Ky vendim jepet derisa nuk është dhënë vendimi i ndërmjetëm për shqyrtimin e provave.

⁸⁰“3.Gjykata vendos rrëzimin e padisë, kur vlerëson se veprimi administrativ apo akti nënligjor normativ është i ligjshëm dhe i themeltë. 4.Gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se, pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta”.

trajtimin e kësaj çështjeje, ka demonstruar mangësi në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr.96/2016.

29. Në një vlerësim të përgjithshëm të mangësive të konstatuara nga Kolegji në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, arrihet në konkluzionin se, pavarësisht numrit të tyre, ato nuk duket se përkufizojnë subjektin si një magjistrat me nivel të aftësive që do ta bënin atë të papërshtatshëm në kuptim të nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. Kolegji në këtë konkluzion mban në konsideratë si faktin se subjekti ka përballuar një numër të lartë gjykimesh, të cilat mbeten jashtë vlerësimit të Kolegjit, por që logjikshëm mund të afektonin vlerësimin për kriterin e aftësive profesionale, ashtu edhe rolin e tij në disa prej çështjeve të analizuara.
30. Ndonëse nuk konsiderohet si i paaftë dhe i papërshtatshëm sipas analizës së mësipërme, Kolegji çmon se natyra dhe numri i problematikave të konstatuara gjatë analizimit të çështjeve si më lart, ngrenë pikëpyetje serioze për aftësitë profesionale të subjektit dhe mënyrën se si ai i ka performuar ato, duke e çuar Kolegjin në përfundimin se vlerësimi për kriterin e aftësive profesionale për subjektin duhet të bëhet sipas nenit 44, germa “b” e ligjit nr.84/2016, si “me mangësi”.
31. Kolegji, ndërsa arrin në konkluzionin e mësipërm në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, duke konsideruar edhe problematikat e konstatuara në kriterin e pasurisë, çmon se nuk është i aplikueshëm rekomandimi për ndjekjen e programit të trajnimit në shkollën e magjistraturës, por shihet i arsyeshëm një vlerësim i përgjithshëm i këtyre rezultateve, në këndvështrim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr.84/2016.
32. Në një analizë të përgjithshme të të gjitha konkluzioneve të arritura në këtë proces e të arsyetuara në vendim, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti jo vetëm ka disponuar e gëzuar pasuri të cilat rezultojnë me problematika në drejtim të legjitimitetit të burimeve të tyre, por edhe duket se ka ndihmuar të rritë vlerën e tyre nëpërmjet influencave që vijnë nga ushtrimi i funksioneve, si në rastin e transaksioneve me shoqëritë “{***}” ShPK e “{***}” ShPK, por edhe ka rezultuar se një pjesë e denoncimeve të publikut, si shprehje e mosbesimit ndaj mënyrës se si ai ka ushtruar funksionet e gjyqtarit, kanë qenë të drejta. Në këtë këndvështrim, Kolegji arriti në konkluzionin se plotësohen kushtet e rrethanat për zbatimin e nenit 61/5 të ligjit nr.84/2016 dhe shkarkimin e subjektit nga detyra. Përfundimisht, Kolegji arriti në konkluzionet e mëposhtme, mbi të cilat disponoi për zgjidhjen e çështjes.

Lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë

- I. Mungesë e burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë shtëpi banimi 2 kate+papafingo, me sipërfaqe 268,2 m², komuna {***}, {***}, Tiranë, e krijuar nga familja e personit të lidhur, në vitin 2003.
- II. Konstatim i faktit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *vetting* përse i përket deklaramit të kredisë së marrë nga personi i lidhur pranë NBG Bank, në vitin 2004, në vlerën prej 23.000 eurosh, si një prej burimeve që kanë shërbyer për financimin e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 102 m², të ndodhur në Rrugën e {***}, {***} Tiranë, duke qenë se nga hetimi ka rezultuar se kjo kredi është disbursuar në favor të huadhënësit të personit të lidhur, z. F. Sh.
- III. Konstatim i faktit se të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur, në vlerën prej 18.000 eurosh, si diferencë e çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes të apartamentit me sipërfaqe 102 m², të ndodhur në Rrugën e {***}, {***}, Tiranë, nuk plotësojnë kërkesat e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme, për shkak të

shmangies nga detyrimi për pagimin e tatimit mbi të ardhurat personale në vitin 2007, viti i krijimit të tyre.

- IV. Mungesë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të financuar blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe prej 73 m², me adresë rr. “{***}”, Tiranë, në vitin 2003.

Lidhur me kriterin e kontrollit të aftësive profesionale

- I. Mungesë e vlerësimit të duhur në lidhje me situatën e një konflikti në dukje të interesit, për sa i përket (i) pjesëmarrjes së subjektit të rivlerësimit në gjykimin e çështjeve gjyqësore në të cilat kanë qenë palë ndërgjyqëse ortakët e vetëm të shoqërive “{***}” ShPK e “{***}” ShPK, me të cilët subjekti dhe personi i lidhur kishin qenë në marrëdhënie kontraktuale; dhe (ii) paraqitjen jo në kohën e duhur të dorëheqjes nga gjykimi i çështjeve që u përkasin shoqërive “{***}” ShA dhe “{***}” ShPK dhe organit tatimor në të cilin personi i lidhur ishte në pozicione drejtuese.
- II. Lidhur me çështjet gjyqësore të analizuara për shkak të denoncimeve të paraqitura në Komision e në Kolegj, krahas çështjes së konstatuar dhe evidentuar në vendimin e Komisionit, konstatohen mangësi në drejtim të aftësive profesionale të subjektit, në çështjet që u përkasin denoncimeve të shtetasve D. Sh., T. B., K. D., I. S., si edhe denoncimeve të entit shtetëror {***},{***}, Vlorë dhe shoqatës {***} ({***}).
33. Mangësitë e vërejtura në çështjet e mësipërme, përfshirë trajtimin jo me mënyrën e duhur të situatave të konfliktit të interesit në dukje, konsiderohen se janë qëndrime që kanë afektuar indikatorët e njohurive të ligjit, aftësive organizative e etikës dhe integritetit, të parashikuara në nenet 72, pika 2; 74, pika 2; e 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, situatë e cila kualifikohet si nivel “me mangësi” i kriterit të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 44, pika “b” e ligjit nr. 84/2016.
34. Në kushtet kur mangësitë e konstatuara në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale nuk janë të vetmet, por ato konstatohet se ekzistojnë krahas defekteve në drejtim të burimit të ligjshëm të pasurive të subjektit të cituara më lart, ndonëse të krijuara jo drejtpërdrejt prej sjelljes e veprimtarisë së tij, por minimalisht të miratuara prej tij, konsiderohen prej Kolegjit se duhen vlerësuar në tërësi, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një nga alternativat e vlerësimit të kriterëve të procesit të rivlerësimit të parashikuar nga ligji.
35. Në zbatim të këtij parashikimi, Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit dështoi të kalonte testin e moscenimit të besimit të publikut, për shkak të ekzistencës së të gjitha këtyre shkeljeve dhe se programi i trajnimit njëvjeçar në Shkollën e Magjistraturës nuk mund të shërojë këtë situatë në drejtim të rikuperimit të besimit të publikut, duke bërë të zbatueshëm në këto kushte, parashikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
36. Në përfundim, mbështetur në konkluzionin e mësipërm dhe në zbatim të neneve D e E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 4, pika 2; e 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji çmon se vendimi nr. 161, datë 18.06.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duhet ndryshuar, pasi ai nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 161, datë 18.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 18.06.2021.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi